

# **PËRMBAJTJA**

Fjala përshëndetëse e Avokatit të Popullit

## **KREU 1**

### **Kuadri ligjor dhe institucional**

## **KREU 2**

### **Bashkëpunimi**

- 2.1 Bashkëpunimi me institucionet e Administratës Publike dhe niveli i zbatimit të rekomandimeve të AP-së
- 2.2 Bashkëpunimi ndërkombëtar
- 2.3 Bashkëpunimi në kuadër të projekteve

## **KREU 3**

### **Ndjekja dhe zbatimi i rezolutes së Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2017**

## **KREU 4**

### **Vlerësimi i situatës së respektimit të të drejtave të njeriut nga administrata publike**

- 4.1 Të drejtat e personave të privuar nga liria
- 4.2 Respektimi i të drejtave të njeriut nga organet e Policisë së Shtetit
- 4.3 Parandalimi i dhunës dhe torturës
- 4.4 Respektimi i të drejtave të njeriut nga Prokuroria
- 4.5 Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore civile dhe administrative
- 4.6 Ndihma juridike falas
- 4.7 Respektimi i të drejtës së pronës
- 4.8 E drejta për kujdes shëndetësor
- 4.9 E drejta për arsim
- 4.10 Mjedisi dhe të drejtat e njeriut
- 4.11 E drejta për strehim
- 4.12 Ndihma Ekonomike
- 4.13 E drejta për sigurime shoqërore
- 4.14 Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara
- 4.15 Të drejtat e fëmijëve

## **KREU 5**

### **Angazhime të tjera institucionale**

- 5.1 Raporti i veçantë për problematikat që lidhen me zbatimin e projektit për ndërtimin e segmentit rrugor “Unaza Lindore Tiranë”, në zonën e Shkozës
- 5.2 E drejta për tubime paqesore
- 5.3 Protesta kundër taksës së Rrugës së Kombit
- 5.4 Monitorimi i pavarur i të drejtave të emigrantëve të huaj dhe kthimeve të detyruara të qytetarëve shqiptarë
- 5.5 Hartimi i Plani Strategjik 2019-2022

## **KREU 6**

### **Shërbimet mbështetëse**

- 6.1 Menaxhimi i Burimeve Njerëzore dhe Administrative
- 6.2 Vështrim mbi të ardhurat dhe shpenzimet
- 6.3 Funksionimi i zyrave rajonale

## **KREU 7**

### **Shifra dhe fakte në lidhje me ankesat dhe trajtimin e tyre**

- 7.1 Numri i ankesave, kërkesave dhe njoftimeve të shqyrtuara
- 7.2 Rastet e mbartura në vite

## **Fjala përshëndetëse e Avokatit të Popullit**

Prej kohëve më të vjetra, një ndër qëllimet kryesore të njeriut ka qenë të njohë të vërtetën. Është kjo dëshirë thelbësore, në dukje e nënkuptueshme dhe e mirëqenë, e cila qëndron në bazamentin e zhvillimit tonë. Prirja drejt së vërtetës dhe kurioziteti për të, shërbejnë si mjete më të sigurt për përparimin e njerëzimit, edhe pse shpesh ai nuk është më komodi prej mjeteve.

Në një mënyrë a në një tjetër, e gjithë shoqëria jonë, mënyra e saj e organizimit dhe institucionet që e bëjnë atë funksionale, janë ndërtuar mbi premisën e së vërtetës dhe refuzimin ndaj mashtrimit, iluzionit dhe falsitetit.

E vërteta qëndron në themelin e demokracisë, si element që kuantifikohet nga vullneti i shumicës dhe nga interesi publik. Nga ana tjetër, nëse ka një tipar dallues të gjithçkaje që nuk duhet ta pranojmë për demokraci, ai është kurrgjë më pak se shmangia prej së vërtetave të rëndësishme për qytetarët, ndërtimi i iluzioneve dhe shtypja e lirisë që buron prej së vërtetës.

Në shoqërinë tonë moderne, ndonëse demokracia është e gjithëpranuar si forma jonë e shtetit, kufiri mes së vërtetës dhe propagandës mashtruese fatkeqësisht është zbehur shqetësueshëm këto kohë.

Propaganda, duhet ta pranojmë, nuk është thjesht pasojë e anti-demokracisë. Shpesh ajo është edhe pararendëse e saj. Teksa liria që gëzojmë është e vërtetë dhe e pranishme, rreziku që ajo të shpërdorohet duke e tjetërsuar sistemin që e prodhoi atë, mbetet eminent.

Propaganda është emri tjetër i së pavërtetës. E vërteta flet me ekzistencën e saj e si e tillë ajo nuk ka nevojë për propagandë. E maskuar si ekspertizë estetike ndaj sipërfaqes, propaganda në kushtet e lirisë është në fakt kufizuese e lirisë. E lirisë për të mësuar të vërtetën fillimisht, e më pas e vetë lirisë në plotkuptimësinë e saj.

Propaganda në kohën tonë ekziston si përpjekje për të krijuar realitete të pëlqyeshme për interesin privat, si muzikë për veshin që i dëgjon dhe si pikturë syrin që i sheh. Në thelb propaganda është fabrikim industrial i të vërtetave të leverdisshme.

Mirëpo nuk ka të vërteta të leverdisshme. Leverdia është koncept ekonomik, ndërsa e vërteta një koncept moral. Leverdia është rumbullakosje dashamirëse shifrash, është kompromis elokuent fjalësh dhe farfuritje verbuese pamjesh. Ndërsa e vërteta është paraqitja më prozaike, e ftohtë, matematike dhe e pamëshirshme e ASAJ QË EKZISTON.

Në fund të fundit, e vërteta mund të jetë edhe e mërzitshme. Ajo refuzon të duket siç bën propaganda, si një klip me efekte speciale që paraqet nga kënde të favorshme një pamje që përndryshe do të të neveriste. Ajo nuk është poster bombastik ose spektakël televiziv. Ajo nuk është as spekulim individual mjeran për pak më shumë vëmendje.

E vërteta mund të jetë edhe një paraqitje e zymtë faktesh brenda një raporti të gjatë e pa figuracion. Mirëpo kjo është e vërteta.

Përgjatë një viti, institucioni i Avokatit të Popullit, si më i larti në renditjen e institucioneve tona kombëtare në mbrojtje të të drejtave të njeriut, ka dëgjuar, mbledhur dhe shqyrtuar të vërtetat e qytetarëve shqiptarë. Ato të vërteta që janë sjellë në vëmendjen tone pikërisht prej tyre por edhe që na janë paraqitur vrullshëm nga realiteti në vend. Ky raport nuk pretendon asgjë më të bukur e asgjë më interesante se kaq.

Ju faleminderit!

## **KREU 1**

### **Kuadri ligjor dhe institucional**

Në ditët e sotme marrja në konsideratë e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut është e dukshme dhe e ndjeshme në çdo sferë të aktivitetit qeverisës dhe në shumë sfera të tjera të jetës publike dhe private. Numri dhe shkalla e përhapjes së institucioneve që kanë për objekt të punës së tyre të drejtat e njeriut reflekton këtë realitet. Megjithatë është e kuptueshme që, vetëm një institucion ligjërishit dhe efektivisht i pavarur, i shkëputur nga përgjegjësitë e qeverisjes ekzekutive dhe nga administrata gjyqesore, mund të luajë një rol unik dhe të mbajë një pozicionin udhëheqës në fushën e të drejtave të njeriut. Një institucion i tillë jep një kontribut të pazëvendësueshëm në përpjekjet e një vendi për të mbrojtur shtetasit e tij dhe për të zhvilluar një kulturë që respekton dhe zhvillon të drejtat e njeriut.

Institucionet e krijuara për mbrojtjen e të drejtave të njeriut janë aktorë të rëndësishëm shtetformues në sistemet demokratike. Ombudsmani si njëri prej tyre luan rol të pazëvendësueshëm, duke qenë tregues i shkallës së pjekurisë të klasës politike dhe të mentalitetit të shoqërisë që e krijon atë. Në këtë kuptim, ngritja, funksionimi dhe mbështetja e institucionit të Ombudsmanit, Avokatit të Popullit në Shqipëri, si një eksperiencë e re institucionale dhe konceptuale, pavarësisht mungesës së traditës institucionale në këtë qasje përfaqëson përpjekje të qenësishme për ndërtimin e shtetit të së drejtës. Kjo mungesë tradite është aq e prekshme saqë edhe në kujtimet e botuara të grupit hartues të tekstit të Kushtetutës së vitit 1998, kur flitej për parashikimin e institucionit të Avokatit të Popullit pikëpyetjet që ngriheshin ishin të shumta, por modelet që mund të ndiqeshin nuk mungonin.

Krijimi i këtij institucioni në vendin tonë është realizuar me parashikimin në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të miratuar me referendum në vitin 1998. Duke ndjekur modelin klasik të Ombudsmanit parlamentar, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin organik “Për Avokatin e Popullit”, në vitin 1999, duke afirmuar institucionin e Avokatit të Popullit, si një garanci kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshëm të individit, shtetas shqiptarë, të huaj, rezident të rregullt, ose jo në Shqipëri, refugjat, si dhe të personave pa shtetësi që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të organeve të administratës publike.

Për këto arsye, ai bën pjesë në ato institucione, të njohura ndryshe si, institucione kombëtare të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut, me natyrë jo vendimmarrëse por opinionbërëse, garante të demokracisë dhe të të drejtave të njeriut.

Në përputhje me Parimet e Parisit,<sup>1</sup> Avokatit të Popullit i është përcaktuar një mandat i gjerë, i bazuar në standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, për promovimin, parandalimin e shkeljes dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Ky mandat jetësohet në juridiksionin dhe kompetencat që këtij institucioni i parashikohen në ligjin e tij organik si dhe nga fakti se, veç detyrave të caktuara në dispozitat e këtij ligji, Avokati i Popullit mund të kryejë edhe detyra të tjera të caktuara në ligje të veçanta, apo edhe rolin e institucionit të besuar dhe realizues të procedurave paraprake, për fillimin e proceseve të përzgjedhjes së kandidaturave, për krijimin e institucioneve të rëndësishme të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, të përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë,<sup>2</sup> në Ligjin nr.84/2016 “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Ligjin nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

---

<sup>1</sup> Angazhimi i OKB për krijimin e institucioneve kombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, i cili fillon që në vitin 1946, njohu një zhvillim shumë të rëndësishëm me work-shopin e organizuar nga ana e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, në Tetor 1991, në Paris. Në këtë aktivitet u përcaktuan disa parime për rritjen e efektivitetit të punës së institucioneve kombëtare të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, të cilat njihen ndryshe si, Parimet e Parisit. Ato përbëjnë modelin (që është pranuar prej shteteve anëtare) për ngritjen dhe funksionimin e këtyre institucioneve.

<sup>2</sup> Shih pikën 3, të nenit 149/d, pikën 11, të nenit 179, dhe pikën 6, të nenit C, të Aneksit-Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Parimet e Parisit janë dokumenti bazë i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, që parashikon standartet për funksionimin e Institucioneve Kombëtare për Promovimin dhe Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut. Në këtë mënyrë institucioni i Avokatit të Popullit në Shqipëri është çertifikuar edhe nga institucionet kompetente ndërkombëtare për standartet e larta që përmbush. Këto standarte lidhen me të drejtën për të paraqitur pranë paraqesë Qeverisë, Parlamentit dhe çdo organi tjetër kompetent, në baza konsultative, ose me kërkesë të autoriteteve përkatëse ose nëpërmjet ushtrimit të kompetencave të tij të hetimit me iniciativë, mendime, rekomandime, propozime dhe raporte për çdo çështje që ka të bëjë me promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Me një staturë të tillë institucionale, pritshmëritë e ligjshme të publikut dhe të gjithë aktorëve dhe faktorëve të tjerë të shoqërisë sonë të brishtë demokratike kanë qënë dhe janë të larta karshi veprimtarisë së institucionit të Avokatit të Popullit.

Një institucion kombëtar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut (siç është institucioni i Avokatit të Popullit), duhet të veprojë domosdoshmërisht me “Parimet e Parisit”, të cilat përcaktojnë kompetencat, përgjegjësitë, përbërjen dhe garantojnë pavarësinë dhe pluralizmin. Me qëllim që Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut të konceptohen dhe të veprojnë në përputhje me këto parime dhe të veprojnë si institucione lidere në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ato i nënshtrohen procesit të akreditimit i cili kryhet çdo 4 vjet. Disa nga kriteret që udhëheqin procesin e akreditimit janë: institucion me një mandat të gjerë, bazuar në normat dhe standardet universale të të drejtave të njeriut; autonomia nga qeveria; pavarësia e garantuar në statut ose kushtetutë; pluralizmi; burimet e përshtatshme financiare dhe kompetenca të qarta hetimi dhe investigimi. Forcimi i kapaciteteve njerëzore dhe financiare të tyre, zbatimi i standarteve dhe praktikave më të mira, nëpërmjet pasjes së një infrastrukture që mundëson realizimin e objektivave dhe qëllimeve, është dhe mbetet një përpjekje dhe sfidë e vazhdueshme.

Nivelet e akreditimit nga GANHRI (Global Alliance of National Human Rights Institutions) janë tre “A”, “B”, “C”, ku A është statusi më i lartë. Institucionet me statusin A, mund të marrin pjesë me të drejta të plota në punime dhe takime rajonale dhe ndërkombëtare të institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut, të mbajnë pozicione drejtuese në strukturat e GANHRI ose në një nga nën-komitetet e saj, etj.

Institucioni i Avokatit të Popullit të Shqipërisë është akredituar me Statusin “A” për herë të parë në vitin 2004; është riakredituar në vitin 2008 dhe në vitin 2015 me të njëjtin status. Sipas raportit të fundit (26 Maj 2017) të GANHRI, procesi i akreditimit për Shqipërinë ka filluar në 2013 dhe ka përfunduar në tetor të 2014, rrjedhimisht procesi i rradhës i akreditimit (i cili bazohet në plotësimin e disa kushteve thelbësore të përmendura më sipër) duhet të fillonte në 2018, por është shtyrë për në vitin 2019.

## KREU 2

### Bashkëpunimi

#### 2.1 Bashkëpunimi me institucionet e Administratës Publike dhe niveli i zbatimit të rekomandimeve të AP-së

Niveli i zbatimit të rekomandimeve nga institucionet e administratës publike ka qenë dhe mbetet një shqetësim i vazhdueshëm për institucionin e Avokatit të Popullit. Në këtë kuadër, Avokati i Popullit është i ndërgjegjshëm se veprimtaria e institucioneve të tilla e kanë shumë të nevojshme që të ketë një mekanizëm eficient dhe sistematik të ndjekjes dhe përmbushjes së rekomandimeve, që i drejtohen organeve të administratës publike. Në këtë aspekt është vlerësuar fakti që tashmë, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar vendimin nr.49/2017 “Për krijimin e mekanizmit për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavaruara kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj”, në të cilën janë përfshirë edhe sugjerimet e Avokatit të Popullit. Më konkretisht, niveli i zbatimit të rekomandimeve për vitin 2018 është si më poshtë:

Institucioni i Avokatit të Popullit ka adresuar në total **171 rekomandime**<sup>3</sup> drejtuar organeve të Administratës Publike duke përfshirë atë qendrore dhe vendore. Nga numri total i rekomandimeve rezulton se:

- **93 rekomandime janë pranuar;**
- **17 rekomandime janë refuzuar;**
- **5 rekomandime pa përgjigje;**
- **56 rekomandime në proces.**

Pra, siç rezulton nga të dhënat e mësipërme numri i rekomandimeve të regjistruara për vitin 2018 është 171, por 56 prej tyre janë në proces, që do të thotë se për këto rekomandime ende nuk kanë kaluar afatet procedurale për të konsideruar nëse janë pranuar apo refuzuar, zbatuar apo pa zbatuar, me apo pa përgjigje, duke qënë se janë dërguar në fund të vitit 2018 apo në fillim të vitit 2019 për inspektime të kryera në 2018.


Nisur nga analiza e statistikave të mësipërme, për vitin 2018 rezulton dhe sikundër evidentohet ka një ulje të numrit të rekomandimeve të pranuar në tërësi nga institucionet e Administratës Publike, por kemi një rritje në përqindje të rekomandimeve të zbatuara. Ndërkohë që edhe lidhur me rekomandimet pa përgjigje rezulton se për vitin 2018 janë më pak rekomandime pa përgjigje, krahasuar me vitin 2017.

Në formë grafike, këto të dhëna paraqiten si më poshtë:


---

<sup>3</sup> Më shumë informacion në lidhje me përmbajtjen e rekomandimeve dhe institucioneve që u janë drejtuar, gjenden në Aneksin I bashkelidhur këtij raporti


## REKOMANDIME 2018



## Zbatueshmëria e Rekomandimeve për 2018



## Zbatueshmëria e Rekomandimeve për 2018



### 2.2 Bashkëpunimi ndërkombëtar

Gjatë vitit 2018, përfaqësues të Institucionit të Avokatit të Popullit morën pjesë në një sërë aktiviteteve ndërkombëtare, në kuadër të bashkëpunimit dypalësh dhe shumëpalësh të Institucionit, të renditura si vijon:

- ✓ *Bashkëpunimi në kuadër të Aleancës Globale e Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (GANHRI) si dhe Rrjeti European i Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (ENNHRI).* Institucioni i Avokatit të Popullit ka ndjekur aktivitetet e organizuara në kuadër të GANHRIT si dhe ka zhvilluar veprimtari aktive përsa i takon Rrjetit European të Institucioneve të të Drejtave të Njeriut (ENNHRI-t). Misioni i ENNHRI-t është të mbështesë dhe të forcojë Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e njeriut në të gjithë Evropën, në përputhje me parimet e Parisit. Institucioni i Avokatit të Popullit ka dhënë kontributin e tij në aktivitete të ndryshme, grupe pune etj, të zhvilluara në kuadër të këtyre organizmave. Më konkretisht:
- ✓ Një delegacion i nivelit të lartë i kryesuar nga Avokatja e Popullit Znj. Erinda Ballanca mori pjesë në takimet vjetore të Aleancës Globale të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (GANHRI) që u mbajtën në datat **21-23 shkurt 2018** në Gjenevë, Zvicër, ku u diskutua për *“Të drejtat e njeriut dhe të personave me aftësi të kufizuara”*.
- ✓ Përfaqësues të Institucionit të Avokatit të Popullit morën pjesë në Workshopin e ENNHRI-t në lidhje me *mbrojtjen e personave të zhvendosur*, që u mbajt në datat **23-25 Prill 2018, Kiev, Ukrainë**.
- ✓ Përfaqësues të Institucionit të cilët mbulojnë problematikat e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara morën pjesë në takimin e grupit të punës së ENNHRI-t, që u mbajt në datat **2-3-4 Tetor 2018, në Riga, Letoni**.
- ✓ Konferenca Vjetore e ENNHRI-t u mbajt në Athinë, Greqi në datat **24-25 Tetor 2018**, me temë kryesore: *“Të ndërtojmë ura për të drejtat e Njeriut –Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut, si mbrojtëse të të Drejtave të Njeriut*. Në këtë takim mori pjesë një delegacion i nivelit të lartë drejtues nga Institucioni i Avokatit të Popullit, kryesuar nga znj. Erinda Ballanca. Përfaqësuesit e Avokatit të Popullit. Në këtë takim u diskutua përkatësisht në lidhje me realitetin e qeverisjes demokratike në vendet pjesëmarrëse, mbi format e komunikimit të ndjekura për promovimin e të drejtave të njeriut.
- ✓ Në kuadër të takimeve vjetore të Rrjetit European të Ombudsmanëve u zhvilluan edhe zgjedhjet për instancat drejtuese me mandate 2019-2022. Një ndër kandidaturat e paraqitura për anëtar të Bordit të ENNHRI dhe GANNHRI ishte edhe ajo e institucionit të Avokatit të Popullit, përfaqësuar nga



Avokatja e Popullit znj. Erinda Ballanca. Me kënaqësi evidentojmë se në përfundim të procesit zgjedhor znj. Ballanca rezultoi fituese për të dyja postet, duke u bërë kështu *anëtare e bordit të dy strukturave mjaft të rëndësishme dhe me impakt në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut*, duke qënë secila përkatësisht rrjete Evropiane dhe Globale të institucioneve homologe. Përfaqësimi i Shqipërisë në këto nivele, mundëson jo vetëm një imazh pozitiv për Shqipërinë, por mbi të gjitha i hap rrugë zhvillimeve të mëtejshme bashkëkohore në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut.

- *Bashkëpunimi në kuadër të AOMF (Shoqata e Ombudsmanëve/Mediatorëve të Frankofonisë) dhe AOM (Shoqata e Ombudsmanëve të vendeve të Mesdheut).*

Institucioni i Avokatit të Popullit ka mbajtur presidencën e Shoqatës së AOM për dy mandate radhazi 2014-2016 dhe 2016-2019, duke marrë pjesë aktivisht në grupe pune, vizita të përbashkëta në qendra migrantësh dhe trainime sipas tematikave, fokusuar kryesisht në tematikën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të migrantëve si objektivi kryesor i Shoqatës nën presidencën e Avokatit të Popullit. Aktualisht, Avokati i Popullit është anëtar i bordit dhe Zv/President i Shoqatës së AOM. Për vitin raportues aktivitetet janë si më poshtë:

#### *Shoqata e Ombudsmanëve/Mediatorëve të Frankofonisë:*

- ✓ Avokatja e Popullit, Znj. Erinda Ballanca mori pjesë në mbledhjet e Bordit Drejtues të AOMF-së dhe konferencën të organizuar në bashkëpunim me Ombudsmanin Rumun në datat **3-4 maj 2018**, në Bukuresht, Rumani.
- ✓ Përfaqësues të Avokatit të Popullit morën pjesë në trajnimin e destinuar bashkëpunëtorëve të rinj të institucioneve anëtare, ku në fokus kryesor ishin çështjet e menaxhimit të ankesave, marrëdhëniet me administratën dhe ankuesit, etj, që u mbajt në datat **9-10-11 tetor 2018**, në Rabat, Marok.
- ✓ Avokatja e Popullit, Znj. Erinda Ballanca mori pjesë në konferencën e AOMF-së që përkonte edhe me rastin e 20-vjetorit të Shoqatës, i mbajtur në **datat 6-9 nëntor 2018**, në Bruksel dhe Namur, Belgjikë. Takimi konkludoi me miratimin e Deklarates se Namurit, e cila bën thirrje për forcim dhe konsolidim të institucioneve të ndermjetesimit, promovimin e një strategjie për një shtet të hapur, arritjen e një shoqërie gjithëpërfshirëse dhe respektim i të drejtave themelore të çdo qytetari.

#### ➤ *Shoqata e Ombudsmanëve të vendeve të Mesdheut:*

- ✓ Një delegacion i nivelit të lartë i Avokatit të Popullit, i kryesuar nga Znj. Erinda Ballanca, mori pjesë në takimet vjetore të AOM-së që përkuan edhe me 10 vjetorin e krijimit të Shoqatës dhe 20-vjetorin e krijimit të Ombudsmanit të Maqedonisë në **datat 30-31 maj 2018, Shkup, Maqedoni**.
- ✓ Përfaqësues të Avokatit të Popullit morën pjesë në trajnimin e radhës me temë mbrojtja e të drejtave të personave të privuar nga liria, që u zhvillua në Rabat, Marok. **28-29 nëntor 2018**.

#### ➤ *Aktivitetet e institucionit të Avokatit të Popullit në rolin e Mekanizmit për Parandalimin e Torturës*

Në kuadrin e bashkëpunimit Ndërkombëtar, janë realizuar aktivitetet si më poshtë:

- ✓ Pjesëmarrja e Avokates së Popullit, znj. Erinda Ballanca në Konferencën Ndërkombëtare të Nivelit të Lartë me rastin e 10-vjetorit të krijimit të Ombudsmanit të Armenisë si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës mbajtur në datat 28-29 Nëntor në Jerevan, Armeni.
- ✓ Pjesëmarrja e përfaqësuesve të institucionit në Forumin European të Mekanizmit për Parandalimin e Torturës mbi monitorimin e shtëpive të të moshuarve të organizuar në **12 Mars**, në Trier, Gjermani.
- ✓ Pjesëmarrja në trajnimet e organizuara nga FRONTX në lidhje me monitorimin e kthimeve të detyruara, të mbajtur në datat **9-13 prill**, në Beograd, Serbi.
- ✓ Pjesëmarrja në Forumin European të Mekanizmave Kombëtare për Parandalimin e Torturës, të mbajtur në datat **17-18 Prill**, në Lubjanë, Slloveni si edhe në takimin e Rrjetit të Mekanizmave Kombëtare të

- Parandalimin e Torturës të Europës Juglindore, në datat **29-30 Maj**, në Podgoricë, Mali i Zi.
- ✓ Pjesëmarrja, në kuadër të bashkëpunimit me IOI, më Workshopin me temë: “Forcimi i ndjekjes së zbatueshmërisë së rekomandimeve të Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës”, i fokusuar kryesisht në përgatitjen e rekomandimeve efektive, ndjekja dhe vlerësimi i zbatueshmërisë së rekomandimeve dhe progresi në këtë proces.
  - ✓ Pjesëmarrja në takimin e dytë rajonal të Mekanizmave për Parandalimin e Torturës, organizuar nga ATP dhe ODHIR në datat **3-4 Dhjetor** në Milano, Itali.
- *Aktivitetet e institucionit të Avokatit të Popullit në kuadër të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të fëmijëve*
- ✓ Pjesëmarrja e Avokates së Popullit, znj.Erinda Ballanca, në Konferencën e 22-vjetore të Rrjetit European të Ombudsmanëve për Fëmijë (ENOC) dhe Asamblenë e Përgjithshme të mbajtur në **datat 19-21 shtator 2018**, në Paris me temë “Shëndeti mendor i Fëmijëve dhe Adoleshentëve”.
  - ✓ Pjesëmarrja e përfaqësuesve të institucionit në Konferencën me temë: “Të drejtat e fëmijëve të privuar nga liria”, organizuar në **26 nëntor 2018**, në Bruksel, Belgjikë.
  - ✓ Pjesëmarrja e përfaqësuesve të institucionit në Konferencën Ndërkombëtare të organizuar nga Komisioneri i Lartë për të Drejtat e Njeriut të Federatës Ruse, të mbajtur në **datën 8 Nëntor**, në Moskë, Rusi.

Gjithashtu, gjatë vitit 2018, është marrë pjesë edhe në aktivitetet e mëposhtme:

- ✓ Pjesëmarrja e Avokates së Popullit, znj.Erinda Ballanca, me ftesë të Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme të Francës, në kuadër të Programit të ftesave të personaliteteve të së ardhmes, në vizitën studimore të zhvilluar në datat 3-10 qershor, në Paris, Francë.
- ✓ Pjesëmarrja e Avokates së Popullit, znj.Erinda Ballanca në takimin e organizuar nga Fondacioni Konrad Adenauer me temë kryesore “Sfidat e zbatimit të Reformës në Drejtësi”, zhvilluar në datat **30 shtator- 3 tetor**, në Como, Itali.
- ✓ Pjesëmarrja e përfaqësuesve të institucionit në një vizitë studimore të organizuar nga Zyra e Këshillit të Europës në Tiranë, në **datat 6-9 Maj**, në Bruksel, Belgjikë.

### 2.3 Bashkëpunimi në kuadër të projekteve

Gjatë vitit 2018, Avokati i Popullit vijoi zbatimin e **Marrëveshjes së bashkëpunimit me UNHCR** për monitorimin e pikave të kalimit të migrantëve dhe forcimin e respektimit të të drejtave të tyre. Në këtë kuadër, përveç vendosjes së një përfaqësuesi të Avokatit të Popullit në Gjirokastrë, gjatë vitit 2018 u vendos shtimi i numrit të përfaqësuesve të AP edhe në dy pika të tjera të kalimit të migrantëve, respektivisht në pikën e kalimit të kufirit të Hanit të Hotit në Shkodër dhe në atë të Kapshticës. Shuma totale e përftuar nga kjo marrëveshje shkon në 3.745 mije lek, nga të cilat për mbulimin e shpenzimeve të ekspertit (paga, shpenzime transporti, tel etj) gjatë vitit 2018 janë harxhuar 2.350 mijë lek.

Avokati i Popullit ka vijuar bashkëpunimin me **Agjencinë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ)** me qëllim përmirësimin e shërbimeve sociale. Fokusi i projektit ka të bëjë me përmirësimin e kapaciteteve për lëvrimin e shërbimeve sociale për grupet në nevojë. Krahas ngritjes së kapaciteteve, projekti parashikon edhe ndërgjegjësimin e përfituesve për të drejtat e tyre sociale, përfshirë të drejtën e mosdiskriminimit. Duke qenë se projekti është rajonal, një vend të rëndësishëm zë edhe shkëmbimi i përvojave dhe praktikave më të mira me partnerët që kontribuojnë në këtë fushë në vendet e rajonit. Aktivitetet e realizuara në kuadër të këtij projekti kanë qenë të fokusuara në: pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucionit të Avokatit të Popullit në trajnime kombëtare dhe ndërkombëtare (Ljubjanë, Shkup, Prishtinë), si dhe në hartimin e një vlerësimi në lidhje me ofrimin e shërbimeve sociale dhe të një metodologjie për monitorimin e këtyre shërbimeve nga institucioni i Avokatit të Popullit, për shërbimet e ofruara nga pushteti vendor.

**Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar (USAID)** financon një projekt për transparencën në shëndetësi. Avokati i Popullit së bashku me Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe ILDKPI janë përfitues të këtij projekti, i cili shtriu fushën e veprimit edhe për vitin 2018. Deri tani projekti ka ofruar një numër trainimesh për stafin e Avokatit të Popullit, përfshirë edhe zyrat rajonale të AP. Synimi është forcimi i koordinimit ndërinstitucional për të luftuar korrupsionin në sektorin e shëndetësisë përmes rritjes së ndërgjegjësimit të pacientëve dhe publikut në tërësi por edhe të strukturave përgjegjëse për monitorimin dhe mbikëqyrjen e shërbimit shëndetësor dhe respektimin e standardeve dhe protokolleve mjekësore. Në kuadër të këtij projekti, gjatë vitit raportues, janë realizuar disa inspektime në shërbimin shëndetësor për të cilat janë përgatitur dhe raportet përkatëse të monitorimit.

Në kuadër të Marrëveshjes së **Grantit midis Ambasadës të Republikës së Bullgarisë në Tiranë dhe Avokatit të Popullit të Shqipërisë (Fond prej 30 mijë euro)**, Avokati i Popullit është përfitues i një projekti për forcimin e kapaciteteve administrative. Projekti parashikon forcimin e kapaciteteve të stafit, ndërgjegjësimin e publikut dhe institucioneve për rëndësinë e zbatimit të rekomandimeve të AP, si dhe përmirësimin e sistemit të menaxhimit të ankesave në institucion. Kohëzgjatja e tij është për periudhën janar 2018- qershor 2019. Gjatë vitit raportues, nga ky projekt është përdorur një shumë rreth 1.5 mil lek kryesisht në fushën e promovimit, përmirësimit të teknologjisë së informacionit dhe trajnimit të stafit.

### **KREU 3**

#### **Ndjekja dhe zbatimi i rezolutes së Kuvendit për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2017**

Në kuadër të vlerësimit të veprimtarisë së institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2017, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar, më datë 21.06.2018, rezolutën përkatëse ku ndërmjet të tjerash i ka rekomanduar institucionit të Avokatit të Popullit marrjen e një sërë masash që lidhen me ushtrimin e funksioneve të tij kushtetuese dhe ligjore. Në zbatim të kësaj rezolute, institucioni i Avokatit të Popullit ka ndërmarrë veprimet e mëposhtme:

- 1. Të monitorojë zbatueshmërinë e rekomandimeve që i adreson organeve të administratës publike, në mënyrë të veçantë rekomandimet e pranuar formalisht prej tyre. Informacioni në raportin vjetor të Avokatit të Popullit për nivelin e zbatimit të rekomandimeve duhet të jetë i përditësuar. Çdo tre muaj të informojë Nënkomisionin Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve që i ka adresuar organeve të administratës publike.....*

Niveli i zbatimit të rekomandimeve nga institucionet e administratës publike ka qenë dhe mbetet një shqetësim vazhdueshëm për institucionin e Avokatit të Popullit. Përtej hapave dhe iniciativave pozitive të konstatuara ndër vite, mbetet shumë për tu bërë në këtë drejtim jo vetëm, nga organet e administratës publike, në nivel qendror dhe vendor (sidomos sa i përket zbatimit të rekomandimeve), por dhe nga Kuvendi i Shqipërisë, si organi legjislativ ku paraqiten dhe diskutohen raportet e hartuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Është kjo arsyeja që në mënyrë të vazhdueshme, institucioni i Avokatit të Popullit ka monitoruar dhe monitoron nivelin e zbatimit të rekomandimeve të adresuara organeve të administratës publike nëpërmjet përgatitjes së informacioneve të përditësuara, të cilat bëhen pjesë e raportimeve periodike apo vjetore.

Gjatë gjithë periudhës raportuese, institucioni i Avokatit të Popullit në zbatim dhe të Vendimit të Kuvendit të Shqipërisë Nr.49/2017, “Për krijimin e Mekanizmit për Monitorimin Sistematik të Ndjekjes dhe Zbatimit të Rekomandimeve të Institucioneve të Pavarura”, ka informuar zyrtarisht në mënyrë periodike (çdo tre muaj) Kuvendin e Shqipërisë në lidhje me rekomandimet që institucioni i Avokatit të Popullit i ka adresuar institucioneve publike, si dhe statusin e zbatimit të tyre.

Pavaresisht krijimit nga ana e Kuvendit të një mekanizmi të tillë, jemi të mendimit se ka ende vend për përmirësime në këtë drejtim dhe më konkretisht mekanizmi duhet të luajë një rol më aktiv, për të justifikuar qëllimin e krijimit të tij. Një model mjaft interesant që është aplikuar në Kosovë dhe që ka rezultuar efikas, është përfshirja e zërit të zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit të Kosovës, në listën e çështjeve që monitorohen nga ana e Komisionit të Bashkimit Europian.

- 2. Të vazhdojë me dhënien e kontributit në kuadër të Reformës në Drejtësi, për zbatimin me përgjegjshmëri dhe pavarësi të të gjitha përgjegjësive ligjore të parashikuara në paketën e Reformës në Drejtësi*

Reforma në Drejtësi ka marrë fokus të veçantë në punën e institucionit të Avokatit të Popullit, jo vetëm për shkak të detyrimeve ligjore në përcaktuara në legjisllacion, por edhe për shkak të vetë rëndësisë që ka kjo reformë dhe që lidhet drejtpërdrejtë me respektimin e të drejtave të njeriut në vend.

Nën këtë përgjegjësi, Avokati i Popullit ka qenë dhe vazhdon të jetë në mbështetje të plotë të zbatimit të Reformës në Drejtësi, si një reformë jetike për të gjithë shqiptarët, pasi shumë nga çështjet që adresohen nga qytetarët, lidhen me sistemin e drejtësisë në vend, për shkak të një sërë problematikave që rëndojnë këtë sistem. Për më tepër Avokati i Popullit konsideron si jetësore për të gjithë shoqërinë shqiptare kthimin e besimit në sistemin e drejtësisë në vend dhe për këtë ka dhënë kontributin e tij në monitorimin e shumë prej proceseve të realizuara në kuadër të Reformës në Drejtësi.

Më konkretisht pas përfundimit me sukses të procesit për verifikimin dhe listimin e kandidatëve që shprehën interesin për pozicionet e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, konkretisht për Anëtar të Komisionit; Gjyqtar i Kolegjit të Apelit, si dhe Komisionerit Publik, Avokati i Popullit, vazhdoi me procesin e verifikimit të kriterëve formale ligjore për kandidatët nga rradhët e avokatisë, e me pas edhe për kandidatët nga rradhët e Shoqërisë Civile, që shprehën interesin për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

Gjithashtu të vetëdijshëm për rëndësinë e proceseve që ndërthur kjo reformë dhe rolin që Avokati i Popullit mund të luajë për transparencën dhe respektimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, Avokati i Popullit në përputhje me parashikimin e bërë në pikën 3, të nenit 149/d dhe pikën 11 të nenit 179 (dispozitat kalimtare dhe të fundit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenin 284 pika 6 të ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, ka monitoruar procesin e zgjedhjes së Anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi të zhvilluar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë. Mbi bazën e këtij monitorimi, Avokati i Popullit ka hartuar dhe bërë publik Raportet përkatëse të monitorimit për procedurën e hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, për të cilat kërkojmë vëmendje në vlerësimin e tyre dhe marrjen e masave përkatëse. Nga sa ne kemi verejtur ka një nevojë urgjente për të adresuar problemet e dala në procesin e zbatimit të reformës në drejtësi e në mënyrë të vecante në lidhje ngritjen dhe funksionimin e organeve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë.

Ndërkohë, në fazën e fillimit të funksionimit të institucioneve të reja të Drejtësisë, Avokati i Popullit ka vazhduar detyrën e tij kushtetuese dhe kjo detyrë, ka të bëjë me vrojtimin e kujdesshëm që të drejtat e qytetarëve në këtë vend të respektohen dhe çdo institucion të zbatohet me korrektesë ligjin gjatë ushtrimit të detyrës së tij. Në këtë këndvështrim, Avokati i Popullit, ka monitoruar dhe ndjekur pjesën më të madhe (80%) të seancave të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Kolegjit të Apelit.

Shtojmë se Avokati i Popullit ka gjetur bashkëpunim dhe mirëkuptim nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në rastin kur i kemi kërkuar informacion këtij organi, në lidhje me lajmin e publikuar në media mbi kontrollin e fëmijëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve, gjatë praktikave eventuale të verifikimit të pasurive të prindërve të tyre si dhe vazhdimin e praktikës së mirë të zhvillimit të seancave në salla që garantojnë solemnitetin dhe publicitetin.

Shtojmë se duhet vlerësuar edhe ngarkesa e punës që kanë stafet teknike të organeve të reja të vetingut, pasi për kryerjen në kushte normale të punës dhe për përfundimin në një kohë sa më optimale, përveç besimit njëkohësisht këtyre organeve i duhen krijuar edhe kushte sa më normale pune, ç’ka nënkupton rritjen dhe forcimin e kapaciteteve të këtyre institucioneve (përfshirë rritjen e numrit të nëpunësve, trajnimin e tyre, apo edhe pagesën për punën e kryer jashtë orarit zyrtar siç parashikohet në legjislationin e punës). Gjithsesi, me gjithë punën e mirë të bërë duket se ritmet e kryerjes së verifikimit nuk janë ato të parashikuara nga ligjvënësi por gjykojmë as ato të pritura nga qytetaret. Mosfunksionimi i Gjykatës Kushtetuese dhe funksionimi i Gjykatës e Lartë në mënyrë minimale janë një problem madhor që ndikon drejtperdrejtë në situatën e demokracisë në vend dhe në gjykimin e Avokatit të Popullit sjellin përkeqesim të ndjeshëm të nivelit të garantimit të zbatimit të drejtave të njeriut në vend. Është e qartë tashmë që për të realizuar këto reforme sipas parashikimeve kushtetuese e ligjore vec vullnetit politik (në kuptimin e mbeshtetjes së parlamentit) duhen kapacitete financiare dhe njerzore me të madha se ato që vendi ynë ka në dispozicion.

Avokati i Popullit i ka ngritur këto çështje në të gjitha takimet me tematikë të tillë, duke kërkuar që këto të jenë në axhendën prioritare si të pushtetit ekzekutiv, ashtu edhe atij legjislativ.

Reforma në drejtësi, dhe rezultati për të cilin ajo u bë duhet të vazhdojnë të jete shqetësimi kryesor i të tere institucioneve në vend. Në përfundim të raportimit për këtë pikë, përsërisim edhe një herë lidhjen e natyrshme të Reformës në Drejtësi, me të drejtat për: Drejtësi, Mirëqeverisje, si dhe me respektimin dhe

mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut në vendin tonë.

3. *Të kontribuojë në mënyrë proaktive për përmirësimin e legjislacionit vendas, në përmbushje edhe të rekomandimeve të Progresraportit të Komisionit European të bërë publik në prill të vitit 2018, ku i kërkohet Avokatit të Popullit të jetë pjesë e konsultimeve të projektligjeve në komisionet parlamentare.*

Gjatë periudhës raportuese, institucioni i Avokatit të Popullit është investuar në dhënien e mendimeve dhe sugjerimeve për aktet e mëposhtme:

- Projektligji “Për një shtesë në ligjin nr.8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve”, të ndryshuar”, i cili propozonte një regjim të posaçëm për të dënuarit me burgim, të ndaluar në një burg të sigurisë së lartë. Ishte shumë e rëndësishme që edhe në një projekt-ligj të një natyre të posaçme që synon të sanksionojë privimin e disa të drejtave dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve një vend i veçantë ti kushtohet edhe pjesës që i takon trajtimit human të tyre, pasi ka të drejta themelore që i përkasin të gjithëve - madje edhe personave që qëndrojnë në burg. Qëllimi i këtij projektligji synonte që të aplikohet një regjim i posaçëm i kushteve në burgje që do të privonte të drejtat e të dënuarve dhe të paraburgosurve ku veçanërisht kufizon të burgosurit dhe të paraburgosurit të kontaktojnë me njeri-tjetrin apo të komunikojnë me botën e jashtme.

Rekomandimet e pranura të institucionit të Avokatit të Popullit ishin të natyrës së..... , Veçanërisht, u kërkua garantimi i të drejtës së të burgosurve që përfshirja në këtë rregjim të ishte e kufizuar dhe të vendosej nga gjykata, por në çdo rast të ishte vendim i ankimeshëm në respekt të të drejtave të burgosurve për tu ankuar pa kufizim nëse u shkelen të drejtat.

- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006, “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar. Në vazhdimësi të përmbushjes së rekomandimeve për zbatimin e Konventës “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”, u sugjerua e nevojshme, ndërmjet të tjerash, përfshirja e një dispozite ligjore e veçantë, e cila të parashikojë monitorimin e këtij projektligji nga një institucion i pavaruar kushtetues, siç institucioni i Avokatit të Popullit. Ky monitorim të bëhet në përputhje me konventën e KE-së “Për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, ratifikuar me ligjin nr.104, datë 8.11.2012, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr.8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar.
- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë të Drejtësisë për të Mitur dhe të Planit të Veprimit të saj 2018-2021”. Për këtë dokument strategjik, institucioni i Avokatit të Popullit ka dhënë komentet e tij, me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të këtij dokumenti, duke kërkuar njëkohësisht mbajtjen në konsideratë të faktit, që sfidat në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve lidhen me buxhetimin real të nevojshëm, nisur nga perspektiva e të drejtave të fëmijëve, ngritjen e shërbimeve të reja në ndjekje të dinamikës së nevojave të fëmijëve në kontakt dhe konflikt me ligjin, hartimin e politikave gjithëpërfshirëse sociale në nivel vendor, mbështetur në një bazë të dhënash të sakta mbi numrin e fëmijëve subjekt të veprës penale, por edhe në cilësinë e viktimës dhe të dëshmitarit të mitur, konsolidimin e mekanizmave përgjegjës, që garantojnë realizimin efektiv të mbikëqyrjes, promovimit, mbrojtjes dhe monitorimit të të drejtave të fëmijës, si dhe krijimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në kontakt dhe konflikt me ligjin.
- Projektvendimet e Këshillit të Ministrave, “Për veprimtarinë e strukturave për mbrojtjen e fëmijës, në lidhje me fëmijën nën moshën e përgjegjësisë penale që dyshohet apo ka kryer veprë penale” dhe “Për llojet, mënyrën e shkëmbimit dhe të përpunimit të informacionit e të dhënave statistikore, të kërkua nga Agjensia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës pranë strukturave shtetërore përgjegjëse, në

nivel qendror dhe vendor”, për të cilat janë dhënë disa komente dhe sugjerime për përmirësimin e mëtejshëm të tyre.

- Projektvendimi i Këshillit të Ministrave, *“Për bashkërendimin e veprimtarisë ndërmjet mekanizmave këshillimorë dhe koordinues institucionalë dhe strukturave në nivel qendror dhe vendor, për çështjet që lidhen me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”*. Është sugjeruar që ky projektvendim të rregullojë në mënyrë të shprehur e të hollësishme, çështje të bashkëpunimit e bashkërendimit të punës, ndërmjet mekanizmave këshillimorë dhe koordinues institucionalë, në nivel qendror dhe vendor, për të cilat vetë ligjvënasi nuk është shprehur, por i ka deleguar të drejtën Këshillit të Ministrave për t’i rregulluar këto çështje me akt nënligjor. Në këtë kuptim, trajtimi i mekanizmave konkretë, të qartë e transparentë, si gjetje, gjykohet që do të përbënte urën e konsolidimit të mëtejshëm të këtij bashkëpunimi dhe do të përbënte në fakt, thelbin e projektvendimit.
- Projektvendimet të Këshillit të Ministrave *“Për rregullat e funksionimit të grupit teknik ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijëve pranë bashkive dhe njërive administrative”*, *“Për procedurat e referimit dhe të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”*, si dhe *“Për procedurat dhe rregullat për kthimin e riatdhesimit të fëmijës së pashoqëruar”*, për të cilat janë dhënë komentet dhe sugjerimet përkatëse me synim përmirësimin e mëtejshëm të tyre. në funksion të rritjes së mbrojtjes së fëmijëve.

Pas miratimit dhe hyrjes në fuqi të Ligjit nr.96/2017 *“Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”*, deri në fund të vitit 2018, në institucionin e Avokatit të Popullit janë dërguar për mendim, vërejtje apo sugjerime, projekt vendimet si më poshtë vijon:

- Projektvendimi *“Për masat e përshtatëshme për nxitjen e kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar të pakicave kombëtare në veprimtarinë mësimore dhe shkencore të institucioneve të arsimit të lartë”*. Nëpërmjet sugjerimeve të dhëna është synuar për ta nxjerrë këtë projektvendim nga karakteri deklarativ dhe për ta bërë më konkret dhe detyrues në zbatim. Me miratimin dhe hyrjen në fuqi të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.562 datë 29.09.2018 *“Për masat e përshtatëshme për nxitjen njohjes së kulturës, historisë, gjuhës dhe besimit fetar të pakicave kombëtare në veprimtarinë mësimore dhe shkencore të institucioneve të arsimit të lartë”*, vërejmë se vërejtjet dhe sugjerimet tona nuk janë marrë parasysh.
- Projektvendimi *“Për pajisjen me tekste shkollore të nxënësve, zhvillimin e mëtejshëm profesional të mësuesve, si dhe për krijimin e funksionimit të klasave mësimore në gjuhën e pakicave kombëtare”*. Sikurse e kemi konfirmuar në procesin e miratimit të Ligjit nr.96/2017 *“Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”*, problematik mbetet përcaktimi i dhënë në nenin 13 dhe nenin 15, të Ligjit nr.96/2017, ku gëzimi dhe realizimi i disa të drejtave, lidhet me terma të tillë si, *“numri thelbësor dhe kërkesë e mjaftueshme”*, si dhe *“... mbi 20 % e numrit të përgjithshëm të popullsisë së kësaj bashkie”*. Kemi theksuar më herët se, dispozitat e këtij ligji krijojnë një lloj konfuzioni në këtë pikë pasi, shprehen për të drejtën e institucioneve publike në nivel qendror dhe vendor, për mbledhjen e të dhënave në lidhje me identifikimin e personave që u përkasin pakicave kombëtare (neni 7/1).

Një tjetër çështje që është konstatuar në këtë kontekst është fakti se, ndarja e re territoriale administrative ka krijuar problematikë, përse i takon pranisë reale të popullsisë së ndryshme nga ajo në mazhorancë, të vendosur në zona të caktuara të vendit. Sipas kësaj ndarjeje, në raste specifike rezultojnë se kufiri i ri territorial administrativ ndan në dy pjesë të veçanta komunitete, që i përkasin të njëjtit minoritet, por që pas kësaj nuk i përkasin më së njëjtës njësi territoriale administrative. Kjo gjendje faktike, kemi theksuar se do të krijojë probleme me zbatimin e dispozitave të ligjit, ku sanksionohet gëzimi dhe realizimi i disa të drejtave, të lidhura paraprakisht me plotësimin e termave *“numri thelbësor dhe kërkesë e mjaftueshme”*, si dhe *“mbi 20 % e numrit të përgjithshëm të popullsisë së kësaj bashkie”*. Kemi vlerësuar se këto problematika mbarteshin edhe në përmbajtjen e këtij projektvendimi.

Miratimi dhe hyrja në fuqi e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.561 datë 29.09.2018 “Për pajisjen me tekste shkollore të nxënësve, formimin fillestar, zhvillimin e mëtejshëm profesional të mësuesve, si dhe për krijimin e funksionimin e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare”, gjykojmë se mbart të njëjtat probleme të konstatuara më lart. Ndërkohë pavarësisht se është parashikuar edhe nxjerrja e një VKM-je, në përputhje me parashikimin e bërë në pikën 3, të nenit 13, të Ligjit nr.96/2017, rezulton se ky akt nënligjor ende nuk ka dalë, pavarësisht vërejtjeve dhe sugjerimeve që ne kemi dhënë për të dhe është vështirë të gjykohet mbi përputhshmërinë e nocioneve dhe kriterëve që do të përcaktohen prej tij, me ato të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.561 datë 29.09.2018.

- Projektvendimi “Për kriteret për përcaktimin e njësisë së vetqeverisjes vendore, numrit thelbësor dhe kërkesës së mjaftueshme të personave të pakicave kombëtare”.

Nisur nga përmbajtja e dispozitave të këtij projektvendimi kemi theksuar në qëndrimin tonë se, ekzistojnë dhe mbeten të hapura për diskutim çështjet e ngritura me sipër, për projektvendimin, “Për pajisjen me tekste shkollore të nxënësve, zhvillimin e mëtejshëm profesional të mësuesve, si dhe për krijimin e funksionimin e klasave mësimore në gjuhën e pakicave kombëtare”. Nisur nga problematika të shqyrtuara nga ana e Avokatit të Popullit ndër vite sa i takon pajisjes me tekste mësimore falas të nxënësve të pakicave kombëtare, kemi sugjeruar se do të ishte i nevojshëm parashikimi i teknikaliteteve për mënyrën e pajisjes me tekstet, kohën e aplikimit të kësaj lehtësie që iu krijohet këtyre nxënësve, etj.

- Projektvendimi, “Për përcaktimin e strategjive, programeve dhe planeve të veprimit për të krijuar kushtet e nevojshme që pakicat kombëtare të ruajnë dhe zhvillojnë identitetin e tyre të dallueshëm, në Republikën e Shqipërisë”. Edhe në këtë rast, pa dashur të përsërisim gjykimin tonë të njëjtë të përdorur në analizën për projektvendimin, “Për përcaktimin e masave dhe politikave të nevojshme për të siguruar pjesëmarrjen e pakicave kombëtare në jetën publike, kulturore, sociale dhe ekonomike të tyre, në Republikën e Shqipërisë”, më lart, kemi vlerësuar se edhe ky projekt vendim ka nevojë të ripunohet për ta nxjerrë atë nga karakteri deklarativ dhe për ta bërë atë më konkret dhe detyrues në zbatim.

- Projektvendimi, “Për përcaktimin e masave dhe politikave të nevojshme për të siguruar pjesëmarrjen e pakicave kombëtare në jetën publike, kulturore, sociale dhe ekonomike të tyre, në Republikën e Shqipërisë”. Nisur nga përmbajtja e dispozitave të këtij projekt vendimi, kemi theksuar se ai nuk i ka “shpëtuar” dot, karakterit deklarativ të dispozitave të Ligjit nr.96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”. Relacioni shoqërues i projekt vendimit, në fakt në objektivat e parapara të synuara me miratimin e këtij projektvendimi ka rezultuar më i qartë dhe konkret, se sa përmbajtja e vet projekt vendimit. Në këto rrethana, kemi shprehur mendimin se projekt vendimi ka nevojë të ripunohet për ta nxjerrë atë nga karakteri deklarativ dhe për ta bërë atë më konkret dhe detyrues në zbatim, si dhe për t’ju përmbajtur korrektësisht përmbajtjes detyruese të pikës 3, të nenit 11, të Ligjit nr.96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Në përfundim, pervec sa më sipër, është e nevojshme të përmendet si shqetësim konstatimi nga institucioni i Avokatit të Popullit i faktit të mos miratimit të akteve nënligjore (apo vonesave në miratimin e tyre) për disa akte ligjore të caktuara, mosmiratimi i të cilave pamundëson zbatimin konkret të legjislacionit në disa fusha të së drejtës.

4. Të rrisë angazhimin në ndjekjen e përmbushjes së objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, Agjenda 2030, me fokus të veçantë buxhetimin gjinor, mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, mbrojtjen e konsumatoreve, detyrime që burojnë nga legjislacioni në fuqi në fushat përkatëse dhe/ose rezolutat e miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë

Shqipëria tashmë ka përqafuar Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara, objektiva këto që duhet të bazohen mbi të drejtat e njeriut. Me këtë duhet të kuptojmë, që e gjithë puna jonë e përbashkët e institucioneve, e Parlamentit, e Pushtetit Vendor e biznesit, e shoqërisë civile, në të



ardhmen do të duhet të ketë për orientim, pikërisht këto objektiva, të cilat synojnë: Reduktimin e varfërisë, të pabarazisë dhe të përjashtimit social.

Duke qenë një Axford gjithëpërfshirëse që vendos prioritete në çështjet që ndikojnë tek njerëzimi në nivel global, me qëllim dhënien fund të varfërisë dhe urisë, sigurimin e qasjes në kujdesin shëndetësor, arsimin gjithëpërfshirës, aksesin në burime si ujë i pijshëm dhe energji elektrike, rritjen ekonomike dhe punësimin, shoqëri paqësore dhe gjithëpërfshirëse, etj, me aplikimin e saj universal dhe rëndësinë për formësimin e prioriteteve të zhvillimit, Axforda 2030 do të hapë shtigje të reja për integrimin e të drejtave të njeriut në politikat globale dhe kombëtare përgjatë 15 viteve të ardhshme.

Avokati i Popullit si një nga aktorët e angazhuar në mbrojtje dhe respektim të të drejtave të njeriut, të cilat përbëjnë edhe bazën e konceptimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, ka dhe duhet të luajë një rol specifik në procesin e zbatimit dhe monitorimit të Axfordës. Kjo, bazuar edhe në Deklaratën e Meridës “Mbi rolin e institucioneve të të drejtave të njeriut në Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm”, miratuar në muajin Tetor 2015 në Meksikë, në Konferencën e 12-të të Komitetit Ndërkombëtar Koordinues të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut, ku përcaktohet edhe roli dhe veprimet që duhet të ndërmarrin institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut për këtë proces.

Në këtë aspekt, edhe sfidat për punën e institucionit të Avokati i Popullit do të jenë të vazhdueshme dhe jo të lehta, duke pasur në konsideratë edhe kapacitetet e pakta të institucionit. Deri më sot, institucioni i Avokatit të Popullit patur një sërë angazhimesh dhe kontributesh për këtë nisëm mjaft të rëndësishme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Vlen të përmendet bashkëpunimi i vazhdueshme me Zyrën e Kombeve të Bashkuara në Tiranë, pjesëmarrja në trajnime të ndryshme që lidhen me OZHQ-të si dhe dhënia e kontributeve konkrete në hartimin e Raportit të treguesve të OZHQ 16.1 dhe 16.2.

Avokati i Popullit në mënyrë të vazhdueshme ka shprehur opinionet e tij mbi ndërhyrjet që i duhen bërë Buxhetit të Shtetit, duke reflektuar në to problemet dhe shqetësimet e qytetarëve, me argumentimin që buxheti i shtetit është një instrument i pazëvendësueshëm, kryesor, në realizimin e këtyre objektivave. Ai duhet të jetë shprehje dhe në vitet në vijim e këtij qëllimi të shtetit shqiptar për t’i realizuar ato.

Avokati i Popullit ka vlerësuar përgatitjen dhe prezantimin nga qeveria Shqiptare të Raportit Kombëtar Vullnetar, i cili u paraqit në Forumin Politik të Nivelit të Lartë të Kombeve të Bashkuara mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm, të zhvilluar në New York në korrik 2018, duke rekomanduar në të njëjtën kohë nevojën e përgatitjes dhe analizimit në mënyrë konkrete të kostove buxhetore që do të kërkonte zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SGD).

Gjithashtu, Avokati i Popullit mbështet fuqishëm Platformën “Për Integrimin, Përshejtimin dhe Mbështetjen e Politikave”(MAPS), miratuar nga Grupi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara. Raportet e prodhura nga kjo Platformë kanë ndihmuar qeveritë dhe partnerët e tjerë kombëtarë të identifikojnë hapat konkretë të politikave dhe programeve të nevojshme për të përshpejtuar tranzicionet kombëtare drejt zhvillimit të qëndrueshëm. Misioni i parë i tillë i MAPS në Ballkanin Perëndimor u realizua në Shqipëri, gjatë periudhës 16-20 Prill 2018, ku u zhvilluan takime edhe me përfaqësues të Avokatit të Popullit me qëllim identifikimin e mundësive dhe rolit që mund të luajë një institucion kombëtar i të drejtave të njeriut në monitorimin e zbatimit të objektivave të qëndrueshëm. Realizimi i këtij misioni prodhoi një raport i cili, ndërmjet të tjerash, tregon lidhjen e fortë ndërmjet Agjendës 2030 dhe SDG-ve nga njëra anë dhe axhendës së anëtarësimit në BE nga ana tjetër, duke theksuar se si zbatimin kombëtarin e Agjendës 2030 mund të përshpejtojë përparimin drejt pranimit në BE - duke ndihmuar gjithashtu Shqipërinë për të adresuar më mirë sfidat e rëndësishme të zhvillimit të cilat nuk janë qendrore për axhendën e pranimit në BE.

Bazë e rëndësishme në punën e institucionit të Avokatit të Popullit mbetet edhe Rezoluta e miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me datë 04.12.2017 ku mes të tjerash anëtarët e Kuvendit

angazhohen të nxisin bashkëpunimin me institucione të pavarura të llogaridhënies siç janë institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut (Avokati i Popullit).

Në këtë proces, pa dyshim që rol të rëndësishëm mbart edhe pushteti legjislativ. Për rrjedhojë, është e domosdoshme që ky organ të punojë së bashku me Qeverinë dhe të gjithë partnerët dhe grupet e interesit, për të rishikuar kuadrin ligjor ekzistues dhe identifikuar mundësitë për të çuar më tej zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, veçanërisht miratimin ose ndryshimin e ligjeve për të promovuar barazinë gjinore, përfshirjen sociale dhe mbrojtjen e mjedisit.

Mbetet shumë e rëndësishme, gjithashtu, që Kuvendi të ofrojë mbështetje për institucionet qeverisëse në nivel vendor për të zbatuar dhe monitoruar Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, duke pranuar se ato janë më afër me qytetarët dhe shpesh kanë përgjegjësi për çështje të rëndësishme në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Roli i Kuvendit mund të jetë shumë efektiv në sigurimin e zhvillimit dhe përdorimit të mjeteve për t'u mundësuar parlamentarëve të kryejnë një mbikëqyrje më efektive të ligjeve, të buxheteve, programeve dhe politikave të propozuara për të vlerësuar kontributin e tyre në zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Rritja e ndërgjegjësimit për arritjet e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm është një instrument për të garantuar suksesin në këtë proces. Përfshirja e të gjithë aktorëve (përfshirë dhe të rinjtë) përmes fushatave ndërgjegjësuese, zhvillimit të ditëve të hapura apo javës së objektivave të zhvillueshëm, do të do ndihmonte në njohjen më të mirë të këtyre objektivave si dhe në ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të tyre.

Nisur nga gjithë sa më sipër, sfidat për punën e institucionit të Avokati i Popullit mbeten, ndërmjet të tjerash, ngritja e mekanizmave për monitorimin dhe zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, forcimi i bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë për të mbështetur institucionet e të drejtave të njeriut në zhvillimin e mjeteve, metodologjisë dhe kapaciteteve për të monitoruar zbatimin Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm si dhe bashkëpunimi me institucione relevante që prodhojnë dhe grumbullojnë të dhëna statistikore përfshirë INSTAT, botën akademike dhe organizata të shoqërisë civile.

Vizioni i ardhshëm i Avokatit të Popullit, sikurse edhe vizioni i çdo aktori të përfshirë për realizimin e kësaj ambicie është që “askush të mos ngelet pas” dhe gjithkujt e kudo t'i realizohet dinjiteti njerëzor dhe t'i respektohen plotësisht të drejtat e tij. Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm janë tashmë pjesë e punës tonë të përditshme për monitorimin, parandalimin e cënimit të të drejtave të njeriut, si edhe promovimin e tyre.

5. *Në kuadër të funksionit si Mekanizëm për Parandalimin e Torturës, të jetë më proaktiv në lidhje me monitorimin e respektimit të të drejtave të personave të privuar nga liria, në komisariatet e policisë dhe vendet e ekzekutimit të vendimeve penale, në Qendrën e Trajtimit të të Huajve të Parregullt në Shqipëri dhe Qendrën e Azilkërkesve, pikat e ndalimit kufitar, si dhe pikat, të cilat shihen si të mundshme për të ndërtuar qendra të pritjes ose ndihmës për kalimin tranzit të personave në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare, si dhe të ndjeke zbatimin e rekomandimeve të adresuara.*

Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) monitoron të gjitha institucionet publike ku privohet liria e individit, me qëllim vlerësimin e nivelit të respektimit të drejtave të njeriut në këto institucione, parandalimin e shkeljeve, përmirësimin e standardeve të trajtimit të personave të privuar nga liria dhe promovimin e respektimit të vazhdueshëm të të drejtave të tyre.

Në vitin 2018, MKPT ka kryer një numër të konsiderueshëm inspektimesh nga të cilat **51 vizita** monitoruese të kryera në bazë të planit të miratuar të inspektimeve dhe ka kryer gjithashtu ri-inspektime, kontrole me tematikë të veçantë dhe hetime administrative, në të gjitha institucionet ku privohet apo mund të privohet liria e individit, përfshirë këtu institucionet penitenciare, njësitë policore, spitalet psikiatrike, qendrat ku trajtohen shtetasit e huaj, azilkërkuesit dhe viktimat e trafikut, si dhe pika të kalimit kufitar dhe mjediset ku parashikoheshin të ndërtoheshin kampet e trajtimit të përkohshëm të migrantëve dhe ka përgatitur rekomandime bazuar në gjetjet e inspektimeve dhe nga ankesat e marra sipas parashikimeve ligjore.

Problematikat kryesore në sistemin e burgjeve (IEVP), për vitin 2018 kanë qenë si më poshtë vijon:

- Mospërmbushja e detyrimeve ligjore dhe për të vënë në zbatim rekomandimet e vazhdueshme të Avokatit të Popullit, në krijimin e kushteve të përshtatshme infrastrukturore dhe në sigurimin e bazës materiale të nevojshme për të garantuar respektimin e të drejtave ligjore të paraburgosurve dhe të dënuarve në një numër të konsiderueshëm të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale.
- Mospërmbushja e detyrimeve ligjore (ligji nr. 44/2012, datë 08.05.2012 “Për Shëndetin Mendor”) për ngritjen e një Institucioni të Posaçëm Mjekësor, me qëllim trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor që kanë kryer vepra penale për të cilët gjykatat kanë marrë vendim për “mjekim të detyruar në një institucion mjekësor”.
- Mos funksionimi i sistemit të kujdesit shëndetësor në parametrat e duhur që përbën trajtim jo të mirë të cilin duhet ta përfitojnë personat e dënuar në këto institucione të vuajtjes së dënimit. Përkatesisht, organizimi i sistemit të kujdesit shëndetësor në këto institucione, ende nuk është standartizuar me implementimin e zgjidhjeve pozitive – juridike, dhe burimeve financiare dhe materiale, kurse numri i personelit të angazhuar mjekësor është i pa mjaftueshëm, dhe i pjesëshëm në kohë e në burime njerëzore që ti përgjigjet nevojave të personave të dënuar.
- Neglizhencë e pajustificuar nga ana e organeve gjyqësore në zbatimin e detyrimit ligjor të parashikuar në nenin 46, paragrafi i parafundit, të Kodit Penal, për të shqyrtuar kryesisht të gjitha vendimet e dhëna për “mjekim të detyruar në një institucion mjekësor” pas kalimit të afatit një vjeçar nga dita e dhënies së vendimit, si dhe dërgimin e vendimeve në institucionet ku trajtohen personat përkatës.

Sa më sipër është një shembull i punës së konsiderueshme që mbetet për t’u bërë nga administrata e burgjeve. Sigurisht që përmirësimet nuk mund të jenë të qëndrueshme, nëse problematikat nuk e gjejnë zgjidhjen që në filluesën e tyre. Mungesa e fondeve nuk është e justifikueshme për mos respektimin e të drejtave të njeriut. Planifikime të sakta bazuar në strategji të cilat mund të gjejnë zbatim janë të nevojshme për të ushtruar përgjegjësitë e parashikuara me ligj.

Nga ana tjetër MKPT ka vijuar të jetë në krye të përgjegjësisë të veta si për mbrojtjen ashtu edhe promovimin e të drejtave të personave të privuar nga liria dhe do të bashkëpunojë ngushtë me të gjithë aktorët për të promovuar standardet me të larta në të gjitha nivelet, kombëtare e ndërkombëtare.

Ndërkohë, problematikat në Drejtoritë Vendore të Policisë dhe në komisariatet në varësi të tyre kanë qenë si më poshtë vijon:

- Mbipopullim i ambienteve të sigurisë.
- Mospërmbushje e detyrimeve ligjore për ndërtimin apo përshtatjen e ambienteve të shoqërimit dhe/ose sigurisë sipas standardeve të përcaktuara në aktet nënligjore.
- Probleme me instalimin apo vënien në funksion të sistemit të monitorimit me kamera vëzhgimi në korridorët e dhomave të shoqërimit dhe të sigurisë.
- Plotësimi i regjistrave të evidentimit të personave të shoqëruar (në një pjesë të komisariateve) jo me saktësi dhe përgjegjësi.
- Zhvillimi i takimeve në dhomat e punës dhe jo në dhomat e intervistimit.

- Mosplotësim i stafëve mjekësore.

Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit në rolin e MKPT-së ka marrë pjesë në aktivitetet e Rrjetit të MKPT-ve të Evropës Juglindore, rrjet ky i jetësuar në vitin 2013 bazuar në Deklaratën e Bashkëpunimit të nënshkruar nga Institucionet e Ombudsmanëve/ Avokatëve të Popullit të Shqipërisë, Austrisë, Bullgarisë, Kroacisë, Maqedonisë, Malit të Zi, Sllovenisë, Serbisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Hungarisë, Greqisë dhe Rumanisë. Në përmbushje të qëllimit të këtij rrjeti të specifikuar edhe në OPCAT për rritjen e bashkëpunimit, shkëmbimin e eksperiencave dhe organizimin e aktiviteteve të tjera të përbashkëta për një realizim sa më të qenësishëm të mandatit të MKPT-ve në rajon, MKPT-ja shqiptare mori pjesë dhe kontribuoi në disa seminare dhe konferenca.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka bashkëpunuar ngushtësisht me Komitetin për Parandalimin e Torturës (CPT), duke qene dhe pjese takimeve që CPT-ja bëri në Tiranë, gjatë vizitës periodike në 20-30 nëntor 2018, në Nënkomitetin e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Torturës (SPT), Shoqatën për Parandalimin e Torturës (APT) për të siguruar një sistem cilësor mbikëqyrje e raportimi. Bashkëpunimet me këto struktura janë kryer në kuadër të takimeve të përbashkëta e kontakteve të drejtpërdrejta dhe kanë pasur për qëllim shkëmbimin e eksperiencave dhe vlerësimin e nevojave e mjeteve të nevojshme në luftën për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria në përmbushje të OPCAT-it.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, në realizim të funksioneve të tij ligjore, edhe gjatë vitit 2018 ka bashkëpunuar ngushtësisht me Organizatat e Shoqërisë Civile lokale aktive dhe të specializuara në këto fusha, si me Komitetin Shqiptar të Helsinkit, Qendrës Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës (ARCT) etj. Falë këtij bashkëpunimi, është arritur që të realizohen inspektime të përbashkëta, me karakter multidisiplinar dhe të thelluar si dhe janë zhvilluar auditoriume, konferenca e seminare me qëllim nxjerrjen në pah të problematikave të konstatuara në burgje e komisariate si dhe diskutimin e gjetjen e zgjidhjeve për to.

Ndërsa në dt 21 dhjetor 2018, në bashkëpunim me OSBE, Ministrinë e Drejtësisë dhe Qendrën Koordinuese kundër ekstremizmit të dhunshëm organizoi konferencën “ Respektimi i të drejtave të njeriut në kuadër të parandalimit dhe luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm në institucionet e privimit të lirisë dhe Shërbimin e Provës”.

Gjithashtu nën kujdesin e USAID si pjesë e projektit “ Transparenca në Sistemin Shëndetësor” është përgatitur nga ekspertët e MKPT-së me ekspertizën e Qendrës Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës një raport tematik “ Transparenca në sistemin e shëndetit mendor”

Në funksion të promovimit të të drejtave të njeriut në vend, si dhe parandalimit të shkeljeve, ekspertët e MKPT-së gjatë vitit 2018 kanë qenë aktive në median e shkruar dhe atë elektronike shqiptare, përmes takimeve të përbashkëta me gazetarët, intervistave, botimeve nëpër revista të ndryshme, me qëllim ndërgjegjësimin mbi problematikat dhe arritjet në fushën e të drejtave të njeriut për personat e privuar nga liria.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka qenë në vazhdimësi i angazhuar nën mandatin e vet në monitorimin e situatave dhe mbrojtjen e interesave të personave në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare që janë gjendur në territorin shqiptar.

Avokatit të Popullit ka mbajtur në vijimësi një qëndrim që ndonëse merr parasysh sfidat me të cilat haset Shqipëria në përballje me flukset migratore, nxit Qeverinë Shqiptare për më shumë transparencë dhe gatishmëri për bashkëpunim, me qëllim që nevojat e të gjithë atyre që kërkojnë azil në Shqipëri të plotësohen në mënyrën më të mirë të mundshme dhe trajtimi i atyre që nuk kërkojnë azil të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Gjatë këtyre përpjekjeve, theksi është vënë tek identifikimi më i mirë i të huajve të parregullt që kapen në territor, duke nxjerrë më qartësisht përmes zbatimit korrekt të

Procedurës së Përzgjedhjes së kush kategorizohet si azilkërkues (dhe referohet tek Drejtoria për Refugjatët), si migrant i paligjshëm apo si viktimë e trafikut të qenieve njerëzore (dhe referohet tek organet përkatëse që ndihmojnë në këtë fushë).

Avokatit të Popullit në rolin e MKPT-së është përfshirë gjerësisht në monitorimin e përmbushjes së detyrimeve të shtetit shqiptar ndaj të huajve të parregullt, azilkërkuesve dhe refugjatëve në Shqipëri, duke ndërmarrë një sërë nismash, përfshirë këtu inspektimet periodike në Qendrën e Mbyllur për Të Huajt e Parregullt-Kareç, në Qendrën e Azilkërkuesve- Babru, dhe në pikat e kalimit kufitar, me qëllim final ushtrimin e një presioni pozitiv dhe të vazhdueshëm ndaj autoriteteve përkatëse për përmbushjen e detyrimeve dhe standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Në këtë kuadër, është zgjeruar niveli i bashkëpunimit me UNHCR për vitin 2018, për të ndihmuar në forcimin e monitorimit të kufijve, nëpërmjet rekrutimit nga institucioni i Avokatit të Popullit të dy ekspertëve të jashtëm për monitorimin e zbatimit të procedurës së përzgjedhjes, si edhe të trajtimit të të huajve të parregullt në Shqipëri për pikat e kalimit kufitar në Kakavijë, Hani i Hotit dhe Muriqan, monitorim i cili do të vazhdojë edhe gjatë vitit 2019 duke e shtrirë edhe në pikën e kalimit kufitar në Kapshticë.

Gjatë monitorimeve është vërejtur se nevojitet përmirësim i mbrojtjes së të drejtave të migrantëve që hyjnë në territorin shqiptar përmes njohjes më të mirë të të drejtave prej tyre. Avokati i Popullit vëren se kërkohet rritje e përgjegjësisë së oficerëve të kufirit për respektimin e parimit të moskthimit dhe rritjen e cilësisë së intervistave të përzgjedhjes. Ka ende shumë faktorë që ndikojnë në cilësinë e intervistave dhe që lidhen që me:

- burimet e kufizuara njerëzore të personelit kufitar
- mungesën e kapaciteteve dhe mjediseve të veçanta
- mungesën e oficerëve gra për rastet e migrantëve femra
- numrin e kufizuar të përkthyesve në gjuhën arabe
- mungesën e shërbimit social nga bashkitë respektive
- nevojën për përmirësimin e skemës së trajtimit mjekësor në rastet e shfaqura në kufi, etj.
- rritjen e numrit të migrantëve që hyjnë në territorin shqiptar.

Për më shumë në lidhje me monitorimet dhe inspektimet e kryera si dhe problematikat e konstatuara nga MKPT-ja, referojuni Kreut 5, pika 5.4.

6. *Të përfundojë procedurat paraprake të përzgjedhjes së kandidatëve për Komisioner, për vendet vakante të krijuara në institucionin e Avokatit të Popullit brenda muajit shtator të vitit 2018.*

Në lidhje me përfundimin e procedurave paraprake të përzgjedhjes së kandidatëve për Komisioner, për vendet vakante të krijuara në institucionin e Avokatit të Popullit, siç dhe jeni të informuar ky proces ka përfunduar tashmë. Me konkretisht:

Në respekt të nenit 33/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, si dhe të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë ‘Për vlerësimin e veprimtarisë, së institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2017’, nëpërmjet thirrjes së hapur publike, gjatë muajit gusht 2018, institucioni i Avokatit të Popullit ka njoftuar procesin e përzgjedhjes së kandidaturave për tre vendet vakante për Komisioner respektivisht:

- *Komisioner në Seksionin e përgjithshëm;*
- *Komisioner në Seksionin për policinë, shërbimin sekret, burgjet, forcat e armatosura dhe pushtetin gjyqësor;*
- *Komisioner në Seksionin për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre;*

Brenda afatit të përcaktuar, u paraqitën 13 (trembëdhjetë) kandidatura të cilët u ftuan më datë **30.10.2018**, për të prezantuar platformën e tyre në seancën dëgjimore me Komisionin Ad-Hoc (një nga kandidatët nuk u paraqit në seancën dëgjimore). Në përbërje të këtij komisioni ishin përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, që veprojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, si dhe përfaqësues të institucionit të Avokatit të Popullit.

Kjo seancë dëgjimore ishte e hapur dhe u zhvillua në ambjentet e institucionit të Avokatit të Popullit ku kandidatët pjesëmarrës u vlerësuan në bazë të kushteve ligjore dhe kriterëve objektive.

- a. **vlerësimin e jetëshkrimit** të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën;
- b. **vlerësimin e platformës** (prezantimi i kandidaturës, problematikat e fushës ku aplikohet, çështjet që duhet të trajtohen me përparësi, mënyrën e manaxhimit dhe drejtimit të seksionit;
- c. **vlerësimin e veprimtarisë** në mbrojtjen dhe nxitjen e respektimit të të drejtave dhelirive të shtetasve;
- d. **intervistën e strukturuar me gojë** (vlerësimin e jetëshkrimit, të njohurive, integritetit, figurës, aftësive dhe formimit të kandidatëve).

Në zbatim të nenit 33/1, pika 6, të ligjit të nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, në të cilin theksohet se: “Lista me katër kandidatët e përzgjedhur nga Avokati i Popullit për çdo vend vakant, së bashku me vlerësimin e tij për përmbushjen e kushteve ligjore dhe kriterëve objektive dhe renditjen e kandidaturave sipas preferencës së tij, i kalon komisionit të Kuvendit që mbulon çështjet ligjore.....”, Avokati i Popullit në përfundim të këtij procesi vendosi t’i propozojë Kuvendit të Shqipërisë (shkresa nr.311/1, datë 15.11.2018) kandidaturat që plotësonin kushtet ligjore dhe kriteret objektive për pozicionin Komisioner në Seksionin e Përgjithshëm dhe Seksionin për Policinë, Shërbimin Sekret, Burgjet, Forcat e Armatosura dhe Pushtetin Gjyqësor.

Kandidaturat në pozicionin Komisioner në Seksionin për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre, nuk u dërguan pasi institucioni i Avokatit të Popullit ndodhej në pritje të përgjigjes verifikuese nga Autoriteti për Informim mbi dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, për një nga kandidaturat, e cila plotësonte deri në atë moment kushtet ligjore.

Në vijim të procedurës së procesit të përzgjedhjes së kandidaturave për vendin vakant për Komisioner në Seksionin për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre, pasi u plotësua dokumentacioni përkatës me ardhjen e informacionit nga Autoriteti për Informim mbi dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, Avokati i Popullit vendos që t’i propozojë Kuvendit të Shqipërisë (shkresa nr.311/14, datë 26.11.2018) listën e kandidaturave që plotësonin kushtet ligjore dhe kriteret objektive edhe për pozicionin Komisioner në Seksionin për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre.

7. *Të bëjë të mundur ngritjen e një sistemi online të menaxhimit të ankesave, në mënyrë që të përpunohen të dhënat në kohë reale si edhe të rritet cilësia dhe shpejtësia e hetimit nga komisionerët dhe ndihmëskomisionerët e AP*

Në institucionin e Avokatit të Popullit, me mbështetjen e qeverisë së Mbretërisë së Danimarkës, është instaluar dhe funksionon që nga viti 2002 sistemi Doculive, cili ka të bëjë me menaxhimin dhe trajtimin e rasteve dhe ankesave që paraqiten pranë institucionit të Avokatit të Popullit. Ky sistem ndihmon shumë në punën e përditshme të trajtimit të ankesave të qytetarëve, pa pasur nevojë për dosjen në hard copy. Gjithashtu, nëpërmjet këtij sistemi mund të nxirren statistika të ndryshme në lidhje me të drejtat e shkelura të qytetarëve si dhe për institucionet përgjegjëse për mosrespektimin e këtyre të drejtave, etj.

Duke qene se ky sistem të dhenash ka nevojë që të përmirësohet, me qëllim trajtimin dhe ndjekjen në mënyrë më eficiente të rasteve/ankesave, institucioni i Avokatit të Popullit është përpjekur të vlerësojë mundësitë e zëvendësimit të këtij database me një sistem më të avancuar. Në diskutimet që janë zhvilluar me Ombudsmanin danez, jemi informuar me sistemin e ri doculive që perdoret nga ky institucion, sistem i cili do të ishte i përshtatshëm edhe për menaxhimin e rasteve dhe ankesave për institucionin tonë. Duke qenë se kostoja e blerjes dhe instalimit të këtij sistemi (30-40 mije euro) shkon përtej mundësive buxhetore të institucionit, ka qenë e pamundur deri më sot zëvendësimi i sistemit online ekzistues të trajtimit dhe ndjekjes së ankesave.

Gjithsesi, me qëllim rritjen e aksesit të qytetareve, është mundësuar funksionimi për publikun i aplikacionin “Avokati i Popullit” për telefonat inteligjentë me të njëjtin emër. Aplikacioni ka për qëllim të ofrojë një platformë shtesë për marrjen e ankesave nga qytetarët lidhur me shkeljen e të drejtave të njeriut dhe raportimin e korrupsionit, duke përmirësuar vazhdimisht procesin e brendshëm të trajtimit të ankesave në mënyrë që qytetarët të marrin përgjigje profesionale dhe në kohë.

Aplikacioni do të jetë veçanërisht i dobishëm për qytetarët që jetojnë jashtë Tiranës dhe ata që nuk zotërojnë një kompjuter. Këta qytetarë do të kenë mundësi të dërgojnë ankesa lehtësisht nëpërmjet telefonit të tyre celular dhe të ndjekin ecurinë e ankesës së tyre. Aplikacioni u bë i mundur falë mbështetjes së Agjensisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar USAID nëpërmjet projektit “Transparenca në Sistemin shëndetësor” nisur në vitin 2017.

Institucioni i Avokatit të Popullit po zhvillon procesin e organizimit të një fushate informimi rreth aplikacionit në të gjithë vendin për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve për përdorimin e tij në dërgimin e ankesave.

8. *Të bëjë një vlerësim të brendshëm të organizimit dhe funksionimit të institucionit, në përputhje me rekomandimin nr.2 të përditësuar të Komisionit Europian kunder racizmit dhe intolerancës (ECRI) lidhur me “Organet e barazisë” dhe të paraqesë një raport të gjetjeve pranë Nënkomisionit për të drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë.*

Në lidhje me rekomandimin për një vlerësim të brendshëm të organizimit dhe funksionit të institucionit në përputhje me rekomandimin nr.2 të përditësuar të Komisionit Europian kundër racizmit dhe intolerancës (ECRI), duhet të theksohet fillimisht se ky rekomandim lidhet me organet e barazisë (equality bodies), pra për organet e krijuara me një mandat të qartë për të luftuar racizmin, intolerancën dhe diskriminimin.

Përsa i përket arkitekture institucionale, në varesi të traditave ligjore dhe administrative të shteteve anetare, organet e barazisë mund të marrin forma të ndryshme. Në disa shtete, një organ i barazisë është krijuar me mandatin për të mbuluar fusha të shumta; në disa shtete të tjera janë krijuar disa organe barazie me mandatin për të mbuluar një ose disa fusha. Ekzistojnë edhe praktika të tjera ku mandati i barazisë i është atribuar një institucioni me mandat të gjerë që përfshin gjithashtu një mandat për të drejtat e njeriut dhe/se mandatin e një Ombudsmani. Gjithashtu, ka vende të tjera anetare ku organet e barazisë me një mandat të vetëm apo të gjerë janë të shkrirë brenda institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut (Ombudsmanit).

Duke ndjekur këtë llogjike, rekomandimi i mësipërm i ECRI-t shkon drejt qasjes së përcaktimit të standarteve që duhet të kenë organet e barazisë sa i përket ngritjes, funksionimit, kompetencave, pavarësisë dhe aksesueshmërisë. Gjithashtu, ndërmjet të tjerash, ky rekomandim kërkon që organet e barazisë të koordinojnë dhe të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin (nëse ekziston më tepër se një strukturë e tillë) si dhe me institucionet e tjera të të drejtave të njeriut, përfshirë institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut/Ombudsmanin. Ky bashkëpunim është i nevojshëm me synimin për të maksimizuar impaktin e tyre të përgjithshëm në lidhje me mandatin e barazisë. Ato duhet të sigurojnë, gjithashtu,

arritjen e një mbulimi sa më të gjerë të çështjeve të barazisë, adresimin e çështjeve të ndërlidhura, si dhe shmangjen e përpjekjeve/veprimeve të dyfishta. Ky koordinim dhe bashkëpunim përfshin dialogun në procesin e planifikimit të tyre, iniciativa të përbashkëta në punën e tyre si dhe një komunikim të vazhdueshëm e të qendrueshëm.

Për tu kthyer në terrenin shqiptar, duhet të theksohet se neni 2 i ligjit nr.8454, date 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, përcakton se "... Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat legjitime të individit nga veprimet e paligjshme dhe të parregullta ose mosveprimet e organeve të administratës publike si dhe të tretëve që vepronjë për llogari të saj".

Në mënyrë efektive, juridiksioni i posaçëm i përcaktuar në ligjin për Avokatin e Popullit përcakton mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave legjitime të individit. Në këtë kufi të gjerë përkufizimi, logjika e ligjit organik natyrisht përfshin të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi, që përfshin parimi kushtetues i barazisë së qytetarëve para ligjit.

Ndërkohë, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 10221, datë 4.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", u krijua institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (Organ barazie), ligji i të cilit përcakton si objekt kryesor të veprimtarisë së tij, dispozita të mbrojtjes efektive kundër diskriminimit për secilin individ, si dhe mbrojtjen e tyre nga çdo formë sjelljeje që promovon diskriminimin (neni 21/1).

Nga një interpretim i ngushtë i dispozitave ligjore mund të thuhet se pavarësisht kompetencës më të gjerë të Avokatit të Popullit në mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, duke specifikuar kompetencën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për të siguruar mbrojtje efektive kundër diskriminimit për çdo individ, kjo çon në faktin se kjo kompetencë i përket së pari Komisionerit si organ barazie dhe jo Avokatit të Popullit.

Në një interpretim të gjerë të dispozitave ligjore mund të thuhet se ndërkohë që ligji organik i Avokatit të Popullit përfshin si kompetencë të përgjithshme të drejtën për mbrojtje nga diskriminimi dhe barazinë para ligjit, për rrjedhojë nuk ka asnjë pengesë ligjore për këtë të fundit që të trajtojë këto çështje. Këtij argumenti i shtohet fakti që në konkurrencën e mundshme të normave që përcaktojnë kompetencat dhe juridiksionin e institucioneve të lartpërmendura, ligji organik i Avokatit të Popullit është një akt normativ *më i lartë* se sa ligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi", pasi është miratuar me shumicë të cilësuar (tre të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit), ndërsa ligji "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" është miratuar me shumicë të thjeshtë.

Në këto kushte ne kemi qenë shumë të kujdesshëm që në trajtimin e çështjeve, të përjashtojmë ato raste ku apriori flitet për diskriminim, duke adresuar vetëm çështjet ku ngrihen pretendime për shkelje të të drejtave të tjera të njeriut. Kjo nuk na ka penguar të ndërhyjmë me rekomandime në lidhje me ndryshimin apo përmirësimin e legjislacionit me objekt mbrojtjen nga diskriminimi.

Pra, ekziston në mënyrë efektive një ndarje e punës midis dy institucioneve, të Avokatit të Popullit dhe atij të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për shkaqe që janë nën mandatin e ECRI (Komisioni Europian kundër Racizmit dhe Intolerancës). Kjo ndarje nuk është në vetvete një çështje e përcaktuar mirë brenda ligjit, por është një çështje e praktikës së mirë, e krijuar ndërmjet këtyre dy institucioneve dhe e formalizuar nëpërmjet një Memorandumi Bashkëpunimi të nënshkruar ndërmjet palëve më datë 28.05.2018, në respekt edhe të dispozitave të rekomandimit në fjalë. Objekti i këtij memorandumi është institucionalizimi i marrëdhënieve midis palëve me qëllim zgjidhjen e konfliktit të konkurimit të kompetencave, që mund të ekzistojnë ndërmjet Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për shkak të përmbajtjes së ligjeve të cilat rregullojnë veprimtarinë e tyre në kuadër të garantimit të të drejtave dhe lirive të njeriut.



Një tjetër moment i rëndësishëm që duhet mbajtur parasysh është se juridiksioni i Avokatit të Popullit përfshin **vetëm sferën publike**, sikurse dhe për aq sa përcakton Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë, në lidhje me termin “Organe publike – Administratë Publike” dhe se natyra e akteve të tij është rekomanduese dhe politikbërëse në tërësi. Ndërkohë juridiksioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi përfshin jo vetëm sferën publike por edhe atë private, dhe natyra e akteve të lëshuara prej tij nuk është vetëm rekomanduese (ka të drejtën e sanksionimit me gjobë). Duket se këto mund të kenë qenë elementët që janë marrë në konsideratë në momentin në të cilin është vendosur modeli i funksionimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili është një institucion i krijuar më vonë se insitucioni i Avokatit të Popullit). Nga sa më sipër jemi të mendimit se ky model e ka përforcuar mbrojtjen e të drejtave të shtetasve edhe për faktin e thjeshtë të rritjes së kapaciteteve, gjë e cila mund të mos kishte ndodhur, nëse mbrojtja tërësore do të kryhej nga një institucion i vetëm. Në çdo rast modeli aktual duket që po funksionon dhe të dy insitucionet kanë ndërmarrë nisma për të përdorur burimet e përbashkëta njerëzore në zyrat e tyre rajonale.

#### **KREU 4**

### **Vlerësim i situatës së respektimit të të drejtave të njeriut nga organet shtetërore**

#### **4.1 Të drejtat e personave të privuar nga liria**

##### *Shqyrtimi i rasteve individuale*

Gjatë vitit 2018 janë paraqitur gjithsej 308 ankesa individuale që lidhen me të drejtat e të burgosurve, nga të cilat 264 janë mbyllur dhe 44 janë ende në shqyrtim. Nga rastet e mbyllura 150 kanë rezultuar të pabazuara në ligj, 100 janë zgjidhur në favor të ankuesit gjatë shqyrtimit, 13 kanë rezultuar jashtë kompetence dhe 1 ka përfunduar me rekomandim drejtuar organit të prokurorisë. Gjithashtu ka vijuar hetimi për ankesat e mbartura nga vitet e kaluara.

Ankesat e marra në shqyrtim janë paraqitur si nga të burgosurit ashtu dhe nga familjarë të tyre. Numri më i madh i ankesave (siç ka ndodhur dhe me raportimin e vitit të kaluar) ka të bëjë me: cilësinë e shërbimit shëndetësor; refuzimin e kërkesës për të përfituar leje shpërblyese; zvarritjen e procedurës për të shkuar me leje shpërblyese; zvarritjen e procedurës për t’u transferuar në një I EVP tjetër; transferimin e padrejtë në një I EVP tjetër; pretendimet për ushtrim dhune fizike, psikologjike dhe keqtrajtim; dhënia e padrejtë e masës disiplinore.

##### *Problematikat që dalin nga shqyrtimi ankesave*

Ankesat që kanë të bëjnë me cilësinë e shërbimit shëndetësor vazhdojnë të jenë të shumta në numër. Gjykojmë se mbipopullimi (pamvarësisht përmirësimeve në këtë drejtim) ka bërë që administrata e burgjeve të mos i përgjigjet në kohë dhe me cilësi kërkesave të të burgosurve për trajtim mjekësorë. Gjithashtu në disa I EVP është konstatuar mungesë e mjekut, pavarësisht se në organikë parashikohet të ketë një të tillë, pasi ky vend pune nuk është i pëlqyer. Disa mjekë që fillojnë detyrën në I EVP, pas një farë kohe japin dorëheqjen.

Të burgosurit duhet të vuajnë dënimin në një institucion sa më afër vendbanimit të familjes. Ky është një nga kriteret kryesore ligjore për përcaktimin e I EVP-së ku i burgosuri duhet të vuajë dënimin. Nga hetimi i rasteve kur është pretenduar se po zvarritej procedura për të dërguar të burgosurin në një I EVP më afër vendbanimit të familjes, ka rezultuar se shkak i vonës ka qenë mbipopullimi në I EVP e tjera. Hapja e I EVP Malësi e Madhe (Reç) ka bërë që të plotësohen disa nga kërkesat e të burgosurve për të vuajtur dënimin në një I EVP afër vendbanimit të familjes. Në rastet kur nga të burgosurit është pretenduar transferim i padrejtë, DPBurgjeve na ka kthyer përgjigje se arsyeja e transferimit të të burgosurit në një I EVP larg vendbanimit të familjes ka qenë siguria e tij për shkak të konflikteve me të burgosur të tjerë apo cënimi i rendit në I EVP. Nga ana jonë është e vështirë të provohet nëse me të vërtetë arsyeja e transferimit ka qenë siguria e të burgosurit apo ndëshkimi i tij për shkak të sjelljes në

institucion. Megjithatë është kryer një punë hetimore lidhur me bazueshmërinë e informacionit të përpiluar për të motivuar transferimin. Nga hetimi që kemi kryer lidhur me transferimin e disa të burgosurve nga I EVP Lezhë në I EVP të tjera, kemi arritur në përfundimin se arsyeja e transferimeve nuk ishte e bazuar. Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve i është rekomanduar transferimi i të burgosurve në një I EVP më afër vendbanimit të familjes.

Refuzimi i kërkesës për leje shpërblyese ka qenë objekt i disa ankesave të shqyrtuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Në rastet e ankesave të të dënuarve për leje shpërblyese dhe leje të veçantë, Institucioni i Avokatit të Popullit nuk mund të ndërhyjë për të dhënë ose jo leje, por vetëm për të verifikuar procedurën e shqyrtimit të këtyre kërkesave. Nga hetimi i këtyre rasteve ka rezultuar se, arsyeja e refuzimit të tyre ka qenë mungesa e besueshmërisë lidhur me qëndrimin e të dënuarit jashtë institucionit. Institucioni nuk ka patur garanci nëse jeta dhe shëndeti i të dënuarit nuk do të çenohej gjatë lejes ose i dënuari mund të cënonte jetën dhe shëndetin e të tjerëve. Institucioni i Avokatit të Popullit nuk mund të verifikojë informacionin që përfitohet në rrugë operative apo konfidenciale. Gjithsesi vlerësimi i dhënë për këto raste ka një dozë të shtuar subjektiviteti.

Në lidhje me shpërblimin e punës të të burgosurve, siç kemi informuar edhe më parë, që më datë 04.03.2013 i është dërguar rekomandim Ministrisë së Drejtësisë, ku është kërkuar hartimi i projekt vkm-së për përcaktimin e kritereve të shpërblimit të punës të të burgosurve dhe dërgimin e tij sa më parë për miratim në Këshillin e Ministrave. Ky rekomandim nuk është zbatuar dhe puna e të burgosurve vazhdon të mospaguhet.

Burgjet nuk janë vendi i duhur për të burgosurit me probleme të shëndetit mendor. Akoma nuk është gjetur një zgjidhje përfundimtare për strehimin në një ambient spitalor jashtë sistemit të burgjeve të personave që kanë marrë masë nga gjykata për mjekim të detyruar. Që në vitin 2012, Avokati i Popullit i ka dërguar një rekomandim Ministrisë së Drejtësisë, ku është kërkuar hapja e një institucioni të ri mjekësor për sistemimin e personave me probleme të shëndetit mendor, për të cilët gjykata ka dhënë masë mjeksore “mjekim të detyruar”. Ky rekomandim nuk ka gjetur zgjidhje. Në përgjigjen e fundit që kemi marrë nga DPB jemi vënë në dijeni se, po përshtaten dy godina në I EVP Lezhë për të vendosur aty të burgosurit me probleme të shëndetit mendor që mbahen aktualisht në I EVP Krujë. Në përfundim të rikostruksionit, këto mjedise do të funksionojnë si institucion i posaçëm mjekësor dhe do të kalojnë në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë.

Ankesat për keqtrajtim, ushtrim dhune fizike dhe psikologjike nga punonjës të Policisë së Shtetit dhe të Burgjeve janë shqyrtuar me përparësi nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Pretendimet për ushtrim dhune, veçanërisht të dhunës psikologjike, nuk janë të lehta për tu provuar. Gjatë vitit 2018 janë regjistruar 23 ankesa të tilla. Në një rast kemi arritur të provojmë se, disa punonjës të policisë së I EVP Fushë-Krujë, gjatë veprimeve të tyre aktive për të neutralizuar një të dënuar me sjellje të dhunshme, kishin humbur vetëkontrollin duke e tejkalluar minimumin e mundshëm të përdorimit të forcës dhe duke shkelur parimin e proporcionalitetit, sepse intensiteti i forcës kishte qenë më i madh se sa intensiteti i rezistencës së të dënuarit. Për shkak të këtij intensiteti, i dënuari kishte pësuar dëmtime në pjesë të ndryshme të trupit. Në përfundim të hetimit administrativ të këtij rasti arritëm në konkluzionin se, nga punonjësit e Policisë së Burgjeve të I EVP Fushë-Krujë ishin konsumuar elementët e veprës penale të “kryerjes së veprimeve arbitrare”. Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Krujë, iu rekomandua fillimi i hetimeve ndaj punonjësve përgjegjës. Organi i prokurorisë na ka informuar se për këtë rast ka filluar procedimin penal.

Vetvrasjet në burgje janë ngjarje që shpesh kalojnë pa shumë bujë. Institucioni i Avokatit të Popullit, i vënë në dijeni nga media, ka nisur me inisiativë hetimin e rasteve të vetvrasjeve në burgje për të kuptuar nëse këto ngjarje mund të parandaloheshin. Në përfundim të hetimit të një vetvrasje të ndodhur në fund të vitit 2017 në I EVP Lezhë, i kemi rekomanduar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe I EVP Lezhë marrjen e masave për parandalimin e vetvrasjeve. Mungesat në organikën e personelit

shëndetësor dhe social ndikojnë në cilësinë e shërbimit që ofrojnë këto dy sektorë. Rrjedhimisht zvogëlohet edhe mundësia për të parandaluar rastet e vetvrasjeve. Të dënuarit shfrytëzojnë shpesh mundësitë që krijon infrastruktura e amortizuar ose jo e ndërtuar sipas standarteve për të kryer aktin e vetvarjes. Vlerësojmë se rritja e cilësisë së shërbimeve psikosociale do të mundësojë parandalimin e kësaj problematike.

Në datën 18.10.2018, Ministria e Drejtësisë ka depozituar në Kuvend projektligjin, “Për një shtesë në ligjin nr.8328, datë 16.4.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve”, të ndryshuar, i cili do të sjellë ndryshime në të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve që akuzohen apo janë dënuar për vepra penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore. Këto të burgosur do të nënshtrohen një regjimi të posaçëm sipas të cilit veprimet e tyre do të kufizohen më shumë se sa ato të të burgosurve të tjerë. Shqetësimi i vetëm që mbetet për ne është, nëse IEVP-ët në Shqipëri kanë llogjistikën e duhur për ta bërë të zbatueshme regjimin e posaçëm duke ruajtur një ekuilibër midis sigurisë dhe dinjitetit të të burgosurve. Mbetet për tu parë nëse zbatimi i regjimit të posaçëm do të lejojë një nivel minimal të pranueshëm kontakti për të burgosurit dhe nëse aktivitetet sociale, kulturore dhe krijuese do të jenë të mjaftueshme për të mos u konsideruar trajtim johuman dhe degradues në kuptim të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Një problematikë tjetër e ngritur në vazhdimësi është dhe çështja e personelit të burgjeve. Siç kemi raportuar dhe më parë, rekomandimet e dërguara për respektimin e të drejtave të punonjësve të policisë së burgjeve janë pranuar por, nuk po gjejnë zbatim me arsyetimin se nuk ka fonde të mjaftueshme. Në vitin 2018 i jemi rikthyer sërish të drejtave financiare të punonjësve të policisë së burgjeve. Në përfundim të hetimit të ankesave të efektivëve të IEVP “Ali Demi”, i rekomanduam Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave dhe DPB: kompesimin e orëve shtesë të punës të kryer gjatë pushimit javor ose në ditët e festive zyrtare; zbatimin e Kodit të Punës për sa i përket orëve maksimale shtesë që mund të kryhen; pajisjen me uniformë; trajtimin e barabartë ekonomiko-financiarë të punonjësve të policisë së Burgjeve me punonjësit e Policisë së Shtetit; ndryshimin e VKM nr.201, dt. 15.03.2017, për të formuluar më qartë rregullat e llogaritjes së shtesës për vjetërsi në punë; rritjen e numrit të punonjësve të Policisë së Burgjeve; zgjidhjen e problemit të transportit nga vendbanimi në qendrën e punës dhe anasjelltas.

Në përfundim, vlen të theksohet se rehabilitimi i të burgosurve është funksioni kryesor i burgjeve. Personat e privuar nga liria duhet të inkurajohen të punësohen duke u shpërblyer në para për punën e kryer. Nëpërmjet programeve dhe shërbimeve ata duhet të ndihmohen të zgjidhin problemet e tyre si, varësia nga përdorimi i substancave narkotike dhe sjellja e dhunshme. Gjithashtu, duhet gjetur një zgjidhje përfundimtare për strehimin në një ambient spitalor jashtë sistemit të burgjeve të burgosurve me probleme të shëndetit mendor. Funksioni rehabilitues i burgjeve është bërë një sfidë më e vështirë me rritjen e popullsisë në burgje dhe buxhetin e pamjaftueshëm. Masa e sigurisë “arrest me burg” dhe dënimi me burg duhet të zgjidhen si alternativë e fundit në sigurimin dhe ndëshkimin e personave që kryejnë vepra penale me rrezikshmëri të vogël. Trajtimi i punonjësve të burgjeve kërkon vëmendjen e institucioneve shtetërore për ti siguruar atyre kushtet e pune, pagesë dhe kompesim ekonomik të përshtatëshme me vështirësinë që paraqet puna në burgje.

Sa më sipër, mbetet shumë e rëndësishme që institucionet përgjegjëse të marrin masat e nevojshme për të adresuar problematikat e përmendura më sipër, në respekt edhe të Rregullave dhe Standarteve Minimale të Trajtitimit të të Burgosurve (**The Mandela Rules**), të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 20 dhjetor 2015.

#### **4.2 Respektimi i të drejtave të njeriut nga organet e Policisë së Shtetit**

Gjatë vitit 2018 në institucionin e Avokatit të Popullit janë administruar 146 ankesa, ndaj Ministrisë së Brendshme dhe organeve të Policisë së Shtetit. Konstatojmë se numri i ankesave ndaj këtyre organeve

*në vitin 2018 është më i madh se sa numri i ankesave të administruara në vitin 2017 që ishte 91. Objekt i ankesave të qytetarëve kanë qënë pretendime për shkelje të të drejtave të tyre ligjore nga strukturat ose punonjësit e Ministrisë së Brendshme dhe të Policisë së Shtetit.*

Objekti i ankesave ka qënë i larmishëm sikurse mund të përmendim: për keqtrajtme fizike ose psikologjike në momentet e arrestimit, të shoqërimit apo gjatë marrjes në pyetje në organet e policisë; për trajtim jo human e dinjitoz në mjediset e organeve të policisë ku mbahen, ruhen dhe trajtohen të shoqëruarit ose të arrestuarit/ndaluarit; për shoqërime të paligjshme; për mos marrje, mos administrim ose mos ndjekje të kallëzimeve apo ankesave të bëra prej tyre; për pengim të ushtrimit të të drejtës kushtetuese të tubimeve; për vendosje të masave administrative të padrejta; për mos mbajtje dhe mos dhënie të procesverbaleve për veprimet e kryera nga punonjësit e policisë; për bllokim sendesh personale; për sigurimin e jetës; për pengim të daljes lirisht jashtë shtetit; për mos dhënie informacioni; për dhënie të përgjigjeve negative ndaj të dënuarve të cilët kanë kërkuar përfitimin e të drejtës për leje shpërblyese; për shkelje të të drejtave të shtetasve të huaj në Shqipëri; për cënim të marrëdhënieve të punës dhe për transferime të padrejta nga Policia e Shtetit, etj.

Nga shqyrtimi i ankesave të administruara ka rezultuar se disa prej tyre kanë qënë të bazuara dhe konkretisht për ushtrim dhune fizike, për pengim të ushtrimit të të drejtës për tubim, për cënim të marrëdhënieve të punës, etj. Duhet të mbajmë në konsideratë faktin se, shkeljet dhe cënimet e të drejtave kushtetuese e ligjore të shtetasve të kryera nëpërmjet veprimeve ose mos veprimeve të punonjësve apo strukturave të caktuara të Ministrisë së Brendshme dhe të Policisë së Shtetit ndikojnë drejtpërdrejtë në cënimin e imazhit të këtyre organeve në publik dhe për rrjedhojë çënojnë rëndë besimin e publikut tek ato.

Për rastet për të cilat janë konstatuar shkelje të të drejtave të qytetarëve, nga institucioni i Avokatit të Popullit janë bërë rekomandimet përkatëse drejtuar organeve kompetente për marrjen e masave të nevojshme penale, administrative dhe organizative me qëllim rivendosjen në vend e të drejtave të shkelura qytetarëve, ndëshkimin e shkelësve të ligjit dhe përgjithësimin e tyre me qëllim mos përsëritjen në të ardhmen.

#### *E drejta e shtetasve për të mos iu cënuar integriteti fizik dhe trajtuar me dinjitet*

Në institucionin e Avokatit të Popullit janë administruar disa ankesa të bëra nga shtetas të ndryshëm të cilët pretendonin për sjellje jo korrekte të punonjësve të policisë në rastet e kapjes së persona në kërkim si autorë të dyshuar të veprave penale, kur kanë shkelur rregullat e parashikuara në dispozitat e Kodit Rrugor, apo gjatë kontrolleve rutinë që bëjnë policia në lokale, mjedise të tjera dhe në rrugë. Në vend që punonjësit e policisë të sillen me korrektesë dhe etikë, i fyejnë dhe dhunojnë ata, apo ushtrojnë forcë fizike dhe i lidhin me pranga pa qënë nevoja. Sikur të mos mjaftonin vetëm këto, dhe me qëllim justifikimit dhe mbulimit të veprimeve të kundërligjshme, punonjësit e policisë bëjnë kallzime dhe i arrestojnë ata për veprat penale të “Kundërshtimit të punonjësit të policisë së rendit” dhe atë të “Goditjes së punonjësit të policisë”. Pas arrestimit, kur dërgohen në gjykatën përkatëse për vleftësim dhe caktim të masës së sigurimit, duke mos pasur prova për pafajësinë e tyre, gjykata i vlerëson të ligjshëm arrestimet në flagrancë dhe ndërkohë ka caktuar masën e sigurimit personal “arrest në burg”.

Në një rast, pas kryerjes së hetimeve administrative dhe marrjes së deklarimeve të dy dëshmitarëve të pranishëm shtetasve A. C. dhe L. F., është mundësuar që të provohet se arrestimi i shtetasit D.D. ishte bërë në mënyrë të kundërligjshme, sepse ai nuk kishte kryer asnjërin nga veprat penale për të cilat ishte arrestuar nga policia dhe nuk kishte kundërshtuar apo goditur punonjësit e policisë. Arrestimi i D.D. ishte bërë për arsye të justifikimit të dhunës së ushtruar ndaj tij nga punonjësit e policisë të strukturës operacionale të Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë.

Ndërkohë nga verifikimet e bëra rezultoi se ankuesi kishte bërë kallëzim në Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat Tiranë. Nga punonjësit e SHÇBA-së kallëzimi i bërë nga ankuesi dhe materialet e tjera procedurale i ishin referuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Tiranë. Kjo e fundit kishte regjistruar procedimin penal nr. 3120, datë 20.04.2018 për veprën penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”, parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal. Pas fillimit të procedimit penal, prokurori i çështjes e kishte deleguar atë për kryerjen e hetimeve në Drejtorinë e SHÇBA-së Tiranë. Më vonë, në datën 18.05.2018, prokurori i çështjes kishte vendosur bashkimin e procedimit penal nr. 2927 të vitit 2018 për veprën penale të “Kundërshtimit të punonjësit të policisë së rendit” me procedimin penal nr. 3120, datë 20.04.2018, për veprën penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare” dhe hetimin e tyre në një procedim të vetëm.

Bazuar në deklaratimet e dëshmitarëve të pranishëm në këtë ngjarje, në faktin që i arrestuari D. D. natën e ndodhjes së kësaj ngjarjeje nuk kishte përdorur pije alkoolike dhe ishte një person me përmasa dhe peshë trupore të imta, si dhe numrit të madh të punonjësve të policisë rreth 10 persona, gjykuam se ai nuk ka pasur arsye për të kryer veprat penale për të cilat ishte arrestuar. Përveç këtij fakti, ankuesi ishte dhunuar fizikisht nga njëri prej punonjësve të policisë, ndërkohë që nga hetimi ynë administrativ nuk na rezultoi që të ketë qënë e nevojshme as përdorimi i forcës ndaj tij.

Ndodhur në këto rrethana, kur për të njëjtën ankesë dhe ngjarje organi i prokurorisë kishte filluar procedimin penal ndaj punonjësve të policisë për veprën penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”, vendosëm që të mos i drejtohem këtij organi me rekomandim për fillimin e hetimeve ndaj punonjësve të policisë. Ndërkohë është vënë në dijeni SHÇBA-në Tiranë për faktet e administruara nga ana jonë dhe deklaratimet e dëshmitarëve të pranishëm. Është detyrë dhe e drejtë e organit të prokurorisë që të bëjë një hetim profesional, objektiv, të plotë dhe të gjithanshëm lidhur me procedimin penal të filluar ndaj punonjësve të policisë, si dhe ndaj të arrestuarit D. D.

Megjithatë, nisur nga kjo ankesë, por edhe disa ankesa të tjera të ngjashme, gjykuam që këto raste duheshin vlerësuar seriozisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Për këto arsye ishte nevojë imediate që punonjësit e policisë të edukohen e trajnohen që të sillen dhe komunikojnë me qytetarët me etikë, durim dhe profesionalizëm. Ata duhet të tregohen të kujdesshëm që në rastet e konstatimit të kundërvajtjeve administrative, të mos bëhet shkak për ndodhjen e incidenteve të pahijshme deri në kryerjen e veprave penale, si ato të cituara më sipër nga punonjësit e policisë, apo më keq akoma që, për të justifikuar një veprim të paligjshëm të tyre ndaj qytetarëve, të bëjnë kallëzime të rreme. Kjo mënyrë sjelljeje e disa punonjësve të policisë vjen në kundërshtim me nenin 2 të ligjit nr. 108/2014 “Për Polinë e Shtetit” ku parashikohet se: *“Policia e Shtetit ka për mision ruajtjen e rendit e të sigurisë publike, ruajtjen e personaliteteve të larta shtetërore dhe objekteve të rëndësisë së veçantë, garantimin e zbatimit të ligjit, në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut”*. Gjithashtu ajo vjen në kundërshtim edhe me nenin 94 të këtij ligji i cili parashikon se:

*“Punonjësi i policisë është i detyruar të respektojë rregullat e sjelljes dhe etikës gjatë përmbushjes së detyrave....”*

Për sa më sipër dhe me qëllim rritjen e performancës dhe imazhit të Policisë së Shtetit, si dhe rritjen e besimit të publikut tek ky organ, iu rekomandua Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit:

- 1. Fillimin e ecurisë disiplinore ndaj punonjësve të policisë të strukturës operationale të DVP Tiranë nga Drejtoria e Performancës dhe e Standardeve Profesionale pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.*
- 2. Nxjerrjen e përgjegjësive, dhënien e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës dhe përgjithësimin e këtij rasti në strukturat e Policisë së Shtetit me qëllim mos përsëritjen e rasteve të tilla në të ardhmen.*
- 3. Trajnimin në vijimësi të punonjësve të policisë së shtetit me synimin respektimin e të drejtave të shtetasve, sjelljes së tyre me etikë gjatë përmbushjes së detyrave dhe zbatimin e parimit të*

*proporcionalitetit nëse lind nevoja e përdorimit të forcës konform nenit 123 të ligjit “Për Policinë e Shtetit”.*

Nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit u informuam se rekomandimi u mirëprit dhe u pranua, dhe se kishte filluar hetimin disiplinor për të gjithë punonjësit e policisë të përfshirë në këtë ngjarje. Pas përfundimit të hetimit disiplinor, problematika e konstatuar do të përgjithësoheshin me qëllim parandalimin e rasteve të tilla në të ardhmen dhe njëkohësisht do të mbaheshin në vëmendje për tu trajtuar edhe në trajnimet e vazhdueshme të punonjësve të Policisë së Shtetit.

### **4.3 Parandalimi i dhunës dhe torturës**

Gjatë vitit 2018, Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit, ka kryer **91** vizita, nga të cilat **51** vizita monitoruese të kryera në bazë të planit të miratuar të inspektimeve për vitin 2018 dhe **8** ri-inspektime, kontrole me tematikë të veçantë dhe hetime administrative, në të gjitha institucionet ku privohet apo mund të privohet liria e individit, përfshirë këtu institucionet penitenciare, njësitë policore, spitalet psikiatrike, qendrat ku trajtohen shtetasit e huaj, azilkërkuesit dhe viktimat e trafikut, si dhe pika të kalimit kufitar dhe mjediset ku parashikoheshin të ndërtoheshin kampet e trajtimit të përkohshëm të migrantëve. I gjithë aktiviteti i mësipërm, është shoqëruar me përcjelljen e **51** raporteve të inspektimit dhe rekomandimeve, në institucionet përgjegjëse, mbi problematikat dhe fenomenet e konstatuara.

Nga përgjigjet e deritanishme të marra mbi rekomandimet, ato rezultojnë të jenë pranuar e të kenë vënë në lëvizje institucionet për të përmbushur detyrimet e tyre. Mbetet për t’u ndjekur në vazhdim plotësimi i masave të tjera për përmirësimin e kushteve të trajtimit të individëve që mbahen në këto institucione.

Në inspektimet e kryera u vunë re një sërë problematikash, të cilat paraqesin nevojë të ngutshme për shqyrtim e përmirësim. Përmbledhtazi gjetjet pasqyrohen në vijim:

- Kushte materiale tejet degraduese dhe mosplotësim i rekomandimeve për rikonstruktimin e mjediseve në regjimet e brendshme të I EVP Zahari Krujë, I EVP Sarandë, I EVP Tepelenë, I EVP Kukës, të cilat e bëjnë të pamundur garantimin e të drejtave të të paraburgosurve dhe të dënuarve të sanksionuara në aktet ndërkombëtare dhe legjislacionin kombëtar në fuqi. Meqenëse këto gjetje vazhdojnë të konstatohen në mënyrë të përsëritur, madje me kushte edhe më të degraduara si rrjedhojë e mbipopullimit të vazhdueshëm, mungesës së investimeve dhe amortizimit, Avokati i Popullit rekomandoi mbylljen e menjëhershme të këtyre institucioneve dhe transferimin e personave në institucione të tjera penitenciare.
- Mbipopullimi mbetet një problematikë e sistemit tonë penenciar me një mesatare vjetore prej 15- 20% mbi kapacitetet. Vërehet një ulje e mbipopullimit prej 5%-10% krahasuar me një vit më parë nga një rishpërndarje e të dënuarve/paraburgosurve në I EVP dhe nga vënia në funksionim e I EVP Shkodër dhe rikonstrukcioni i I EVP “Jordan Misja”. Megjithatë problematike paraqitej situata në I EVP-të Krujë, Rrogozhinë, Tepelenë, “Jordan Misja”, Drenovë, Durrës, Vaqarr e Sarandë, të cilat funksiononin në pjesën më të madhe të kohës mbi kapacitetin e lejuar. Si rrjedhojë e mbipopullimit, një pjesë e I EVP-ve ka bërë shtimin e numrit të shtretërve, gjë që kishte pakësuar numrin e personave që flinin me shtroje përtokë, por që nuk adresonte garantimin e standardeve të hapësirës jetike për person. Në disa prej I EVP-ve situata paraqitej edhe më problematike, pasi si rrjedhojë e mbipopullimit mjediset e aktiviteteve të përbashkëta, observimi e izolimi ishin kthyer në mjedise banimi. Ndërkohë, veçanërisht shqetësuese paraqitej situata në seksionin e veçim-observimit të I EVP Rrogozhinë, ku pjesa dërrmuese e personave qëndronin në këtë sektor në kushte degraduese dhe për ta ishte i pamundur realizimi i ajrosjes dhe aktiviteteve sipas parametrave ligjore.
- Moszbatim i marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë për ngritjen e një Institucioni të Posaçëm Mjekësor, të parashikuar në ligjin Nr. 44/2012, datë 08.05.2012 “Për Shëndetin Mendor”, me qëllim strehimin dhe trajtimin e personave që kanë marrë nga gjykata masën “mjekim i detyruar” dhe “shtrim i përkohshëm”. Trajtimi i kësaj kategorie në I EVP Krujë etj, në kushte

materiale degraduese dhe kur në organikat e tyre mungon mjeku psikiatër dhe kur aksesimi për konsulta psikiatrike pranë spitaleve psikiatrike rajonale paraqet vështirësi, ose në Institucionin e Veçantë Shëndetësor të Burgjeve për rastet me episode akute, vijon të mbetet i paligjshëm, duke u reflektuar edhe raportet kombëtare, ndërkombëtare dhe në konferencat rajonale.

- Probleme me krijimin e kushteve për ofrimin e kurseve arsimore e atyre të formimit profesional si dhe për mundësimin e aktiviteteve të tjera kulturore veçojmë I EVP 302 dhe 313 në Tiranë, Tepelenë, Sarandë, Fushë Krujë. Në asnjë prej institucioneve penitenciare, nuk ofrohet arsimi i mesëm.
- Shpërblimet për punën e kryer në të gjitha institucionet, bëheshin me ditë ulje nga dënimi, gjë që nënkupton paragjykim të fajësisë për kategorinë e të paraburgosurve. Po në këtë kuadër, për punën që kryenin të paraburgosurit në këto institucione, nuk paguhej vlera përkatëse e sigurimeve shoqërore, gjë që sjell mos vlerësimin e kohës së punës në institucion si kohë vjetërsie në punë, si dhe mohimin e një të drejte, atë të përfitimit të pensionit të pleqërisë. Të dënuarit nuk ishin të pajisur me librezë pune dhe as me atë të kontributeve shoqërore.
- Infrastruktura në pjesën më të madhe të I EVP-ve paraqiste probleme të amortizimit, lagështirës, furnizimit me ndërprerje me energji elektrike, ujë dhe ngrohje, sigurimit të ndriçimit natyral dhe të ajrosjes së plotë të qelive, pranisë së insekteve, kushteve jashtë standardeve të tualeteve, kuzhinave, dusheve, ambienteve të ajrimit, dhomave të izolimit, etj. I EVP-të me problematika emergjente infrastrukturore paraqiteshin në Zahari-Krujë, Lushnje, Rrogozhinë, Sarandë, Lezhë, Tepelenë, si dhe në Institucionin e Veçantë Shëndetësor të Burgjeve, Tiranë. Përjashtim bënin I EVP-të e reja dhe ato të rikonstruara të cilat praktikisht kanë krijuar një sistem me dy standarde në sistemin penitenciar shqiptar.
- Ambientet e përbashkëta për zhvillimin e aktiviteteve rehabilituese mungonin në një pjesë të I EVP-ve, si rezultat i kthimit të ambienteve të edukimit apo ushtrimit të riteve fetare e veprimtarive sportive në dhoma banimi, si dhe për shkak të mungesës së fondeve për pajisjen e tyre me materiale didaktike. Po ashtu sipërfaqet e vogla për ajrim të jashtëm kushtëzohin llojin e aktiviteteve sportive që mund të zhvilloheshin në to. Për rrjedhojë, në thuajse të gjitha I EVP-të, u konstatua probleme sa i përket aktiviteteve në grup apo individuale dhe pamundësi nga sektori psiko-social të cilat ndonëse mundohen t'i realizojnë realisht nuk arrijnë t'i kryejnë për mungesë të ambienteve të përshtatshme, bazës materiale apo dhe organikës së paplotësuar me stafin e nevojshëm.
- Ambientet e kujdesit shëndetësor në burgje, përjashtuar I EVP-të e reja si Vlorë, Berat, Fier, Durrës, Elbasan dhe Shkoder, ishin përgjithësisht të papërshtatshme për vizita mjekësore, e të pa pajisura me materiale ndihmëse.
- Vonesa dhe mangësi paraqiten në pajisjen e të dënuarve/paraburgosurve me librezë shëndetësore apo me të dhënat elektronike në sistemin e sigurimeve shëndetësore në shumicën e I EVP-ve, që sillnin si pasojë moszbatimin e skemës së rimbursimit të ilaçeve dhe probleme në furnizimin me medikamente.
- Vështirësi në realizimin e konsultave, ekzaminimeve dhe analizave laboratorike specifike si dhe ndërhyrjeve kirurgjikale, vëreheshin ende në disa prej I EVP-ve, për arsye të lidhura me mungesën e mjekëve me kohë të plotë në organikë apo mungesën e autoambulancave, me rezistencën e spitaleve rajonale për të trajtuar personat për shkak të mungesës së kushteve të sigurisë në to, etj.
- Probleme të ofrimit të shërbimit stomatologjik në I EVP që vinin si rrjedhojë e mungesave në aparatura dhe materiale ndihmëse. Shërbimet dentare, përveç ekstraksioneve, kryheshin me vështirësi në poliambulancat publike apo në klinikat private me shpenzimet e vetë të dënuarve<sup>4</sup>.
- Në shumicën e rasteve të dënuarit/paraburgosurit nuk i sigurohet ngrohja sipas parashikimeve ligjore. Sistemet qendrore të ngrohjes, pothuajse në të gjitha I EVP-të, ku ishin të instaluar nuk funksiononin si rezultat i defekteve teknike ose të mungesës së karburantit.
- Mungesat në furnizimin me produktet bazë të higjienës personale (pastë dhëmbësh, furçë dhëmbësh, shampo, etj.) dhe të detergjenteve të nevojshme për të pastruar ambientet e I EVP-ve, si dhe mungesat në uniforma dhe doreza gjatë shpërndarjes së ushqimit u konstatuan në shumicën e I EVP-ve.

---

<sup>4</sup> Më shumë informacion në lidhje me shërbimin stomatologjik në I EVP gjendet në Aneksin 2 të këtij raporti

- Mungesat në dollapë e rafte të rrobave bënin që ato të mbaheshin nga të dënuarit/paraburgosurit në qese plastike ose në thasë, kryesisht poshtë shtretërve. Kjo problematikë ndesh kryesisht në IEVP Lezhë, Tepelenë, Korçë, Durrës, “Jordan Misja”, Sarandë, Kukës, Rrogozhinë e Tropojë.
- Problem i hasur në të gjitha institucionet e inspektuara, ishte konstatimi i çmimeve të larta të produkteve të dyqaneve të IEVP-ve.
- Cilësia dhe larmia e ushqimit mbetej shqetësuese thujse në të gjitha IEVP-të.
- Shpërblimet për punën e kryer në të gjitha institucionet, bëheshin me ditë ulje nga dënimi, gjë që nënkupton paragjykim të fajësisë për kategorinë e të paraburgosurve. Po në këtë kuadër, për punën që kryenin të paraburgosurit në këto institucione, nuk paguhej vlera përkatëse e sigurimeve shoqërore, gjë që sjell mos vlerësimin e kohës së punës në institucion si kohë vjetërsie në punë, si dhe mohimin e një të drejte, atë të përfitimit të pensionit të pleqërisë. Të dënuarit nuk ishin të pajisur me librezë pune dhe as me atë të kontributeve shoqërore

Problematikat e vërejtura nevojitet të adresohen me vendimmarrje nga organet e larta shtetërore, pasi në shumicën e rasteve ato janë rezultat i ashpërsimit të politikës penale, mungesës së fondeve, si dhe mungesës së nxjerrjes së akteve nënligjore për të gjeneruar përmirësime të dukshme të sistemit, si në formë ashtu dhe në përmbajtje.

#### *Niveli i respektimit të të drejtave të personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar në njësitë policore*

Inspektimet e kryera në njësitë policore kishin si qëllim, vëzhgimin e objekteve si dhe mbledhjen dhe vlerësimin e të dhënave mbi veprimet dhe praktikën e ndjekura nga Policia e Shtetit në përmbushje të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, procedurën standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr.306, datë 31.03.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, procedurës standarde “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin Nr.1102, datë 07.11.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, si dhe verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, të dhëna gjatë vitit 2017.

Nga inspektimet e kryera në strukturat e policisë, janë konstatuar problematikat si më poshtë vijon:

- Mbipopullim i konsiderueshëm në drejtoritë e policisë dhe komisariatet ku gjenden ambiente sigurie në varësi të tyre. Në këto struktura punohej në pjesën më të madhe të kohës mbi kapacitetin zyrtar. Mbipopullimi ishte krijuar kryesisht si pasojë e arrestimeve e ndalimeve të shumta të bëra gjatë vitit nga policia, për vepra penale të përfshira rishtazi në Kodin Penal, por edhe për shkak se personat e dënuar me vendim të formës së prerë, apo në mungesë, vononin të pranoheshin nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.
- Pretendime për raste të ushtrimit të torturës dhe keqtrajtimin fizik e psikologjik të shtetasve nga punonjësit e policisë ka patur, në disa komisariate. Ankesat e gjetura të bazuara janë ndjekur kryesisht nga grupe të përbashkëta me Seksionin e Veçantë janë pasuar nga rekomandimet konkrete për marrjen e masave lidhur me personat përgjegjës.
- Mbajtje dhe trajtim i personave të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, me burgim në mungesë, për një periudhë 5-30 ditore, në disa prej ambienteve të sigurisë në strukturat e Policisë së Shtetit.
- Mospërmbushje e detyrimeve ligjore për ndërtimin apo përshtatjen e ambienteve të shoqërimit sipas standardit të kërkuar (3 dhoma shoqërimi, 1 për të rritur, 1 për femra dhe 1 për të mitur). Dhomat e shoqërimit në pjesën më të madhe të komisariateve nuk i plotësonin standardet për trajtim dinjitoz të personave, pasi rezultonin të pakta në numër dhe nuk krijonin ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orënditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, të rritur dhe të mitur<sup>5</sup>.
- Mospërmbushje e detyrimeve ligjore për ndërtimin apo përshtatjen e ambienteve të sigurisë, sipas standardeve të kërkuara e të miratuara nga Konventat Ndërkombëtare dhe procedurës standarde “Për

<sup>5</sup> Më shumë informacion në lidhje me dhomat e sigurisë gjenden në Aneksin 3 të këtij raporti



trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin Nr.1102, datë 07.11.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Përgjashtim bënin ambientet e sigurisë në DVP Tiranë, Gjirokastrë, Kukës, Korçë dhe Fier. Komisariatet e varësisë të DVP Tiranë ku gjenden dhoma sigurie, po ashtu ishin në shkelje të dukshme të standardeve. Në komisariatet që duhej të rezultonin me dhoma të sigurisë të nxjerra jashtë funksionit, vijon të konstatohet se nuk ishin të mbyllura sipas procedurave përkatëse, me dyllosje e procesverbal. Përgjithësisht, këto dhoma u gjetën të mbajtura me çelës ose dry.

- Probleme në ofrimin e një shërbimi shëndetësor nga disa DVP, sa i përket plotësimit korrekt të regjistrave e kartelave mjekësore, si dhe ambienteve të papërshtatshme për ofrimin e konsultave, në disa drejtori mjeku mungon. Në disa prej këtyre institucioneve, vizitat mjekësore kryheshin përtej afatit 12 orësh, të përcaktuar në procedurat standarde të Policisë së Shtetit.
- Probleme për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhgimi në korridoret e dhomave të shoqërimit, sigurisë dhe ambientet e marrjes në pyetje të shtetasve në disa komisariate.

### *Rastet e torturës, keqtrajtimin dhe ushtrimin të dhunës në njësitë policore dhe në institucionet penitenciare*

Pranimi dhe shqyrtimi me përparësi dhe me rigozitet i ankesave të qytetarëve ndaj organeve të Policisë së Shtetit për dhunimin fizik të tyre në njësitë policore, si dhe ndaj Policisë së Burgjeve për dhunimin fizik të të paraburgosurve dhe të dënuarve në institucionet penitenciare, duhet theksuar se mbetet problematikë shqetësuese, pasi shkelja e të drejtës për të mos ju nënshtuar torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerezor ose poshtërues, përbën një nga shkeljet më të rënda të të drejtave themelore të njeriut.

Rastet e përdorimit të dhunës nga punonjësit e policisë ndaj qytetarëve janë të vështira për t'u provuar si edhe vërtetuar. Kjo lidhet me shumë arsye e shkaqe, sepse ato kryhen në vende të mbyllura, brenda ambienteve të policisë, në zyra, pa dëshmitarë të jashtëm okulare, por edhe në rastet kur ka të tillë, është e vështirë që të dhunuarit të dalin kundër punonjësve të policisë. Ekziston edhe frike hakmarrjeje tek qytetaret për ti denoncuar rastet e dhunës, si dhe pasiguri e mosbesim në ndjekjen e tyre nga organet e drejtësisë. Që të mundësohet vërtetimi i dhunës policore është e nevojshme që, ankesa të bëhet sa më shpejt, kur pasojat e saj janë ende të dukshme dhe ndërkohë, duhet bërë hetimi administrativ në vend.

Avokati i Popullit gjate vitit 2018 ka filluar me inisiativë një sërë rastesh ndër të cilat edhe ndjekjen e rastit të bërë publik në media për dhunën e ushtruar nga punonjësit e Policisë Bashkiake Tiranë, ndaj shtetasit N.B, me datë 18.04.2018.

Në këtë kuadër është kryer një hetim të pavarur administrativ nga ana e Avokatit të Popullit, në vijim të së cilit janë kryer një sërë procedurash. Janë marrë shpjegimet me proces-verbal të qytetarit N.B, i cili gjithashtu nga ana e tij ka rregjistruar në vijim një ankesë individuale pranë Institucionit të Avokatit të Popullit. Në përfundim të hetimit administrativ të këtij rasti Avokati i Popullit i ka rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Tiranë, “... nxjerrjen e përgjegjësive me qëllim parandalimin në të ardhmen të veprimeve të tilla për punonjësit e Policisë Bashkiake”, ndërsa Prokurorisë të rrethit Gjyqësor Tiranë i ka rekomanduar, “... fillimin e hetimeve në ngarkim të shtetasve, J.M, A. H dhe I. S, me detyrë punonjës së Policisë Bashkiake Tiranë, për veprën penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”, e kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 250 dhe 25 të Kodit Penal”.

Ky rast është pranuar nga ana e Prokurorisë dhe në përfundim të hetimeve dhe ndjekjes penale është dërguar për gjykim pranë Gjykatës Shkallës Parë Tiranë, me të njëjtat prova dhe argumenta të paraqitura në Rekomandimin e Avokatit të Popullit.

#### 4.4 Respektimi i të drejtave të njeriut nga Prokuroria

Gjatë trajtimit të kërkesë/ankesave të qytetarëve për vitin 2018, ndaj veprimtarisë së punës të organit të Prokurorisë, konstatohet se nga ana e prokurorëve ka një kuptim dhe zbatim më të drejtë të dispozitave procedurale penale pas ndryshimeve në ligjin nr.35/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, dhe ligjit nr.36/2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7895 datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar. Një tjetër aspekt që duhet të përmëndim është edhe trysnia e pritshmërisë nga prokurorët e gjyqtarët, për fillimin e procedurave nga Komisioni i Vetingut.

Kërkesë/ankesat e qytetarëve ndaj organit të *Prokurorisë për vitin 2018 kanë qënë 120, me një rritje në masën 27 përqind, e krahasuar me vitin 2017. Ka shumëllojshmëri të ankesave për cënim të të drejtave nga organi i prokurorisë në procesin penal, të cilat kapin shifrat deri në 10 përqind. Në mënyrë të grupuar dhe sipas rëndësisë së cënimit të së drejtave në procesin penal, ankesat e qytetarëve paraqiten si më poshtë:*

*Së pari: Për zvarritje të pajustificuara në hetimin e procedimeve penale.*

Ka zvarritje të pajustificuara të hetimit për ngjarje kriminale të filluara mbi bazën e ngjarjes, për vepra me rrezikshmëri shoqërore të madhe, të cilat në pjesën më të madhe ndiqen nga Policia Gjyqësore e Policisë së Shtetit. Sipas përgjigjeve të dhëna nga Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore, arsyet e zvarritjes në hetimin e procedimeve penale kanë qënë: Komplexiteti i çështjes; përpilimi dhe dërgimi me vonesë i akteve të ekspertimeve me natyra të ndryshme; moskthimi i përgjigjes së letërporosisë nga autoritetet e drejtësisë të shtetave të huaja etj; procedurat e ndërlikuara që kanë kompanitë celulare për vënien në dispozicion të të dhënave të kërkuara; komandimi i prokurorit të çështjes në një prokurori tjetër etj. Por gjatë trajtimit të këtyre ankesave kemi arritur në përfundimin se ka edhe arsye subjektive të prokurorëve, që kanë sjellë zvarritje të pajustificuara të hetimit të procedimeve penale.

*Së dyti: Për akuzë dhe arrestim të padrejtë.*

Pavarësisht përgjigjeve të marra nga Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore, çojmë se prokurorët duhet të jenë më rrigorozë në zbatimin korrekt të nenit 304 pika 1 e Kodit të Procedurës Penale për të “*kryer hetime edhe për verifikimin e fakteve ose rrethanave në favor të personit ndaj të cilit zhvillohen hetime*”.

Gjatë trajtimit të rastit të tubimit të datës 31.03.2018 në “Rrugën e Kombit” për kundërshtimin e tarifës së vendosur për kalimin në këtë rrugë, konstatuam veprime pa cilësi dhe të papërgjegjshme të Policisë Gjyqësore, që konsistuan në evidentimin e orës së ndalimit të 23 personave në momentin e mbylljes së tyre në dhomat e sigurisë dhe jo, kur qytetarëve u janë vënë prangat në banesë, çka dëshmoi se ora e privimit të lirisë për çdonjërin prej tyre ka qënë 2 orë e gjysëm më parë.

Organi i akuzës çënoi të drejtat e të ndaluarve duke llogaritur si kohë ndalimi orën e ekzekutimit të urdhërave të ndalimit, kohë e cila nuk pasqyroi realitetin e veprimeve të kryera për këtë rast. Pra për 23 personat e ndaluar, koha (ora) dhe vëndi i ekzekutimit të ndalimit të tyre ishin të pasakta dhe nuk pasqyruan atë që kishte ndodhur në të vërtetë.

Organi i Prokurorisë nuk bëri asnjë përpjekje për të parë dhe ndjekur zbatimin me korrektësi të ekzekutimit të urdhërave të ndalimit nga Policia Gjyqësore duke cënuar garancitë procedurale të personave nën hetim.

Nga studimi i urdhërave të ndalimit, tek pjesa arsyetuese organi procedues, jo vetëm që nuk paraqiti asnjë arsye ligjore të ndalimit të personave, por gjithashtu nuk vërtetoi asnjë kusht për ekzistencën e shkaqeve të bazuara për rrezikun e ikjes për secilin prej tyre. Edhe në kërkesën e saj për vleftësimin e

ndalimeve dhe caktimin e masës së sigurimit, zhvilluar më datë 04.04.2018, organi i akuzës nuk paraqiti prova që të vërtetonin kushtet e rrezikut të ikjes për çdo person të ndaluar.

Nga hetimi i pavarur i Avokatit të Popullit dhe zhvillimit të shqyrtimit gjyqësor në seancën e vleftësimit të ndalimit, u evidentua fakti se, disa nga personat e ndaluar nuk kishin shkaqe dhe arsye të tilla objektive që as mund të mendonin për t'u larguar, pra të përbënin rrezik për ikje, siç pretendoi organi i Prokurorisë.

*Së treti: Mosrespektimi i dispozitave procedurale që parashikojnë të drejtat e palëve në procesin penal, e që lidhen me mosnjohimin për mënyrën e zgjidhjes së kallëzimit penal apo ecurisë së hetimeve, shtetasve që kanë kallëzuar veprën penale, mosnjohimin ose vonesa në njohimin e palëve për vendimet e marra nga organi i Prokurorisë sidomos kallëzuesit të veprës penale, kryesisht në rastet e vendimeve për mosfillim të procedimit penal si dhe në mosdhënien e akteve të ndryshme të sekuestruara gjatë hetimit të procedimeve penale.*

Deri para hyrjes në fuqi të ligjit nr.35/2017, datë 1 Gusht 2017, për rastet e pezullimit të hetimit, Prokuroria në pjesën më të madhe nuk njoftonte apo nuk iu dërgonte palëve vendimin përkatës, me arsyetimin se “*ky detyrim nuk parashikohet në nenin 326 të Kodit të Procedurës Penale*”.

Kjo e drejtë e palëve iu njoh dhe me ndërhyrjen e institucionit të Avokatit të Popullit, me ndryshimin në pikën 3 të nenit 326 të Kodit të Procedurës Penale, ku thuhet: “*Vendimi i arsyetuar i njoftohet viktimës ose personit që ka bërë kallëzimin, të cilët mund të bëjnë ankim brenda 10 ditëve nga marrja dijani para gjyqtarit të seancës paraprake. Ankimi shqyrtohet në dhomë këshillimi brenda 30 ditëve. Kundër vendimit nuk lejohet ankim*”.

*Së katërti: Në moskthimin ose kthimin me vonesa të sendeve prova materiale të sekuestruara gjatë fazës së hetimit.*

*Së pesti: Nxjerrja me vonesë e urdhërit të ekzekutimit të vendimit penal që ka marrë formë të prerë.*

Gjatë vitit 2018, janë bërë 4 Rekomandime të cilat paraqiten si më poshtë:

1. Rekomandimi i datës 13.02.2018, drejtuar Prokurorisë të Përgjithshme “*Marrjen e masave me qëllim hetimin e shpejtë të procedimit penal nr.875/2010, hetuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës dhe mundësinë e transferimit të çështjes në një Prokurori të Rrethit Gjyqësor më të afërt, për kryerjen e hetimeve objektive dhe të gjithanshme*”. Rekomandimi është pranuar pjesërisht, duke refuzuar transferimin e çështjes.
2. Rekomandimi i datës 07.05.2018, drejtuar Prokurorit të Përgjithshëm “*Për fillimin e hetimit për veprën penale “Kryerja e veprimeve arbitrare” ndaj shtetasve I.M., A.H., dhe I.S., punonjës të policisë bashkiake në Bashkinë e Tiranë” ndaj shtetasit N.K.,*”. Rekomandimi është pranuar dhe, pas fillimit të hetimit çështja është dërguar në gjyq.
3. Rekomandimi i datës 05.02.2018, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor dhe Komisarariatit të Policisë nr.4 Tiranë “*Marrja e masave për kthimin e sendeve të sekuestruara shtetasit D.D., në zbatim të shkresës nr.7590, datë 18.09.2017, të asaj prokurorie*”. Rekomandimi është pranuar dhe shtetasit i janë kthyer sendet e sekuestruara.
4. Rekomandim drejtuar Prokurorisë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, datë 19.04.2018, “*Në lidhje me trajtimin e rastit tubimit të datës 31.03.2018 në “Rrugën e Kombit”, për kundërshtimin e tarifës së vendosur për kalimin në këtë rrugë*”.

#### **4.5 Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore civile dhe administrative**

Çështja e respektimit të parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor në procesin e ekzekutimit të titujve ekzekutiv prej autoriteteve të ngarkuara me ligj, për ekzekutimin e tyre, si rrjedhojë e

mosekzekutimit të tyre në një afat të arsyeshëm, ka qenë dhe mbetet një çështje me rëndësi thelbësore, pasi lidhet me krijimin, forcimin dhe zhvillimin e një sistemi gjyqësor të respektueshëm për të gjithë.

Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë në një afat të arsyeshëm, nga ana e organeve të administratës publike, në cilësinë e debitorit, mbetet një çështje problematike sistematike, e cila shkel parashikimin e bërë në nenet e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë<sup>6</sup> dhe Kodit të Procedurës Civile<sup>7</sup>, si dhe me parimet sipas të cilave zhvillohet veprimtaria e organeve të administratës publike.

Në procesin e shqyrtimit të ankesave të administruara gjatë vitit 2018, me objekt, mosekzekutimin e titujve ekzekutiv, Avokati i Popullit gjykon se, si shkak që ndikon në mosrespektimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor evidentohet edhe problematika që mbart Udhëzimi nr.1 datë 04.06.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisve të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”, si dhe mosmiratimi prej Ministrisë së Financave i projekt buxheteve të institucioneve debitore, në të cilat përfshihen dhe detyrimet në të holla të rrjedhura sipas vendimeve gjyqësore.

Cënimi i së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosekzekutimit të titujve ekzekutiv në një afat të arsyeshëm, në vlerësimin e Institucionit të Avokatit të Popullit, vjen edhe prej një sërë shkaqesh të tjera, ku mund të përmendim:

- ✓ Mungesën e cilësisë profesionale të përmbartuesve gjyqësor, e cila shfaqet në veprimet dhe mosveprimet e tyre gjatë procesit të ekzekutimit të titujve ekzekutiv.
- ✓ Mosnjohjen e legjislacionit civil dhe atij procedural nga ana e përmbartuesve gjyqësor.
- ✓ Kryerjen e veprimeve përmbartimore jashtë objektit të ekzekutimit, si dhe keqinterpretimin e dispozitivit të vendimit gjyqësor.
- ✓ Mungesën e vullnetit apo frikën e përmbartuesve gjyqësor, për vendosjen e sanksioneve ndaj subjektit pranë personit të detyruar, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë, apo ndaj personave të tjerë në procesin e ekzekutimit, të cilët refuzojnë, kryejnë në mënyrë të parregullt, nuk respektojnë afatet, ose kryejnë të kundërtën e asaj që është vendosur në vendimin e formës së prerë, të gjykatës.
- ✓ Moskryerjen në mënyrë korrekte të veprimeve përmbartimore si dhe mospërpilimin e akteve në përputhje me kompetencat e dhëna në legjislacionin në fuqi. Kjo situatë vërehet sidomos në nxjerrjen e akteve për sekuestrimin e llogarisë, depozitës, së palës debitore. Si përmbartuesit gjyqësor shtetëror ashtu dhe ata privat, nxjerrin akte për sekuestrim llogari, depozite, të palës debitore, duke deleguar kompetencën për “vendosjen e masës së sekuestros”, tek personi i tretë, që rezulton të jetë banka e nivelit të dytë, apo dega e thesarit.
- ✓ Moskryerjen e veprimeve prej autoriteteve të ngarkuara me ligj për ekzekutimin e titujve ekzekutiv, të cilat mundësojnë përmbushjen e detyrimit në të holla, që institucioni shtetëror detyrohet të paguaj sipas vendimit të formës së prerë, të gjykatës.

Numri i ankesave të regjistruara përgjatë vitit 2017 dhe vitit 2018 është si më poshtë:

*Gjatë vitit 2017, janë marrë në shqyrtim 24 ankesa ndaj Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor Shtetëror dhe 16 ankesa ndaj Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor Privat. Gjatë vitit 2018, janë marrë në shqyrtim 32 ankesa ndaj Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor Shtetëror dhe 11 ankesa ndaj Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor Privat. Sikurse konstatohet ankesat ndaj Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor Shtetëror janë rritur, ndërsa ato ndaj Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor Privat janë në një numër më ulët krahasimisht me një vit më parë. Nga ana tjetër konstatohet fakti se, gjatë vitit 2018 numri i ankesave ndaj Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor Shtetëror është tre herë më i lartë se, numri i ankesave ndaj Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor Privat.*

---

<sup>6</sup> Neni 142/3

<sup>7</sup> Neni 451/a

Gjithashtu, një problematikë e konstatuar edhe në vitet e mëparshme nga ana e Avokatit të Popullit, në procesin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, me objekt, detyrimin e subjektit debitor privat të paguajë shuma të caktuara në të holla, mbetet mospërcaktimi zyrtar i minimumit jetik të individit. Në këto kushte, në rastin e kryerjes së veprimeve përmbarimore për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv mbi të ardhurat mujore të debitorit, krijohen situata në cënim të interesave jetike të tij. Mospërcaktimi zyrtar i minimumit jetik bën të pazbatueshëm nenin 533, të Kodit të Procedurës Civile,<sup>8</sup> prej Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor.

Procesi i ekzekutimit të titujve ekzekutiv, mbi pasuri të paluajtëshme të sekuestruara për vjeljen e detyrimit në të holla, has pengesë për shkak të mosnxjerrjes nga ana e Këshillit të Ministrave, të vendimit përkatës për përcaktimin e metodologjisë në caktimin e vlerës së sendit të sekuestruar prej Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor, në përputhje me nenin 7 dhe nenin 11, të Ligjit 114/2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.8116, Datë 29.03.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Mosnxjerrja e këtij akti nënligjor nuk lejon kryerjen e veprimeve përmbarimore në procesin e ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutiv, në fazën për të cilën përmbaruesi gjyqësor do të duhet të respektojë parashikimin e dhënë në nenet e sipërcituara, të ligjit 114/2016.

Një tjetër çështje, e cila mund dhe duhet të jetë objekt shqyrtimi prej Kuvendit të Republikës së Shqipërisë është edhe përcaktimi i normës së strehimit, si send mbi të cilin nuk mund të vendoset masa e sekuestrës në procesin e ekzekutimit të titujve ekzekutiv.

Situata e krijuar, pas zhveshjes së individit debitor nga mundësia e strehimit të tij, me rastin e ekzekutimit të detyrueshëm të titullit ekzekutiv, ka krijuar dhe krijon premisa për uljen në mënyrë të skajshme të standardit të jetesës për individin debitor, kur ai e ka poseduar banesën me familjen e tij. Kategoria e individëve debitor, familjeve të tyre, të cilëve ju është hequr pronësia mbi pasurinë e vetme të paluajtshme, pra banesën e tyre, si rrjedhojë e ekzekutimit të titujve ekzekutiv kanë qenë dhe janë të ekspozuar ndaj humbjes së standardit minimal për strehim, i synuar për t’u arritur në objektivat sociale të shtetit të parashikuara në nenin 59, të Kushtetutës.

Me synimin për të siguruar ushtrimin efektiv të së drejtës për strehim, gjykojmë se objektivi social i plotësimit të nevojave të shtetasve me strehim minimal, mund dhe duhet të gjej shprehjen e vet si objektivi i pacënueshëm me rastin e amendimit të nenit 529, të Kodit të Procedurës Civile, i ndryshuar, duke parashikuar në të, përjashtimin nga sekuestrimi i normës së strehimit që duhet të ketë një individ në banesë.

Po kështu, çështja e përcaktimit të ndihmës ekonomike, apo ndihmës për trajtimin shëndetësor të debitorit, si send mbi të cilin nuk mund të vendoset masa e sekuestrës në procesin e ekzekutimit të titujve ekzekutiv, mund dhe duhet të jetë objekt shqyrtimi legjislativ nga ana e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Në procesin e shqyrtimit të kësaj çështjeje, institucioni i Avokatit të Popullit ka përgatitur dhe i ka dërguar një rekomandim Ministrisë së Drejtësisë për amendimin e nenit 529, të K.Pr.C. Edhe pse janë pranuar në parim rekomandimet, marrja e nismës për amendim ende nuk është kryer.

Në raportet e mëparshme vjetore, Avokati i Popullit, ka sjellë në vëmendje çështjen e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore penale, të dënimit me gjobë të subjektit, prej Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor. Edhe pse kemi konsideruar dhe konsiderojmë kryerjen e veprimeve përmbarimore për ekzekutimin e detyrueshëm të këtyre vendimeve gjyqësore penale, jo në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, konstatojmë sërish se, Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor, vijon me zhvillimin e veprimeve përmbarimore për vjeljen e gjobës penale, duke sekuestruar në mënyrë të kundërligjshme pasuri të të dënuarit. Edhe pse

---

<sup>8</sup> Neni 533, i Kodit Pr.C, parashikon vendosjen e masës së sekuestrës mbi pagën e debitorit pa cënuar minimumin jetik, i cili deri më sot është i papërcaktuar.

për këtë çështje i është rekomanduar me shkresën tonë nr.K2/I40-9 prot, datë 22.02.2016, Ministrit të Drejtësisë, “Marrja e nismës për ndryshim legjislacioni”, situata mbetet e pandryshuar, megjithëse rekomandimi ynë është pranuar në parim. Pranimi në parim i këtij rekomandimi do të duhet të pasohet nga iniciativa ligjvënëse nga ana e Ministrit të Drejtësisë.

Gjithashtu, sjellim në vëmendje faktin, se, një ndër institucionet shtetërore që duhet të japë e para shembullin për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, Ministria e Drejtësisë, nuk rezulton të jetë në këto pozita, po t’i referohemi rastit të ekzekutimit të vendimit nr. 7023, datë 16.09.2011, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë. Konkretisht, edhe pse kanë kaluar më shumë se pesë vjet nga marrja formë të prerë të tij, pala gjyqfituese, ende nuk ka arritur të gëzojë të drejtat e fituara.

Procesi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore penale, civile dhe administrative, si pjesë përbërëse e procesit të gjyqimit, ka mbartur dhe mbart problematika të njëjta sikurse është pasqyruar në raportet e mëparshme të Avokatit të Popullit.

#### **4.6 Ndhimja juridike falas**

Nga data 1 Qershor 2018, ka hyrë në fuqi ligji nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”. Ky ligj sanksionon procedurat për përfitimin e ndihmës juridike falas dhe të garantuar nga shteti, në formën e ndihmës juridike parësore (dhënia e informacioneve dhe këshillimit ligjor), ose të ndihmës juridike dytësore (dhënia e ndihmës juridike dhe ofrimi i mbrojtjes para gjykatës). Ky ligj gjithashtu ka parashikuar krijimin e një strukture të posaçme brenda Ministrisë së Drejtësisë, që do të jetë Drejtoria e Ndhimës Juridike Falas, strukturë e cila do të administrojë, koordinojë dhe eventualisht identifikojë nevojat për ndryshime dhe përmirësime në sistemin e ofrimit të ndihmës juridike falas.

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit, vetëm për vitin 2018 janë administruar rreth 54 kërkesë/ankesa nga qytetarë të cilët kërkojnë asistencën tonë për të përfituar ndihmën juridike falas dhe të garantuar nga shteti. Lidhur me këtë çështje mes institucionit të Avokatit të Popullit dhe Ministrisë së Drejtësisë ka pasur komunikime të vazhdueshme zyrtare për të mundësuar orientimin e duhur të qytetarëve drejt strukturave që mundësojnë caktimin e një avokati pa pagesë. Megjithatë, pavarësisht impenjimit institucional të ekspertëve të Avokatit të Popullit për të sqaruar qytetarët mbi rrugën ligjore që ata duhet të ndjekin për të përfituar ndihmën juridike falas dhe të garantuar nga shteti, është vënë re se vazhdimisht ka pasur paqartësi mbi formën se si do të aplikohet ky ligj, dhe procedurën që duhet të ndiqet nga qytetarët, të cilët shpesh përcillen nga një derë institucioni në tjetrën, mes Ministrisë së Drejtësisë, Gjykatave dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

Për këtë qëllim, institucioni i Avokatit të Popullit ka marrë rol aktiv për adresimin dhe zgjidhjen e kësaj problematike, duke kërkuar shpjegime nga Ministria e Drejtësisë, mbi zbatimin e parashikimeve të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, në lidhje me dy çështje: krijimin e strukturës së Drejtorisë së Ndhimës Juridike Falas dhe hartimin e akteve të nevojshme nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Në lidhje me çështjen e parë për të cilën janë kërkuar shpjegime, ajo e krijimit të një strukture të posaçme pranë Ministrisë së Drejtësisë, e cila është Drejtoria e Ndhimës Juridike Falas, jemi bërë me dije se kanë filluar procedurat për miratimin e kësaj strukture, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Në lidhje me çështjen e dytë për të cilën janë kërkuar shpjegime, atë të miratimit të akteve nënligjore të cilat kanë për synim detajimin e procedurave që rrjedhin nga zbatimi i ligjit nr.111/2017, akte për të cilat ky ligj ka përcaktuar se duhet të miratohen në çdo rast jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e tij, Ministria e Drejtësisë na ka bërë me dije se me urdhër të Ministrit të Drejtësisë është ngritur grupi i

punës i përbërë nga 6 ekspertë, i cili ka hartuar 13 akte nënligjore me nismën e Ministrisë së Drejtësisë, si edhe një draft i udhëzimit të përbashkët të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë, mbi përcaktimin e kriterëve të avokatëve që do të ofrojnë ndihmë juridike detyësore të garantuar nga shteti. Këto akte i janë nënshtruar një procesi të konsultimit paraprak me Gjykatat dhe organizmat kryesorë që kanë kontribut të konsoliduar në këtë fushë, dhe pritet miratimi në një kohë sa më të shpejtë i këtyre akteve.

Institucioni i Avokatit të Popullit do të vijojë të monitorojë në vazhdimësi çështjen e ofrimit të ndihmës juridike falas në zbatim të ligjit nr. 111/2017, në bashkëpunim me strukturat e ngarkuara nga ky ligj për zbatimin efektiv të tij.

#### **4.7 Respektimi i të drejtës së pronës**

Çështja e së drejtës së pronës për kategorinë e subjekteve, prona e të cilëve është shpronësuar pa shpërbllim, shtetëzuar apo konfiskuar pas vitit 1944, ka pësuar ndryshime thelbësore me hyrjen në fuqi, të Ligjit nr.133/2015 *“Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompesimit të pronave”*. Situata juridike e parashikuar në këtë ligj, për trajtimin e së drejtës të pronës është një qasje e papërshtatshme në respektimin e kësaj të drejte. Avokati i Popullit e ka vlerësuar situatën juridike të trajtimit të së drejtës së pronës nga ky ligj jo në përputhje me disa parime kushtetuese, qëndrim i cili është pranuar në vendimin nr.01, datë 16.01.2017 të Gjykatës Kushtetuese, ku është vendosur shfuqizimi i pikave 3 dhe 5, të nenit 6, të Ligjit nr.133/2015.

Ndërkohë, në kushtet e mungesës së kuorumit të nevojshëm vendmarrës, Gjykata Kushtetuese, nuk u shpreh për kushtetueshmërinë e parashikimit të kryer në shkronjën “b”, të nenit 6, si dhe në shkronjat “a” dhe “b”, të nenit 7, të Ligjit nr.133/2015. Edhe pse kërkesa për shfuqizimin e këtyre dispozitave ligjore është depozituar prej Shoqatës “Pronësi me Drejtësi”, pranë kësaj gjykate, Gjykata Kushtetuese prej më shumë se dy vitesh është në pamundësi objektive të shqyrtimit të kësaj kërkesë, pasi nuk plotësohet numri i nevojshëm i anëtarëve të trupit gjykues. Kjo mangësi përbën një nga shkaqet ekzistuese që ndikon në efikasitetin e atyre mekanizmave sistemikë, të cilët janë krijuar në nivel kushtetues si garantë të respektimit të së drejtës të pronës si një e drejtë themelore e njeriut, duke sjellë pasoja të drejtëpërdrejta edhe në mbrojtjen e kësaj të drejte.

Zgjidhja e dhënë për njohjen e pronës në Ligjin nr.133/2015, duke u mbështetur tek kompesimi në të holla sipas vlerësimit financiar të dhënë në këtë ligj, jo vetëm nuk respekton të drejtën e pronësisë së subjektit pronar, por ka dëmton dhe dëmton interesat e taksapaguesve shqiptarë, të cilët do të duhet të vijojnë të paguajnë fatura shumë të mëdha financiare.

Edhe pse janë të evidentuara mijëra hektarë tokë me regjim juridik “Shtet”, të mjaftueshme për zgjidhjen e çështjes së kompesimit në natyrë, kjo çështje sipas Ligjit nr.133/2015, është adresuar kryesisht për t’u zgjidhur me anë të kompesimit financiar. Mosekzekutimi deri më sot i 26 mijë vendimeve me të drejtë kompesimi, të dhëna ndër vite prej Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish Pronarëve (AKKP), sot Agjencia e Trajtimit të Pronave (ATP), ka bërë që ky proces të mbetet ende në kuadrin deklarativ.

Çështja e moszbatimit të vendimeve të gjykatave si dhe i vendimeve administrative, në lidhje me kthimin dhe/ose kompesimin e pronarëve ka qenë dhe mbetet një problem sistematik. ATP-ja edhe pse është urdhëruar të përmbushë detyrimin në të holla sikurse është vendosur nga gjykata, zvarrit pa shkak ekzekutimin e tyre. E njëjta situatë vërehet dhe në procesin e ekzekutimit të vendimeve të dhëna prej Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, me palë shtetin shqiptar, i cili duhet të përmbushë detyrimet e vendosura në këto vendime, brenda afateve të përcaktuara.

Detyrimi i parashikuar në pikën 1, të nenit 34, të Ligjit nr.133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompesimit të pronave”, për përfundimin e procesit të shqyrtimit të dosjeve që janë aplikuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe që kanë qënë në proces shqyrtimi pranë ATP-së, brenda një afati 3 vjeçar nga hyrja në fuqi e ligjit, nuk është përmbushur nga ana e ATP-së.

Parashikimi i kryer në ligjin 133/2015, për detyrimin e ATP-së për të mos trajtuar me vendim kërkesat që mbështeten vetëm në një vendim gjyqësor të vërtetimit të faktit juridik të pronës, neni 27/3 i Ligjit 133/2015, vlerësojmë se nuk vjen në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative, si dhe nuk respekton të drejtën për një proces të rregullt ligjor, apo edhe të drejtën e pronës.

Vendosja e afatit prekluziv për të drejtën e kërimit të njohjes së pronës nga ana e subjekteve të interesuara, sikurse është parashikuar në nenin 27/1, të Ligjit nr.133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompesimit të pronave”, është vlerësuar nga ana e Avokatit të Popullit, në kuptim dhe zbatim të neneve 41 dhe 42 të Kushtetutës, neni 1 të Protokollit nr.1, neni 6/1 të KEDNJ, si dhe të nenit 113, të Kodit Civil, si çënim i së drejtës të pronësisë së individit apo së drejtës për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor. Nuk rezulton të ekzistojë asnjë arsye e justifikuar, e cila do të mund të legjitimonte vendosjen e një kufizimi të tillë.

Në veprimtarinë e ATP-së, konstatohen raste të mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore civile, në të cilat është vendosur detyrimi për kryerjen e një veprimi të caktuar, apo detyrimi për dorëzimin e kompesimit në të holla. Edhe pse vendimet gjyqësore civile kanë marrë formë të prerë vite më pare, ATP-ja nuk ka proceduar dhe nuk procedon në mënyrë të rregullt për ekzekutimin e tyre.

“Humbja” e dosjeve të krijuara në vite dhe të administruara prej ATP-së është një tjetër problem, i cili ka shqetësuar dhe shqetëson subjektet pronarë, duke detyruar ata të drejtohen në gjykatë për zhvillimin e një procesi gjyqësor për vërtetimin e faktit, të ekzistencës së vendimmarrjes, së kryer prej ish-KKKP, ish-AKKP, sot ATP.

Regjistrimi i pasurive të paluajtshme me mospërputhje në sipërfaqe, nga sipërfaqja e përcaktuar në titullin e pronësisë është një tjetër çështje e mprehtë, e cila kërkon zgjidhje. Konstatohen mjaft parregullsi dhe deformime në përcaktimin e statusit të saktë të pronës, saqë ka dalë e nevojshme kryerja e një regjistrimi fillestar për të gjitha pasuritë e paluajtshme në rang vendi.

Kufizimet e vendosura sipas VKM-së nr.138 datë 23.02.2018 “Për Pezullimin e përkohshëm të vijimit të procedurave të kalimit në pronësi të përfituesve të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe të regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi, në zonën me rëndësi për Fondin e Mbështetjes së Investimeve Strategjike”, konsiderohen nga ana e Avokatit të Popullit, jo në pajtueshmëri me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Sipas nenit 17, të Kushtetutës, të drejtat dhe liritë e individit mund të kufizohen vetëm me ligj dhe jo me vendim të Këshillit të Ministrave, sikurse ka ndodhur me rastin e nxjerrjes së Vendimit nr.138, datë 23.02.2018. Avokati i Popullit çmon gjithashtu, se, në kushtet e mungesës së një interesi të ligjshëm publik, jemi para një çënimi të të drejtave të garantuara në nenet 41/3, 42/1 të Kushtetutës.

Në procesin e shqyrtimit të ankesave të paraqitura nga ana e individëve të ndryshëm në institucionin e Avokatit të Popullit, është konstatuar se, punonjës të zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme kanë shfaqur dhe shfaqin parregullsi në ushtrimin e detyrave të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore, në marrëdhënien me subjektet të cilat kërkojnë shërbime të caktuara. Vendosja e barrierave të ndryshme për qytetarët çon në favorizimin e korrupsionit.

Moszhvillimi i procedurave prej institucioneve përgjegjëse, për zbatimin e VKM nr.608, datë 05.09.2012, “Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më datë 10.08.1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie, si dhe për



*regjistrimin e tyre*”, të ndryshuar,<sup>9</sup> deri në hyrjen në fuqi të VKM-së nr.442, datë 18.07.2018 “*Për përcaktimin e procedurave të kalimit të pronësisë e të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.08.1991 dhe të truallit funksional të tyre*”, është një çështje e cila ka çënuar dhe çënon të drejtën e pronësisë së individit. Mosprocedimi i organeve shtetërore të ngarkuara për zbatimin e VKM-së në fjalë, ka bërë që procesi i nxjerrjes së titujve të pronësisë, në zbatim të VKM nr.608, datë 05.09.2012, të mos jetë realizuar efektivisht.

Një tjetër çështje e konstatuar në procesin e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi është edhe mosplotësimi i dokumentacionit në mënyrë të rregullt, prej ish-komisioneve të ndarjes së tokës, në fshat. Ky procedim i parregullt, i kryer sidomos prej komisioneve të ndarjes së tokës në fshat në zonën verilindore të vendit, ka penguar regjistrimin rregullisht të akteve të marrjes në pronësi për çdo familje bujqësore, sipas nenit 196, të Kodit Civil, si dhe ka krijuar premisa për konflikte pronësie midis subjekteve.

Institucionet përgjegjëse ende sot e kësaj dite nuk kanë mundur plotësimin e dokumentacionit të pronësisë edhe pse, përcaktimi i procedurave për plotësimin e akteve të marrjes në pronësi është kryer me VKM nr.253, datë 06.03.2013, ndërkohë që afati është shtyrë vit pas viti, deri më 31.12.2018. Kjo situatë e krijuar dhe trashëguar prej 27 vitesh kërkon impenjimin maksimal të institucioneve përgjegjëse të ngarkuara me ligj, për plotësimin e dokumentacionit si dhe dërgimin e tyre pranë zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Janë 500 mijë prona të ndodhura në 359 zona kadastrale, të cilat ende nuk figurojnë të regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme të zyrave vendore.

Një problematikë që po ndiqet nga institucioni i Avokatit të Popullit është dhe miratimi i VKM nr.708 datë 21.11.2018 “*Për regjistrimin dhe kalimin në përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për turizmin të disa pronave të paluajtshme shtetërore, në vijën bregdetare Vlorë-Sarandë*”.

Ky akt nënligjor, është botuar në Fletoren Zyrtare nr.171, datë 4.12.2018, përcakton kalimin në përgjegjësi administrimi të disa pronave të paluajtshme shtetërore, në vijën bregdetare Vlorë-Sarandë, zonë e cila prej kohësh rezulton shumë problematike sa i takon çështjeve që lidhen me, regjistrimin e pronave të paluajtshme të subjekteve të ndryshme private. Problematika e kësaj zone lidhet më së shumti me pamundësinë e regjistrimit në ZVRPP-në kompetente, të AMTP-ve për tokën bujqësore, apo edhe të pronësive të tjera të patundshme të ndodhura në vijën bregdetare Vlorë-Sarandë, nga ana e subjekteve private të interesuara, me justifikimin e dhënë nga ana e autoriteteve përgjegjëse shtetërore se, kemi të bëjmë me një “zonë të pamënaxhuar”.

Në këto kushte, nxjerrja e kësaj VKM-je, krijon një standard të dyfishtë në trajtimin e regjistrimit të pronave të paluajtshme në këtë zonë, që në parim çënon të drejtën themelore të pronës së subjekteve që disponojnë akte juridike të kalimit të pronësisë, nga shteti tek ta. Avokati i Popullit, prej muajit Dhjetor 2018, ka iniciuar kryesisht shqyrtimin e këtij akti, të cilin nuk e konsideron në respektim të së drejtës themelore të pronës, apo së drejtës për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor.

Çështje të tjera, të cilat janë në raportet tona vjetore të mëparshme dhe nuk kanë gjetur ende zgjidhje, janë:

- ✓ Mospërfundimi i procesit të regjistrimit fillestar sistematik të pronave, në ato zona kadastrale ku është vendosur për njohjen dhe kthimin/kompesimin e pasurive të paluajtshme;
- ✓ Tejzgjatja e procesit të shqyrtimit të vetëdeklarimeve të kryera prej subjekteve, të cilët kanë kryer ndërtimin e objekteve informale edhe pse janë deklaruar afate kohore konkrete për përfundimin e këtij procesi;
- ✓ Tejzgjatja e procesit të shqyrtimit të titujve të pronësisë, të nxjerra në zbatim të ligjit nr.7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”, etj;

---

<sup>9</sup> Kjo dhe për shkak të mosnxjerrjes prej Ministrisë së Financës dhe Ministrisë të Drejtësisë të udhëzimit të përbashkët (neni 10, i VKM nr.608/2012) për caktimin e tarifave të shërbimit në procesin e pajisjes me titull pronësie.

- ✓ Moskrijimi i një harte të vetme unike, dixhitale, që mund të japë informacion mbi pronën;
- ✓ Mosgarantimi i ekzekutimit të vendimeve të formës së prerë të gjykatave të sistemit gjyqësor në vend, si dhe të vendimeve të Gjykatës Europiane të Drejtave të Njeriut, që lidhen me të drejtën e pronësisë.

#### 4.8 E drejta për kujdes shëndetësor

Gjatë vitit 2018, Institucioni i Avokatit të Popullit, ka marrë në shqyrtim 87 ankesa në fushën e shëndetësisë. Nga këto 7 kanë qënë raste me inisiativë të trajtuara nga ana jonë. Objekti i ankesave kanë qënë trajtimi mjekësor jo konform standarteve, burokracira lidhur me rradhët e pritjes në QSUT, ankesa për mungesa në medikamente kryesisht në Spitalin onkologjik në QSUT, mungesa e protokolleve mjeksore, etj. Nga numri i ankesave të marra në total për 80 ankesa ka përfunduar shqyrtimi, ndërsa 6 të tjera janë në shqyrtim. Në numrin e ankesave të shqyrtuara, 30 ankesa janë zgjidhur në favor të qytetarit.

Në mënyrë që të përmirësohet cilësia dhe standartet e trajtimit të pacientëve të çdo spitali apo qëndre shëndetësore duhet të ketë në mënyrë permanente medikamente të mjaftueshme kryesisht në QSUT, Tiranë për shkak të fluksit të pacientëve nga e gjithë Shqipëria. Mungesa të mbartura vit pas viti ka siç dihet në spitalin onkologjik për shkak të specifikës dhe shtimit të numrit të pacientëve që trajton ky institucion spitalor në veçanti.

Mungesa e mjekëve specialist në spitalet rajonale në gjithë vendin mbetet problematikë e mbartur ndër vite, dhe si rezultat mungesa e shërbimeve apo aparaturave ndikon që pacientët të gjejnë rrugë alternative kurimi, siç është fluksi i pacientëve drejt kryeqytetit dhe QSUT-së. Problematike paraqitet edhe mungesa e pajisjeve mjeksore, apo amortizimi i pajisjeve ekzistuese në spitalet rajonale e cila sjell më tej mosofrimin me cilësi dhe standart të shërbimit mjekësor në këto zona.

Referuar ankesave më specifike të shqyrtuara për të cilat janë hartuar edhe rekomandime për vitin 2018, do veçonim Rekomandimin për *“Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e nevojave të pacientëve që vuajnë nga hemofilia, dhe konkretisht lehtësimin e procedurave burokratike si dhe garantimin e vazhdueshëm të Faktorit 9 në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, ankesë e adresuar nga shoqata e pacientëve që vuajnë nga Hemofilia.*

Gjithashtu, rast tjetër ka qënë edhe problematika e shtetases D.XH e cila vuan nga një sëmundje e rrallë e papërfshirë në protokolle mjeksore, me pasojë mostrajtim të denjë shëndetësor dhe social për këtë shtetase. Për këtë rast është rekomanduar marrja e masave të nevojshme dhe të menjëhershme për futjen në protokolle mjeksore të sëmundjes së fibromialgjisë, si një detyrim që ka çdo institucion shtetëror për respektimin e të drejtave të njeriut të njohura me kushtetutë dhe ligje të veçanta. Rast tjetër ka qënë një ankesë e paraqitur nga shoqata e pacientëve që trajtohen me hemodializë, ku dhe i është rekomanduar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Përkrahjes Sociale *“Marrja në konsideratë dhe zgjidhjen sa më parë të problematikave të ngritura nga pacientët që trajtohen me hemodializë në QSUT “Nënë Tereza”.*

Edhe për vitin 2018 në fushën e shëndetësisë institucioni i Avokatit të Popullit është asistuar nga projekti USAID-it *“Transparencë në Sistemin Shëndetësor në Shqipëri”*, qëllimi i të cilit është përmirësimi i shërbimeve shëndetësore nepermjet mbështetjes së Qeverisë e Shqipërisë në përpjekjet e saj për të luftuar korrupsionin. Gjithashtu, një komponent i rëndësishëm i këtij projekti është dhe inkurajimi dhe bashkëpunimi i institucioneve të pavarura përfitues të tij si Avokati i Popullit, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, shoqërisë civile dhe medias për të luftuar korrupsionin në shëndetësi, por edhe për një qeverisje më të mirë të sistemit shëndetësor. Vlerë e shtuar për vitin 2018 në këtë projekt, ka qënë bashkëpunimi për hartimin e dy Raporteve të veçanta, njëra me fokus *“Urgjenca Kombëtare”* dhe e dyta me fokus *“Sistemi i referimit të pacientëve në Kardiologjinë dhe kardiokirurgjinë”*, në QSUT, Tiranë.

Një risi ka qënë edhe rritja e bashkëpunimit të institucionit të Avokatit të Popullit me shoqatat që operojnë në mbrojtje të të drejtave të pacientit. Pjesëmarrja dhe organizimi i shumë tryezave, seminareve dhe konferencave ka rritur ndjeshëm shqyrtimin e rasteve të përbashkëta me këto shoqata në respektim të të drejtave të pacientëve dhe adresimit të shqetësimit të tyre në institucionet shëndetësore përgjegjëse.

Avokati i Popullit përmes trajtimit dhe adresimit të ankesave por edhe hartimit të rekomandimeve të tij, ka si qëllim sensibilizimin e punonjësve të administratës shëndetësore për një shërbim cilësor dhe me standarte ndaj të drejtave të qytetarëve çfarëdo kategorie shoqërore ti përkasin ato.

#### **4.9 E drejta për arsim**

Përpjekjet dhe iniciativat konkrete të kohëve të fundit për reformimin e arsimit, kërkojnë angazhimin e shumë aktorëve për realizimin e tyre. Çdo institucion që është përgjegjës për mbarëvajtjen e këtij sistemi është e nevojshme jo vetëm të njohë situatën dhe nevojat, por edhe të gjejë rrugët dhe përcaktojë politikat e duhura për përmirësim, pasi dobësitë e këtij sistemi do të ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në stabilitetin dhe zhvillimin afatgjatë të vendit.

Përpjekjet e viteve të fundit për të pasur një sistem renditjeje/pikëzimi të përbashkët për universitetet, krahas akreditimit, janë të dobishme, por duhet të përfshijë të gjitha institucionet e arsimit të lartë.

Gjatë vitit 2018 institucioni i Avokatit të Popullit, *ka marrë në shqyrtim 92 ankesa* në fushën e arsimit. Nga këto 8 raste kanë qënë raste me inisiativë të trajtuara nga ana jonë. Objekt i këtyre ankesave kanë qënë kryesisht mospërfashtimi nga tarifatat e studimit të kategorive të studentëve që vijnë nga shtresa sociale në nevojë, për moskthime përgjigjesh nga MAS, probleme administrative nga stafi i universiteteve dhe punonjësve të administratës, punësime dhe pretendime për shkelje të barazisë për tu punësuar nga portali “Mësues për Shqipërinë” etj. Nga numri i ankesave *ka përfunduar shqyrtimi për 80 ankesa dhe 12 janë ende në shqyrtim. Në numrin e ankesave të shqyrtuara, 40 ankesa janë të zgjidhura pozitivisht.*

Problematikat kryesore që ka trajtuar institucioni ynë lidhur me fushën e arsimit kanë qënë të ndryshme por ato që kanë spikatur më shumë kanë qënë problemet e studentëve që vijnë nga shtresa sociale në nevojë, të cilëve u është dashur të përballen me papërgjegjshmërinë e administratës dhe mos përfashtimin e tyre nga përgjysmimi i tarifës shkollore nga Bordet e Universiteteve në vend. Kjo problematikë ka ardhur në rritje vit pas viti që pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Arsimin e lartë dhe kërkimin Shkencor, në vitin 2015.

Vendimet e Këshillit të Ministrave të viteve 2017-2018 për *“Për Përcaktimin e Kategorive të Individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”*, sollën përjashtime dhe sorollatje të shumë studentëve që vijnë nga shtresa sociale në nevojë, nga ana e administratës të universiteteve.

Gjatë vitit 2018, janë hartuar 8 Rekomandime për disa universitete lidhur me marrjen në konsideratë për përfashtimin apo përgjysmimin e tarifave të larta në universitete, të studentëve që vijnë nga shtresa sociale në nevojë. Vlen të theksojmë se vetëm në dy raste rekomandimet tona janë marrë në konsideratë dhe konkretisht nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja dhe Universiteti i Mjekësisë. Edhe mungesa e daljes së akteve nënligjore në zbatim të ligjit të arsimit të lartë nr.80/2015, është problematikë e ngritur nga ana jonë. Megjithë përcaktimin që këto akte duhet të dilnin 9 muaj pas hyrjes në fuqi të ligjit kaluan më shumë se 3 vite dhe nuk dolën tërësisht.

Institucioni ynë është impenjuar në muajin Dhjetor 2018, edhe në lidhje me protestën e studentëve dhe problematikat që ata adresojnë të cilat janë trajtuar në vijimësi nga ana jonë që pas hyrjes në fuqi të ligjit të arsimit të lartë në vitin 2015. Problematikat e tyre kanë të bëjnë kryesisht me tarifat e larta në universitete, kushtet dhe infrastruktura e godinave të tyre dhe e konvikteve, cilësia në mësimdhënie, mungesa e politikave për punësimin e të rinjve pas përfundimit të studimeve, inflacioni i diplomave etj. Të gjitha këto shqetësime po ndiqen në vijimësi me një vëmendje maksimale nga ana jonë në respektim të të drejtave të studentëve për një arsim cilësor dhe dinjitoz.

Problematikë tepër shqetësuese ka qënë edhe ankesa nga Qendra “Për Arsim Cilësor”, lidhur me provimet e lirisimit. Nisur nga shqetësimet e shumë prej maturantëve në lidhje me vendimin për pamundësinë e rivlerësimit të testeve dhe të drejtën e tyre për të ushtruar ankim, prej tyre propozohet ndryshimi i pikës 10, neni 24, të Rregullores të datës 29.12.2017 “Për zhvillimin e maturës Shtetërore 2018 në RSH”, e cila ndalon rivlerësimin e testeve dhe të drejtën e maturantëve për të ushtruar ankim. Në lidhje me këtë problematikë, institucioni i Avokatit të Popullit i rekomandoi MAS-it “*Marrjen e masave për ndryshimin e pikës 1, neni 24, të rregullores "Për Zhvillimin e Maturës Shtetërore 2018 në RSH e cila ndalon të drejtën e ankimit, shoqëruar kjo me informimin e maturantëve për hapat që duhet të ndjekin për tu ankuar"*”.

Rastet e trajtuara me iniciativë nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit kanë qënë kryesisht rastet e bëra publike në median e shkruar dhe vizive që lidhen me kushtet dhe infrastrukturën në shkolla të ndryshme të vendit, mungesa e ngrohjes në muajt e dimrit apo lagështira dhe mungesa e artikujve bazë për zhvillimin normal të një ore mësimore si banka, dyer e dritare, të cilat vazhdojnë të mbeten problematika në shumë shkolla të largëta.

#### **4.10 Mjedisi dhe të drejtat e njeriut**

Në vijim të shqetësimeve të ngritura në vitet e kaluara, Avokati i Popullit konstaton sërish faktin se, problemi kryesor që ekziston në fushën e mbrojtjes së mjedisit është mungesa e ndëshkimit, apo edhe gjambat mjaft të ulëta, të parashikuara dhe vendosura si dënime administrative, për ata individë, apo subjekte, që ushtrojnë një veprimtari të dëmshme ndaj mjedisit dhe që ndikon në një ambient sa më të pastër.

Duke patur parasysh ndjeshmërinë e publiku për një mjedis sa më të shëndetshëm, si edhe nismat rajonale dhe globale që po ndërmerren në kuadër të mbrojtjes së mjedisit dhe ndryshimeve klimatike, institucioni i Avokatit të Popullit është treguar mjaft aktiv në trajtimin e rasteve të ndryshme me iniciativën e tij, si edhe shqyrtimin rigoroz të rasteve dhe ankesave individuale të parashtruara nga individë të ndryshëm. Konkretisht rezulton se gjatë vitit 2018 janë trajtuar 42 ankesa, të paraqitura ndaj organeve të administratës publike të ngarkuara me ligj për mbrojtjen e mjedisit, si edhe për promovimin e një ambienti të mjedisit sa më të pastër dhe të shëndetshëm. Po të krahasohet kjo shifër me të dhënat e vitit paraardhës, rezulton se Avokati i Popullit ka shqyrtuar dyfishin e ankesave që janë trajtuar gjatë vitit 2017, gjatë të cilit kemi patur 20 ankesa. Kjo vjen kryesisht për faktin e rritjes së ndjeshmërisë dhe proaktivitetit të Avokatit të Popullit për trajtimin dhe shqyrtimin e rasteve të ndryshme me iniciativë në fushën e mjedisit, por edhe problematikave me të cilat përballen individët në zona të ndryshme të Shqipërisë, përsa i përket ndotjes dhe rrezikut që i kanoset jetës dhe shëndetit të tyre nga faktorë të ndryshëm, në mjedisin dhe ambientin që i rrethon.

Konkretisht, për vitin 2018 rezulton se, Avokati i Popullit ka filluar shqyrtimin administrativ dhe ka trajtuar 11 çështje me iniciativë, duke katërfishuar pothuajse kështu numrin e rasteve me iniciativë të trajtuara në vitin 2017, me qëllim hetimin dhe verifikimin e çështjeve të ndryshme në këtë fushë, nga ku edhe janë konstatuar veprime, apo mosveprime në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, të cilat çënojnë të drejtën për një ambient të pastër e të shëndetshëm.

Në këtë kuadër mund të përmenden çështjet e filluara me iniciativë lidhur me, ndotjen alarmante për shkak të djegies së mbetjeve spitalore në Vlorë, ndotja e ambientit nga guroret në lagjen Gur i Bardhë/Berat, shpërthimet nga guroret te liqeni i Bovillës, ndotja e mjedisit pranë bregut të lumit Kserja, në Dropullin e Sipërm, rrjedhjen e gazit në Uzinën e Ballshit që shkaktoi helmimin e banorëve të zonës, ndotja e mjedisit në Porto Romano, si edhe zbatimi i kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi, përsa i përket trajtimit dhe përpunimit të mëtejshëm të mbetjeve “bio”, nga ana e strukturave të pushtetit vendor.

Nga verifikimi dhe trajtimi ankesave të cituara më lart, është konstatuar në vazhdimësi se, shkakui i vazhdimit të ndotjes së mjedisit është pikërisht, mosveprimi i organeve shtetërore të ngarkuara me ligj, ndaj subjekteve të ndryshme, që shkaktojnë ndotjen mjedisore.

Në mënyrë të përmbledhur edhe për vitin 2018, problematikat në fushën e mjedisit në Shqipëri mbeten si më poshtë:

- ✓ Ndotja e ajrit në qytetet e mëdha të vendit, sidomos në Tiranë, e cila vjen si pasojë e rritjes së numrit të makinave në qarkullim dhe pakësimit të hapësirave të gjelbërimit, pavarësisht projekteve modeste të njësive të caktuara të qeverisjes vendore, apo edhe strukturave të pushtetit qendror, për mbjelljen e fidanëve të rinj, në zona që veçohen për nivele të larta të ndotjes.
- ✓ Hedhja e mbeturinave në lumenj e liqene, si edhe derdhja e ujërave të zeza të papërpunuara në to.
- ✓ Mbledhja e mbeturinave urbane në Shqipëri dhe riciklimi i tyre nuk është ende në standardet e konsoliduara botërore. Mbeturinat urbane nuk mbledhen pothuajse fare nëpër fshatra.
- ✓ Prerjet e pyjeve dhe zjarret janë shkaqet kryesore për shpyllëzimin dhe zhdukjen e pyjeve në Shqipëri, duke dëmtuar në këtë mënyrë një nga burimet e vlefshme të ruajtjes së parametrave të pranueshëm të mjedisit.

#### **4.11 E drejta për strehim**

Institucioni i Avokatit të Popullit, ka luajtur rol proaktiv në përcjelljen e mendimeve dhe komenteve në lidhje me ligjin e miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, nr. 22/2018, “Për Strehimin Social”. Veçojmë përfshirjen në këtë ligj të rekomandimit tonë për njësitë e qeverisjes vendore, të cilat duhet të parashikojnë çdo vit në programet sociale të strehimit të tyre që, jo më pak se 5% e vendeve nga çdo program, të plotësohen nga familje të cilat deklarojnë se i përkasin minoritetit Rom, si dhe hartimin e programeve të reja të strehimit, nëpërmjet dhënies së një bonusi qiraje të financuar 100% nga njësitë përkatëse, për të gjitha familjet përfituese nga skema e ndihmës ekonomike dhe pa të ardhura financiare.

Gjatë vitit 2018, i janë adresuar rekomandime njësive të qeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për realizimin e objektivave të strehimit, me qëllim përmirësimin dhe krijimin e lehtësirave, apo vendstrehimeve alternative, veçanërisht për grupet e cënueshme dhe në pamundësi ekonomike.

Problematikat më të theksuara të evidentuara nga Avokati i Popullit, lidhur me strehimin janë:

- Mungesa e zgjidhjes për personat e pastrehë, të cilët janë të varfër dhe nuk kanë mundësi të përballojnë shpenzimet e pjesës së pa subvencionuar nga pushteti vendor, ose kreditë e buta;
- Strehimi i personave të komuniteteve Rome, të cilët në disa raste janë zhvendosur me forcë nga qendrat e vendbanimit të tyre; zvarritja e procedurave nga strukturat shtetërore, etj.
- Pamundësia e përfitimit të të varfërve nga programi për banesa me kosto të ulët dhe papërbalueshmëria nga ana e tyre e këtij programi, për shkak të procedurave bankare tepër të gjata dhe të kushtueshme, të aplikueshme për këtë qëllim.

Programi i banesave sociale me qira ka në fokus familjet me të ardhura të ulëta, por njerëzit që jetojnë pranë, ose nën kufirin e varfërisë, nuk mund ta përballojnë këtë program. Programi më i vogël është ai i

subvencioneve të strehimit, ndërkohë që këto programe shihen si zgjidhje e përkohshme e problemeve të strehimit. Programet e strehimit social duhet të zgjerohen më tej për të përmbushur kërkesat e grupeve në nevojë dhe duhet të riorientohen drejt shtresave në pozita të pafavorizuara, për përmbushjen e kritereve të përzgjedhjes nga më të varfrit.

*Gjatë vitit 2018, janë marrë në shqyrtim 55 ankesa nga individë, familje dhe grupe në nevojë apo në vështirësi ekonomike, ndaj organeve të qeverisjes vendore, për mostrajtimin dhe zgjidhjen e problemit të strehimit, krahasuar me 77 ankesa të marra në shqyrtim gjatë vitit 2017.*

Nisur nga problematikat e evidentuara nga ankesat e trajtuara ndër vite në këtë fushë është konstatuar se, kryesisht në zonat rurale por edhe në periferitë e qyteteve, ekziston një numër i konsiderueshëm familjesh, të cilat përballen me nevoja ekstreme për të siguruar strehim, pasi ndodhen në kushtet e pamundësisë totale të pagesës dhe përfitimit nga programet sociale të strehimit, që ofrohen aktualisht nga qeverisja vendore në bashkëpunim me qeverisjen qendrore. Ndërkohë, nga trajtimi i këtyre çështjeve ka rezultuar se ky problem ka qenë dhe mbetet shqetësim kryesor edhe për vetë veprimtarinë e organeve të qeverisjes vendore.

Avokati Popullit, në kuadër të zgjidhjes të problematikave të strehimit iu ka rekomanduar organeve shtetërore hartimin e një kuadri të plotë ligjor, të përafuar me standardet ndërkombëtare, që i përgjigjet realizimit efektiv të kërkesave të individëve dhe familjeve të tyre për strehim, duke garantuar kështu sigurimin e një vendstrehimi për çdo kategori individësh, familje në nevojë, apo në vështirësi ekonomike. Gjithashtu, vlerësohet se hartimi i legjislacionit duhet të shoqërohet me rritjen e buxhetit në këtë fushë, si dhe me mbështetjen që duhet të japë qeverisja qendrore ndaj organeve të qeverisjes vendore me projekte sociale të strehimit.

Nëse i referohemi statistikave, me përjashtim të Bashkisë Tiranë dhe ndonjë prej bashkive të mëdha në vend që kanë mundur të përfitojnë projekte nga programet sociale të strehimit, njësitë e tjera të qeverisjes vendore kanë mungesë kapacitetesh për të konkurruar në këto projekte dhe nuk kanë mundësi financiare, për të ndërtuar banesa sociale për kategoritë e familjeve në nevojë.

Avokati i Popullit, megjithë problematikat e konstatuara vit pas viti është i vetëdijshëm se një pjesë e njësisive të pushtetit vendor kanë vështirësi financiare për ndërtimin e banesave sociale, apo edhe për ofrimin e programeve të tjera, sikundër për shembull bonusi i qirasë sociale.

#### **4.12 Ndhimja Ekonomike**

Varfëria zyrtare e një shteti tregohet qartë me numrin e individëve apo familjeve, që trajtohen me ndihmë ekonomike, përkufizimi i të cilës në legjislacionin shqiptar është:

*“Ndhimja ekonomike është një pagesë e kufizuar në kohë dhe e kushtëzuar, që jepet në formën e një shpërblimi mujor në lekë, për kategoritë e përcaktuara. Kriteret e përfitimit të ndihmës ekonomike vlerësohen sipas nevojave dhe mbajnë parasysh gjendjen e varfërisë, të cilat vlerësohen bashkërisht, duke dhënë pesha specifike të qarta, objektive dhe transparente, si pjesë e një formule të pikëzuar”*

Në vitin 2018, për përfitimin e ndihmës ekonomike për shkak të varfërisë, filloi zbatimi i i sistemit të pikëzimit nëpërmjet regjistrimit elektronik, i cili është shtrirë në të gjithë vendin. Vënia në funksionim i këtij sistemi pikëzimi elektronik, ashtu si është parashikuar nga institucioni i Avokatit të Popullit në raportin vjetor të mëparshëm, solli shumë problematika. Mjafton të pohojmë faktin se u përjashtuan nga ky përfitim rreth 30% të përfituesve, midis të cilëve edhe individë apo familje me kushte të vështira jetese, siç u evidentua gjatë muajve të parë të vitit. Vlen të theksohet fakti i akordimit në masën 6% të bllok ndihmës ekonomike, që pas vlerësimit të gjendjes social-ekonomike të familjeve të përjashtuara nga skema e ndihmes ekonomike, vendimi merret nga Këshillat Bashkiakë.

Mirëpo, nëse u përjashtuan nga përfitimi 30% e përfituesve, rritja në masë e ndihmës ekonomike nuk u reflektua me një vlerë të përfillshme, për ta konsideruar këtë shumë dinjitoze në sigurimin e mjeteve më

të domosdoshme për të jetuar e jo më pastaj për të folur për qëllimin e saj: zhdukjen e varfërisë dhe riintegrimin në shoqëri.

Një problematikë e cila është evidentuar gjatë këtij viti, ka qenë për mosdhënien e së drejtës për të përfituar kompensimin financiar për shpenzimet e energjisë elektrike të kategorisë së personave që përfitojnë ndihmën ekonomike nga **fondi i kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6 %**. Mosdhënia e kësaj të drejte derivonte nga moszbatimi i drejtë i Udhëzimit nr.5 datë 17.02.2017 “*Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind*”, të ndryshuar.

Pas ndërhyrjes sonë institucionale për zgjidhjen e kësaj çështje, është miratuar Udhëzimi Nr. 15, datë 15.01.2019, “*Për një ndryshim dhe shtesa në udhëzimin nr. 8 datë 25.02.2015*” Për planifikimin e fondeve për ndihmën ekonomike”, i cili është botuar në Fletoren Zyrtare më datë 29.01.2019.

Institucioni i Avokatit të Popullit këtë vit ka trajtuar *80 ankesa nga qytetarët krahasuar me 36 ankesa të vitit 2017*, ndërkohë që problematikat kanë qenë pothuajse të njëjta. Shkak i rritjes të numrit të tyre, siç e theksuam edhe më lart, kanë qenë anomalitë që ka sjellë aplikimi i sistemit të pikëzimit në të gjithë vendin.

E drejta për të jetuar, nëse do të niseshim nga shuma e parave që përfitojnë individët apo familjet përfituese të ndihmës ekonomike, është në rrezik! Mos mundësimi nga Shteti Shqiptar i një minimumi dinjitoz jetik, pamundësia e ofrimit të shumë shërbimeve të kujdesit shoqëror, pa mundësia për të siguruar një strehim të përshtatshëm dhe të përballeshëm për t’u paguar; tregojnë qartë çka thamë më sipër.

Duke besuar se inicimi i një ligji të ri për ndihmën ekonomike nga Ministria e Shëndetësisë e Mbrojtjes Sociale, për të cilin po punohet në vazhdimësi, për të cilin institucioni i Avokatit të popullit ka kontribuar me mendime dhe sygjerime, do të përmirësojë apo eliminojë shumë problematika të evidentuara në vite.

#### **4.13 E drejta për sigurime shoqërore**

Sistemi i Sigurimeve shoqërore në vendin tonë përbën skemën kryesore të mbrojtjes shoqërore në Shqipëri. Skema e pensioneve luan një rol të rëndësishëm në mbrojtjen shoqërore dhe në luftën ndaj varfërisë. *Gjatë vitit 2018, pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, janë trajtuar 121 ankesa, përkundrejt 142 ankesa të trajtuara në vitin 2017.*

Problematika që ngrihet në ankesat e qytetarëve është pothuajse e njëjtë si në vitet e tjera paraardhëse. Konkretisht qytetarët ankohen për masën e përfitimit të pensionit të pleqërisë, mosnjohjen e vjetërsisë në punë, mosdhënien e invaliditetit nga Komisionet Mjekësore të Caktimit të Aftësisë për Punë, mospërfitimin e shtesave të pensionit të pleqërisë, mosnjohjen si periudhë sigurimi të viteve të dënimit me burg jo politik, mosmarrje përgjigje për kërkesat për rishqyrtim të pensionit të pleqërisë apo dhe të shqyrtimit të kërkesave ankimore ndaj vendimeve të Degëve të Përfitimeve pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, ndërprerje të padrejtë të pensioneve të pleqërisë, për mosvënie në dispozicion të kopjeve të dokumentacionit të dosjes të pensionit, mosdhënien e së drejtës për të përfituar pension suplementar, etj.

Përgjithësisht nga këto ankesa, kemi evidentuar se shpesh herë ankuesit, kryesisht për mosnjohje të ligjit, nuk kanë konsumuar shcallët e ankimit administrativ në Komisionet e Apelit pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore si dhe në Komisionin Qendror të Apelit pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Në këto raste ndihma jonë juridike ka qenë e favorshme duke i dhënë mundësinë qytetarit të qartësohet për problemin e tij, pa i hyrë procedurave të zgjatura administrative. Këtë veprim ua kemi orientuar që ta kryejnë në një moment të dytë, në qoftëse nuk mbeten të kënaqur dhe më pas t’i drejtohen komisioneve përkatëse të Apelit.

Gjithashtu nga ana e Institucionit tonë është bërë një punë jo e vogël për informimin e qytetarëve për zhvillimet e herë pas hershme lidhur me përmirësimet në ligjin nr.7703 datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, për ndikimet në masat e tyre të pensioneve. Kjo sepse është konstatuar fakti se shumë qytetarë kur i drejtohen Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore marrin përgjigje në mënyrë verbale dhe jo shkresore, duke mos u qartësuar për kërkesat e tyre.

Në vijim po paraqesim disa çështje të shqyrtuara gjatë vitit 2018:

-Mospërfshirja e personave të aksidentuar gjatë kryerjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak në ligjin nr.10142, datë 15.05.2009, “*Për sigurimin shoqëror suplementar të Ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të Punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të Punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë*”.

Pas trajtimit të bërë për këtë çështje me institucionet kompetente, Ministria e Mbrojtjes në muajin Korrik 2018 na ktheu përgjigje se do e riaktivizojë praktikën e nisur në vitin 2016, e cila parashikonte ndërhyrje në ligjin 10142/2009, me qëllim gjetjen e një zgjidhje ligjore për këtë problematikë. Kjo problematikë do vijojë për tu shqyrtuar, pasi ende nuk kemi asnjë nismë ligjore të marrë për këtë rast.

-*Mosdhënie e shtesës në masën e pensionit të pleqërisë të personave që janë pajisur me Dëshminë e Statusit të Punonjësit të Industrisë së Naftës dhe Gazit.*

Nga shqyrtimi i kësaj problematike, kemi konstatuar se mosdhënia e kësaj të drejte nga ana e Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore ka ardhur si pasojë e mosnxjerrjes së akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 8/2017 “*Për Statusin e Punonjësit të Industrisë së Naftës dhe Gazit*”, si dhe interpretimi i cunguar i kategorive përfituese.

Pas ndërhyrjes pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për këtë çështje, në muajin Gusht 2018, u informuam se janë duke u përgatitur të gjitha procedurat e nevojshme administrative në funksion të hartimit, shqyrtimit dhe miratimit të akteve nënligjore në Këshillin e Ministrave.

- *Mosmiratim i Statusit të Minatorit.* Ky status kërkohet, pasi minatorët në Shqipëri jetojnë në kushte shumë të vështitra ekonomike, masa të ulëta të pensioneve të pleqërisë, shumë prej minatorëve kanë humbur jetën në krye të detyrës dhe familja duhet të përfitojë një pension të posaçëm.

Në përgjigje të kërkesës sonë pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, jemi informuar se me Urdhërin e Përbashkët nr.158 datë 28.05.2018, është ngritur një grup pune për trajtimin dhe evidentimin e problemeve me pensionet e ish-minatorëve dhe hartimin e Statusit të Minatorit. Qëllimi i këtij grupi pune është që të përcaktojë pozitën juridike, ekonomike-financiare dhe sociale, të drejtat, detyrimet dhe kufizimet e punonjësve të nëntokës, duke garantuar një trajtim të veçantë për punonjësit e profesioneve të vështira në industrinë nxjerrëse dhe përpunuese.

- Një numër i konsiderueshëm ankesash, kanë patur si objekt masën e ulët të pensioneve të pleqërisë dhe kanë kërkuar ndërhyrjen tonë institucionale për rrillogaritjen e masave të pensioneve. Pas shqyrtimit të ankesave, u kemi rekomanduar Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, rrillogaritje të masave të pensioneve të pleqërisë. Rekomandimet tona janë marrë në konsideratë, duke u bërë rrillogaritjet e përkatëse të pensioneve. Disa ankues kanë përfituar rritje të masës së pensionit si dhe u janë dhënë diferencat përkatëse.
- Mbrojtja e të drejtave të emigrantëve në fushën e sigurimeve shoqërore, mbetet një detyrim ligjor për shtetin shqiptar, i cili duhet të intensifikojë përpjekjet për nënshkrimin e marrëveshjeve dypalëshe me shtetet fqinje, Itali dhe Greqi.



#### 4.14 Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara

Gjatë vitit 2018, janë depozituar dhe trajtuar 131 ankesa për këtë kategori. Duke e krahasuar me vitin 2017 (30 ankesa), rezulton se kemi një rritje mjaft të dukshme të numrit të ankesave.

Problematikat e trajtuara përgjithësisht gjatë këtij viti kanë qenë të njëjta si vitet e kaluara, por është rritur numri i ankuesve. Kjo për shkak të mosmarrjes së përfitimeve nga mosnxjerrja e akteve nënligjore për zbatimin e ligjeve si dhe moszbatimin e drejtë të akteve ligjore dhe nënligjore nga administrata publike. Më poshtë janë disa nga problematikat e trajtuara gjatë këtij viti:

- *Rregullimi i detyrimit ligjor të punëmarrësve për zbatimin e legjislacionit për punësimin të personave me aftësi të kufizuara.*

Në nenin 15 të Ligjit nr.7995 datë 20.09.1995 “Për nxitjen e punësimit”, i ndryshuar është përcaktuar: “Çdo punëdhënës që punëson më tepër se 24 punonjës, është i detyruar të punësojë një person me aftësi të kufizuar për çdo 25 punonjës të personelit të tij”.

Ndërsa në nenin 16 të tij, thuhet shprehimisht: “3. Një punëdhënës që nuk punëson numrin e rekomanduar të personave me aftësi të kufizuar siç tregohet në nenin 15, është i detyruar të paguajë në një llogari të veçantë në Fondin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, shumën e barabartë me minimumin e pagës, për çdo muaj dhe person me aftësi të kufizuar që ai duhej ta kishte punësuar, por që nuk ka vepruar kështu. Këto të ardhura përdoren për të krijuar vende pune për personat me aftësi të kufizuar.4. Këshilli i Ministrave cakton rregullat për zbatimin e paragrafit të mësipërm të këtij neni.”

Ekziston një vakum ligjor për zbatimin nga ana e punëdhënësve të këtij detyrimi ligjor. Nuk ka rregullim me akte ligjore të ekzistencës dhe administrimit të Fondit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit. Është ndërmjetësuar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë që të mundësohet krijimi i Fondit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe subjektet punëdhënëse të respektojnë detyrimin ligjor për punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Në përgjigje të kërkesës sonë për trajtimin e kësaj problematike, jemi informuar se Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ka hartuar projektligjin “Për nxitjen e punësimit”, i cili aktualisht është në proces miratimi në Këshillin e Ministrave. Në këtë projektligj janë përcaktuar edhe rregullat për mënyrën e derdhjes në Fondin Kombëtar të Punësimit, detyrim i punëdhënësve që nuk punësojnë personat me aftësi të kufizuara.

- *Mospërfitim i shtesës në masën e pensionit të invaliditetit, si përfitim paaftësie.*

Nga ana e Njesisë Administrative shtesa në pensionin e invaliditetit, si përfitim paaftësie nuk jepet një muaj pas daljes në komision, por u jepet një muaj pas dorëzimit të Vërtetimit Tip të marrë nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore. Pas shqyrtimit të ankesave, i jemi drejtuar me rekomandim Njesisë Administrative për dhënien e kësaj pagese një muaj pas daljes në komision, rekomandim i cili nuk është marrë në konsideratë.

Së fundmi, si për rastet kur komisionohen për herë të parë apo edhe kur invalidi i punës ndryshon vendbanim, nga ana e MSHMB-së është përgatitur draft-Udhëzimi i përbashkët “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.1406 datë 30.07.2018 “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit të nevojshëm për dhënien e përfitimit, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.869 datë 18.06.2008 “Për zbatimin e ligjit nr.7889 datë 14.12.1994 “Për Statusin e Invalidit”, i cili është dërguar për mendim dhe bashkëfirmosje në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë më datë 14.12.2018.

- *Mospërfitim i kompensimit të shpenzimeve për transportin urban dhe interurban të invalidëve të punës dhe personat që përfitojnë statusin e të verbërit.*

Pavarësisht se në ligjet e tyre specifike, është përcaktuar se masa dhe procedurat e këtij përfitimi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, nuk ka asnjë akt nënligjor me të cilin të rregullohet situata e këtyre kategorive përfituese. Nga korrespondenca e bërë për këtë çështje, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në përgjigje të kërkesës sonë, ka informuar se do të ngrejë një grup pune ndërinstitucional për përcaktimin e një formule kompensimi apo subvencionimi, masën, efektin financiar të saj dhe përgatitjen e projekt-vendimeve, të cilat do të konsultohen dhe me grupet e interesit.

- *Mosdhënia e së drejtës për të vijuar përfitimin në masën 200% të pagesës për shkak të verbërisë, për periudhën shkurt-maj 2018 të kategorinë e personave të cilët kanë ndjekur nivelin e dytë të kursit të avancuar të kompjuterit.*

Për këtë problematikë, e cila ka derivuar për shkak të keqinterpretimit të pikës 1 të Udhëzimit nr.47 datë 11.01.2018 për disa shtesa dhe ndryshime të Udhëzimit nr.2365 datë 26.11.2008 “Mbi zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.277 datë 18.06.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, i ndryshuar, që lidhet me zëvendësimin e termit “kurs kualifikimi” me “kurs formimi profesional”.

Nga shqyrtimi i këtij rasti, duke qenë se ky zëvendësim në këtë akt është bërë për unifikim të terminologjisë me legjislacionin në fuqi në fushën e punësimit dhe të formimit profesional dhe nuk kishte për qëllim kufizimin e të drejtave të fituara nga grupet e aftësisë së kufizuar, iu drejtuam me rekomandim Bashkisë Shkodër dhe Administratorit të Njësisë Administrative Rrethinë për dhënien e dyfishit të pagesës për shkak të verbërisë. Pas pranimit të rekomandimit, ankuesit përfituan të drejtat e tyre ligjore.

- *Mospërfitim i paketës higjieno-sanitare të personave që përfitojnë pagesën e aftësisë së kufizuar dhe invalidëve të punës.*

Sipas legjislacionit në fuqi, vetëm invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë përfitojnë një pagesë shtesë, në masën 16000 (gjashtëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj, për mbulimin e paketës së domosdoshme me materiale të veçanta higjieno-sanitare.

Duke qenë se për një kategori të caktuar të invalidëve të punës dhe personave që përfitojnë pagesën e aftësisë së kufizuar, të cilët janë deklaruar invalidë të plotë me vendim të KMCAP-ve, por që kanë nevojë për të përfituar paketën higjieno-sanitare, nuk ka asnjë parashikim ligjor që të rregullojë situatën e tyre, iu drejtuam Ministrisë Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Në përgjigje të kërkesave tona, në muajin Dhjetor 2018, jemi informuar se:

“Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është duke reformuar sistemin e vlerësimit të aftësisë së kufizuar, bazuar në standartet ndërkombëtare të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh) dhe Konventës së Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) “ Për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar”, duke kaluar nga vlerësimi mjekësor drejt vlerësimit bio-psiko-social. Kjo reformë do të mbështesë sipas nevojave individët me pagesa dhe shërbime me qëllim integrimin në jetën shoqërore. Paketa higjieno-sanitare do të përfitohet nga të gjithë ata persona që e kanë të domosdoshme këtë paketë dhe pavarësisht diagnozës apo statusit që ata kanë”.

- *Mosdhënia e së drejtës për të përfituar pensionin e invaliditetit për kategorinë e personave që në 5-vjeçarin e fundit para lindjes së të drejtës nuk kanë qenë në marrëdhënie pune, pavarësisht se plotësojnë kriteret mjekësore.*

Ligji nr. 9355 datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe Shërbimet shoqërore”, në nenin 4, pika 3, ka përcaktuar: “.3. “Person me aftësi të kufizuar (PAK)”, kuptohet invalidi, të cilit i është kufizuar aftësia, si pasojë e dëmtimit fizik, shqisor, të intelektit psiko/mendor, të lindura apo të fituara gjatë jetës nga aksidente, sëmundje të përkohshme apo të përhershme, të cilat nuk vijnë nga shkaqe që lidhen me punësimin.”

Pavarësisht se ka një Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Shërbimit Social Shtetëror dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore<sup>10</sup>, ku janë përcaktuar kategoritë që do të komisionohen në skemën e aftësisë së kufizuar të Shërbimit Social Shtetëror, ligji i sipërcituar e ka të përcaktuar qartazi se nuk ka kufizime të personave pretendues për të përfituar pagesën e aftësisë së kufizuar, ku aftësia e kufizuar nuk lidhet me shkaqe të punësimit. Aktualisht, për këtë problematike i jemi drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror dhe mbetemi në pritje të përgjigjes.

- *Mosdhënia e të drejtës për të përfituar rimbursimin për shpenzimet në blerjen e karburantit dhe vajit lubrifikant për invalidët që kanë mjete motorrike në përdorim, të cilët janë deklaruar me grup invaliditeti pas vitit 2011.*

Ligjet specifike për personat që gëzojnë statusin e invalidit të punës, të invalidit paraplegjik e tetraplegjik dhe statusin e të verbërit<sup>11</sup>, i japin të drejtën këtyre kategorive për të përfituar rimbursimin e shpenzimeve për blerjen e karburanteve dhe të lubrifikanteve për mjetet motorrike në përdorim të përshtatura për ta. Ata invalidë, që e kanë përfituar këtë të drejtë para vitit 2011, vijojnë ende ta marrin këtë përfitim, ndërsa invalidët e tjerë që janë pajisur me mjete motorrike pas muajit Korrik 2011, nuk e përfitojnë këtë rimbursim.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 10458 datë 21.07.2011 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare, të ndryshuar”, invalidët përjashtohen nga detyrimi për të paguar vetëm taksën e zhdoganimit të makinës, por nuk i jepet e drejta për të përfituar rimbursimet përkatëse.

Theksojmë faktin se asnjë nga aktet nënligjore në zbatim të ligjeve specifike për kategoritë e sipërcituara për përfitimin e kësaj të drejte, nuk është shfuqizuar apo ndryshuar. E gjithë kjo situatë dhe penaltet ka ardhur si pasojë e moszbatimit të ligjit.

Pas shqyrtimit në vijimësi të kësaj problematike, jemi informuar se Instituti i Sigurimeve Shoqërore është duke bashkëpunuar me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për t’i dhënë zgjidhje kërkesave të kësaj kategorie.

Lidhur me mungesën e përshtatshmërisë ndërtimore, i është dërguar rekomandim: Drejtorit të Qendrës Shëndetësore Kukës për marrjen e masave për realizimin e përshtatshmërisë ndërtimore për personat me aftësi të kufizuar, si dhe Drejtorit të Spitalit Rajonal Shkodër për realizimin e përshtatshmërisë së rampës në hyrjen kryesore të këtij Spitali. Rekomandimet e institucionit të Avokatit të Popullit u morën në konsideratë dhe janë zbatuar.

Duhet të theksojmë faktin se lëvizja e lirë e personave me aftësi të kufizuara është një parakusht i mundshëm drejt përfshirjes së plotë në shoqëri. Në këtë kuadër ka një rëndësi themelore aksesit në ambientet fizike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore.

#### **4.15 Të drejtat e fëmijëve**

---

<sup>10</sup> Marrëveshjes së Bashkëpunimit midis SHSSH dhe ISSH nr. 556/1 datë 11.03.2015 dhe Udhëzimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror Tiranë, ku citohet se: Personat, të cilëve u është kufizuar aftësia për punë nga sëmundje që nuk vijnë për shkak të punësimit, është udhëzuar që: 1. Personat që kanë vetëm vite ushtrie, por nuk kanë punuar ndonjëherë, pavarësisht se ushtria njihet si kontribut. 2. Personat që nuk kanë asnjë vit të punësuar, por kanë derdhur për një kohë kontribut vullnetar. 3. Personat që nuk kanë punuar ndonjëherë, por shkolla e lartë u njihet si vjetërsi pune. 4. Personat që kanë punuar në kooperativë. Të gjitha rastet e mësipërme do të komisionohen në skemën e aftësisë së kufizuar të SHSSH..”

<sup>11</sup> Ligji nr. 8098/28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”, i ndryshuar

Ligji nr. 8626/22.06.2000 “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, i ndryshuar

Ligji nr. 7995/20.09.1995 “Për statusin e invalidëve të punës”, i ndryshuar

Veprimtaria e institucionit të Avokatit të Popullit për të drejtat e fëmijëve gjatë vitit 2018, ka vijuar e ndërthurur në dy funksione kryesore, atë të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të fëmijëve. Fokusi i punës u mbështet në rritjen e vizibilitetit në terren, trajtimin të problematikave më të ndjeshme të të drejtave të fëmijëve, si dhe përgatitjes dhe botimit të materialeve promovuese, duke mundësuar përfshirjen e fëmijëve në vendimmarrje.

Në sistemin e regjistrimit të rasteve të trajtuara gjatë vitit 2018, *janë trajtuar me iniciativën e Avokatit të Popullit 94 raste, me objekt të drejtat e fëmijëve*. Pavarësisht numrit të ankesë/kërkesave të trajtuara, theksojmë se shumë nga ankesat e trajtuara kanë patur si objekt një numër të caktuar individësh-fëmijë, por mund të themi se nga trajtimi i tyre dhe rekomandimet përkatëse, kanë përfituar një numër më i madh fëmijësh. Në këtë kuptim, *janë trajtuar rreth 145 ankesa/kërkesa dhe raste me iniciativë*, me objekt shkeljen e të drejtave të fëmijëve nga veprimet dhe mosveprimet e organeve të administratës publike. Nga numri total i trajtimit të rasteve në sistemin e regjistrimit, kanë marrë zgjidhje pozitive, si dhe *janë sqaruar 68 raste, ku rreth 25 prej tyre kanë përfunduar me rekomandime*.

Avokati i Popullit gëzon tagrin ligjor për monitorimin e respektimit të të drejtave të personave të privuar nga liria, ku përfshihen edhe të miturit. Dhe, në këto raste, institucioni i AP-së ka paraqitur rekomandimet apo propozuar masat për përmirësimin e situatës në shkelje, të cilat janë pjesë e punës monitoruese nga MPKT<sup>12</sup>.

Rastet me iniciativë, të trajtuara përgjatë vitit 2018, janë nxjerrë nga publikimet e ndryshme në mediat e shkruara dhe vizive. Kryesisht, objekt i përbashkët i shumicës prej tyre kanë qenë problematika sociale, trajtim familjesh me shumë fëmijë, si nga sistemi i ndihmës ekonomike, ashtu dhe me shërbime të kujdesit shoqëror, si dhe raste të abuzimit ndaj të miturve. Njëpërmjet trajtimit të rasteve me iniciativë, nga korrespondencat e shkëmbyera me përfaqësues të pushtetit qendror dhe vendor<sup>13</sup> kemi synuar, jo vetëm zgjidhjen e problematikave të parashtruara mediatikisht, por edhe promovimin dhe nxitjen e kulturës së respektimit të të drejtave, në zbatimin e interesit më të lartë të fëmijëve, në përputhje edhe me detyrimet ligjore që burojnë nga legjislacioni në fuqi në fushën e të drejtave dhe mbrojtjen e fëmijës.

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së institucionit të Avokatit të Popullit në vitin 2018, për të gjitha rastet e shqyrtuara dhe trajtuara, konstatohen një sërë problematikash dhe vlerësojmë, se sfidat për zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, lidhen me:

- ✓ buxhetimin real të nevojshëm, nisur nga perspektiva e të drejtave të fëmijëve;
- ✓ ngritjen e shërbimeve të reja në ndjekje të dinamikës së nevojave të fëmijëve;
- ✓ hartimin e politikave gjithëpërfshirëse sociale në nivel vendor, të bazuara në një bazë të dhënash të sakta mbi numrin e familjeve në nevojë, si dhe kategoritë e fëmijëve me probleme sociale;
- ✓ konsolidimin e mekanizmave shtetërorë përgjegjës, që garantojnë realizimin efektiv të mbikëqyrjes, promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, si dhe krijimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve;
- ✓ mungesën e shërbimeve të specializuara për fëmijët e dhunuar seksualisht;
- ✓ mungesën e një stafi të trajnuar dhe kualifikuar për identifikimin, referimin, mbrojtjen, hetimin dhe riintegrimin e viktimave, fëmijë të abuzuar seksualisht në të gjitha fushat e veprimtarisë së organeve përkatëse në arsim, shëndetësi, polici, strukturat e mbrojtjes së fëmijëve në nivel vendor, etj;
- ✓ mungesën e trajtimit me profesionalizëm në mediat e shkruara dhe vizive, të rasteve komplekse dhe delikate të fëmijëve të abuzuar seksualisht, neglizhuar ose dhunuar, të të miturve në konflikt me ligjin,

<sup>12</sup> Janë 10 inspektive të Mekanizmit kundër Torturës, ku përfshihen edhe të drejtat e të miturve në konflikt me ligjin.

<sup>13</sup> Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve pranë bashkive; Ministrinë (e Shëndetësisë dhe Kujdesit Social; Drejtësisë, etj); Shërbimi Social Shtetëror; Drejtorinë e Burgjeve, etj. Ndërkohë, që Njësia për Parandalimin e Torturës korrespondencën e saj e ka kryesisht me Drejtorinë e institucioneve të privimit të lirisë, Shërbimin e Provës, Komisaritet e Policisë, etj.

viktima dhe/ose dëshmitarë, lidhur me mbrojtjen e jetës private dhe ruajtjen e konfidencialitetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në ndryshim nga viti 2017, gjatë vitit 2018, promovimi i të drejtave të fëmijëve nga institucioni i Avokatit të Popullit, është realizuar si një proces me pjesëmarrjen e vetë fëmijëve, të cilët kanë njohur dhe zhvilluar të drejtat e tyre, duke qenë edhe kontribuesit kryesorë në drejtim të ndërgjegjësimit dhe advokimit të të gjithë shoqërisë për këto të drejta.

Institucioni i Avokatit të Popullit, nëpërmjet fushatave sensibilizuese ka vënë në zbatim udhëzuesin “*Për bashkëpunimin e institucionit të Avokatit të Popullit me fëmijët dhe me shoqërinë civile*”, ku instrumentat e propozuar nga vetë fëmijët, kanë mundësuar rritjen e bashkëpunimit të institucionit të Avokatit të Popullit me ta dhe shoqërinë civile.

Hartimi i dokumentit “*Paketa e standardeve, pjesëmarrja e fëmijëve në vlerësimin e shërbimit*”, si metodologji pune gjatë kryerjes së inspektimeve, që do të realizohen nga institucioni i Avokatit të Popullit për të garantuar pjesëmarrjen e fëmijëve, gjatë procesit të vlerësimit të institucioneve shtetërore, të cilat ofrojnë shërbime publike për fëmijët, është një tregues domethënës, i cili dëshmon për ecjen me hapa të sigurt në drejtim të përmbushjes së parimeve dhe standardeve ndërkombëtare, ndër më të rëndësishmit parimi “e drejta e fëmijëve për t’u dëgjuar dhe për të qenë pjesë e proceseve vendimmarrëse”, ku mendimi dhe zëri i tyre tash, do të dëgjohej edhe më shumë.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka krijuar partneritet me “Grupin e të Rinjve Zëri 16+” (mbështetur nga Save the Children). Ky instrument kryesor shërbeu për të lobuar dhe advokuar në partneritet me fëmijët dhe shoqërinë civile në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të gjetjeve të raportit “*Zëri i të rinjve 16+ në Shqipëri*”, i cili përbën një studim mbi vlerësimin e pikëpamjeve të fëmijëve, lidhur me problematikat e tyre sipas përcaktimeve të KDF-së.

Në kuadër të ditëve të shënuara në fushën e të drejtave të fëmijëve, institucioni i Avokatit të Popullit ka realizuar një sërë veprimtarish promovuese, të tilla si:

- “*Ndal shfrytëzimit të punës së fëmijëve*”, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare kundër Shfrytëzimit Ekonomik të Fëmijëve, organizuar në Bashkinë Bulqizë, me qëllim ndërgjegjësimin e shoqërisë dhe institucioneve shtetërore, nëpërmjet identifikimit në mënyrë aktive të rasteve të shfrytëzimit të fëmijëve për punë, si dhe trajtimit me prioritet të çdo rasti të raportuar të fëmijës së shfrytëzuar dhe ndërmarrjes së veprimeve konkrete, për largimin e fëmijës nga situata e shfrytëzimit ekonomik. U hartua raporti i veçantë “*Puna e fëmijëve në Bashkinë Bulqizë*”, pikërisht për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik, që paraqet rreziqe për shëndetin fizik dhe mendor, për mirëqenien e zhvillimin tërësor dhe cënnon edukimin e tyre.

Qëllimi i këtij raporti ishte, jo vetëm konstatimi dhe evidentimi i gjendjes aktuale të nivelit të zbatimit të detyrave funksionale të institucioneve në nivel vendor, konkretisht, prefektit, bashkisë Bulqizë, njësisë për mbrojtjen e fëmijës, drejtorisë Rajonale Arsimore, drejtorisë Rajonale të Punësimit, drejtorisë Rajonale të Inspektoratit të Punës, drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, drejtorisë Rajonale të Tatimeve, Komisarariatit të Policisë Bulqizë, por edhe dhënia e rekomandimeve për këto institucione përgjegjëse.

- “*Së bashku në emër të dashurisë*”, në kuadër të Ditës së Shenjtërimit të Nënë Terezës, me qëllim promovimin e vlerave të Nënë Terezës dhe Janusz Korczak, të cilët ofruan shërbime në emër të dashurisë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, duke e konsoliduar këtë vlerë me fëmijët tek fëmijët.

“*Përtej klisheve - festojmë së bashku me fëmijët me aftësi të kufizuara*”, në kuadër të festave të fundvitit 2018, ku institucioni i Avokatit të Popullit organizoi në mjediset e institucionit një veprimtari me fëmijët me aftësi të kufizuara, që marrin shërbime të përkujdesit social rezidencial.

Aspekt pozitiv ka shënuar bashkëpunimi me institucionet shtetërore, sidomos në pranimin e rekomandimeve të adresuara, por mbetet ende sfidë zbatimi i rekomandimeve të pranuar. Nga inspektimet e realizuara në institucionet e arsimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe Njësisë Për Mbrojtjen e Fëmijëve (strukturat e menaxhimit të rastit pranë bashkive), janë konstatuar mungesa e kapaciteteve (burimeve njerëzore) dhe mundësitë e kufizuara financiare, të cilat bëjnë që qeverisja vendore të mos i përgjigjet kërkesave për ngritjen e shërbimeve të reja në ndjekje të dinamikës së nevojave të fëmijëve.

Gjithashtu, vërehen probleme të mungesës së koordinimit dhe institucionalizimit të bashkëpunimit, ndërmjet qeverisjes vendore, OJF-ve dhe strukturave të tjera shtetërore. Konstatohet, se njohuritë në lidhje me zbatimin e të drejtave të fëmijëve në praktikën e përditshme, janë ende të kufizuara me gjithë trajnimet që janë ofruar herë pas here nga organizata të ndryshme. Institucionet duhet të punojnë çdo ditë për të forcuar sistemin e denoncimit dhe të referimit të rasteve.

Risi për vitin 2018 ishte publikimi i Raportit të Komisionerit për të Drejtat e Njeriut në Këshillin e Evropës<sup>14</sup>, zj.Dunja Mijatovic, pas vizitës së saj në Shqipëri, më 21-25 maj 2018. Lidhur me problematikat e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, përfundimet e Komisioneres së Lartë, janë plotësisht në një linjë me konstatimet dhe rekomandimet, që Avokati i Popullit ka nxjerrë në raportet e punës vjetore, raportet e veçanta dhe të bëra publike, si edhe në veprimtaritë promovuese dhe daljet publike në mediane dhe vizive.

Gjetjet dhe rekomandimet e Raportit të Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut, në Këshillin e Evropës, kanë shërbyer si udhërrëfyes në punën tonë, për hartimin e rekomandimeve të vlefshme për institucionet e administratës shtetërore, por jo vetëm.

Kjo, pasi të drejtat njerëzore të fëmijëve (dhuna ndaj fëmijëve, fëmijët pa kujdes prindëror, drejtësia për të mitur, e drejta për arsimimin gjithpërfshirës, me fokus fëmijët romë dhe fëmijët me aftësi të kufizuara), personat pa shtetësi, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara (aksesueshmëria, e drejta e personave me aftësi të kufizuara për një jetesë të pavarur dhe përfshirja e tyre në shoqëri), si dhe problematikat e ndihmës juridike falas, përbëjnë objektin dhe prioritetet e veprimtarisë dhe misionit të institucionit të Avokatit të Popullit në të ardhmen.

---

<sup>14</sup> Raporti i Komisionerit për të Drejtat e Njeriut në Këshillin e Evropës, zj.Dunja Mijatovic, datë 13.9.2018.

## KREU 5

### Angazhime të tjera institucionale

#### 5.1. Raporti i veçantë për problematikat që lidhen me zbatimin e projektit për ndërtimin e segmentit rrugor “Unaza Lindore Tiranë”, në zonën e Shkozës

Bazuar në njoftimin e bërë në media në muajin shtator 2017, Avokati i Popullit ka filluar me iniciativë shqyrtimin e problematikave që lidhen me zbatimin e projektit për ndërtimin e segmentit rrugor “Unaza Lindore Tiranë (Loti III), (Sistemimi i shtratit të Lumit të Lanës dhe ndërtimi i rrugëve paralele, segmenti Materniteti i Ri, Unaza e Jashtme e Tiranës)”. Ndërkohë janë shqyrtuar paralelisht edhe 9 ankesa individuale dhe një ankim-peticion, mbi këtë problematikë. Pas shqyrtimit administrativ nga ana jonë janë konstatuar këto gjetje kryesore:

##### 5.1.1 Procesi i shpronësimit në zonën e Shkozës, me subjekt përfitues Autoritetin Rrugor Shqiptar (ARRSH).

Pas kërkesave tona paraprake drejtuar ARRSH-së, ky i fundit me shkresën nr. 6988/1 prot. datë 21.09.2017, na ka informuar se po vijonte puna në terren për evidentimin e pasurive që prekeshin nga zbatimi i këtij projekti dhe më pas do të vijohej me plotësimin dhe dërgimin për shqyrtim në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës (MTI), të kërkesës për shpronësim (shtesë), ku do të trajtoheshin të gjitha pasuritë pronë private që do të përfitonin shpronësim bazuar në legjislacionin në fuqi. Edhe pas kërkesës së re për shpjegime drejtuar këtij organi publik, në përgjigjen e dërguar me mbi 2 muaj vonesë, ARRSH-ja ka vijuar të theksojë faktin se kishte plotësuar dhe dërguar në MTI, “Kërkesën për shpronësim” (shtesë), me nr. 1464 prot. datë 23.02.2017, në të cilën janë trajtuar pasuritë pronë private, “arë” dhe “truall”, të konfirmuar në vazhdim nga ana e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive Paluajtëshme. Në vijim është dorëzuar me shkresën me nr. 9053 datë 10.11.2017,<sup>15</sup> kërkesa për shpronësim pranë Ministrisë së Industrisë dhe Energjistikës (MIE), për 49 pasuri, përkatësisht të llojit “arë”, “truall”, “ndërtesë” dhe objekte biznesi, me vlerë totale 614 591 261.1 lekë.<sup>16</sup> Po kështu jemi informuar se, janë bërë dy pagesa me vlerë 24 296 791 lekë, në zbatim të VKM nr. 557 datë 27.07.2016.<sup>17</sup>

ARRSH-ja ka pohuar gjithashtu se kishin paraqitur dokumentat për kompensim sipas ligjit, vetëm 5 pronarë, me vlerë 20 716 102 lekë, për të cilët po vijonte procedura për pagesë. Këto pagesa nuk ishin kryer ende, *pasi kishte mungesë fondesh*, për të cilat ishin në pritje. Ky justifikim i dhënë, është i pambështetur në ligj, pasi sipas parashikimeve ligjore në fuqi, fondi i pagesave duhet siguruar para se të fillojë shpronësimi.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, i ndryshuar, nga ana jonë është evidentuar se:

- Për disa pasuri që prekeshin nga zbatimi i projektit ishte miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr.557 datë 27.07.2016 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza Lindore Tiranë (Loti III)”. Ndërkohë që po punohej për një “Kërkesë për shpronësim” shtesë, ku pritej të evidentoheshin pasuri të tjera,<sup>18</sup> që prekeshin nga zbatimi i këtij projekti dhe kërkohej përfshirja e tyre në procesin e

<sup>15</sup> Kjo shkresë rezultoi të jetë dërguar pas Kërkesës së parë për shpjegime, dërguar ARRSH-së nga Avokati i Popullit, në të cilën kërkohej informacion mbi procedurat që kishte ndërmarrë ARRSH në Shkozë.

<sup>16</sup> Kjo shkresë është dërguar bashkëngjitur dhe administrohet tashmë nga ana jonë.

<sup>17</sup> Në zbatim të VKM 557/20156, vlera e përgjithshme e shpronësimit, për pasuritë “truall” dhe “pyll” është 253 220 184 (dyqind e pesëdhjetë e tre milionë e dyqind e njëzet mijë e njëqind e tetëdhjetë e katër) lekësh, dhe do të përballohej nga buxheti i vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës, zëri “Shpronësim”, planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar. Megjithatë duhet theksuar se, zbatimi i këtij VKM nuk mund të kryhet pa një mbulim adekuat me fonde, pasi në të kundërt mund të jemi në kushtet e konsumimit të veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”.

<sup>18</sup> Konkretisht janë 49 pasuri arë, truall, ndërtesë dhe objekte biznesi me vlerë totale 614 591 261.1 lekë.

shpronësimit. Kjo procedurë shtesë e dërgimit të kërkesës për shpronësim, nga ana jonë është gjykuar e pajustificuar dhe shumë problematike për situatën juridike të pronarëve që prekeshin në pronësitë e tyre, ndërkohë që, në zonën e zbatimit të projektit ishte ndërhyrë nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT), Tiranë, për prishjen e disa objekteve.

- Pronarët që dispononin dokumentacione të rregullta pronësie nuk kishin përfituar ende vlerën e shpronësimit, megjithëse ligji nr. 8561 datë 22.12.1999, parashikon domosdoshmërisht përfundimin e procedurave të shpronësimit dhe më pas vijimin e zbatimit të projektit publik. Në këto rrethana, situata ligjore e trajtimit të banorëve që dispononin këto pasuri bëhej më e paqartë, ndërkohë që kishte ndodhur edhe prishja e disa banesave në këto kushte.
- VKM nr.557 datë 27.07.2016, nuk përcakton shprehimisht afatin dhe mënyrën e pagimit për pronarët që shpronësohen, për pronarët e pasurive që zhvlerësohen, si dhe për personat e tretë që kompensohen për të drejtat e tyre për shkak të pronësimit. Po kështu, nuk përcaktohej afati

i fillimit dhe mbarimit të shpronësimit si dhe afati i fillimit dhe përfundimit të punimeve për projektin, ose për realizimin e qëllimit të shpronësimit.

Në këtë kuadër kemi evidentuar se, duke konsideruar zvarritjen e procedurave të kompensimit të banorëve për efekt të shpronësimit dhe verifikimet e tjera shtesë të pasurive që prekeshin nga zbatimi i projektit, kjo procedurë shpronësimi bëhej e pavlefshme në kuptim të pikës 3, e nenit 26, të Ligjit 8561/1999, i ndryshuar. Kjo pavlefshmëri mund të vlerësohet edhe në kuadër të përmbushjes së kritereve të përcaktuara në pikën 1, të nenit 26, të Ligjit nr. 8561/1999, i ndryshuar.

Avokati i Popullit thekson faktin se, mënyra e garantimit dhe mbrojtjes të së drejtave të pronësisë të shtetasve që shpronësohen, duhet të zhvillohet përmes një procedure të rregullt ligjore shpronësimi, duke patur parasysh likuidimin e plotë për vlerën e shpronësimit të subjektit, si edhe përcaktimin e një afati përmbyllës së këtij procesi brenda një kohë sa më të shkurtër dhe të arsyeshme, si pjesë e një procesi të rregullt administrativ. Pagesa e dëmshpërblimit mund t'i nënshtrohet shtyrjeve ose mënyrës së pagimit me këste, por në asnjë rast personat nuk duhet dhe nuk mund të humbasin të drejtën e gëzimit të sendit, pa marrë plotësisht pagesën e dëmshpërblimit.

### **5.1.2 Prishja e ndërtimeve në zonën e Shkozës, Tiranë, në zbatim të Projektit “UnazaJashtme e Tiranës”, Loti III. Veprimtaria e IKMT-së dhe ALUIZNI-t.**

Për verifikimin e ligjshmërisë së veprimtarisë të nisur prej IKMT-së, për prishjen e ndërtimeve në zonën e Shkozës, institucioni i Avokatit të Popullit, i është drejtuar zyrtarisht disa organeve dhe institucioneve shtetërore për dhënie informacioni, apo shpjegimesh. Po kështu është analizuar edhe veprimtaria e ALUIZNI-t.

- Me shkresën nr.K3/I39-3 prot, datë 15.09.2017, i është kërkuar Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t, informacion rreth subjekteve, të cilët kanë vetëdeklaruar ndërtime informale për legalizim në zonën e Shkozës, Tiranë, si dhe vënien në dispozicion të akteve zyrtare të nxjerra, për secilin subjekt vetëdeklarues.

Vënia në dispozicion e informacionit të kërkuar prej ALUIZNI-t, ka qënë e pjesëshme, pasi janë vënë në dispozicion vetëm kopje të vendimeve për skualifikimin e ndërtimeve nga procesi i legalizimit, si dhe të kopjeve të njoftimeve zyrtare të dërguara secilit person. Por ka munguar dërgimi i kopjes së të gjithë akteve të administruara prej ALUIZNI-t, në dosjet e veçanta të krijuara mbi bazën e vetëdeklarimeve të cilitdo prej subjekteve të prekur nga zbatimi i projektit.

- Me shkresën nr.K3/I39-2 prot, datë 15.09.2017, i është kërkuar Kryeinspektorit të IKMT së, vënia në dispozicion e të gjithë akteve zyrtare të nxjerra për secilin subjekt, ndërtimet e të cilëve janë përcaktuar si objekte për prishje prej IKMT-së, në zonën e Shkozës, Tiranë.



Kryeinspektori i IKMT-së, me shkresën nr.3498/3 prot, datë 25.09.2017, na ka bërë të ditur se veprimet për prishjen e ndërtimeve janë në mbështetje të kërkesës së ARRSH, (drejtuar IKMT me shkresën nr.5736, datë 12.07.2017), ku kërkohet lirimi i sheshit të ndërtimit. Na janë vënë në dispozicion kopjet e akteve administrative të nxjerra vetëm për një kundërvajtës, ndërtimi i të cilit ishte prishur në datën 20.09.2017. Pas më shumë se një muaji nga përsëritja e kërkesës sonë, Kryeinspektori i IKMT, me shkresën nr. 3911/1 prot, datë 18.10.2017, na janë dërguar kopjet e akteve të nxjerra ndaj 50 subjekteve, 43 prej të cilëve të sanksionuar me vendim për prishje objekti.

Nga shqyrtimi i ankesave individuale ndaj ndërhyrjeve të kryera prej IKMT-së ka rezultuar që, procedura e njoftimit subjekteve përkatëse të proces verbaleve të konstatimit të kundërvajtjes, është kryer në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Mosveprimi i IKMT dega Tiranë, ka rezultuar në kushtet e parashikuara nga Ligji nr.8510 datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës publike”, i ndryshuar, pasi realisht i është shkaktuar dëm subjekteve poseduese të ndërtimeve tashmë të shembura, në kushtet e trajtimit të këtyre çështjeve në kundërshtim me parashikimet ligjore në fuqi.<sup>19</sup> Në këto rrethana i kemi rekomanduar Kryeinspektorese të IKMT-së, në dy raste; *“Fillimin e procedurave administrative për shpërblimin e dëmit, shkaktuar subjekteve përkatës, si pasojë e e ndërhyrjes nga ana e IKMT-së për prishjen e banesave të tyre, në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr.8510 datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës publike”, i ndryshuar.*

- Me shkresën nr.K3/I39-19 prot, datë 24.10.2017, i kemi drejtuar ARRSH-së, për vënien në dispozicion të kopjes së Vendimit përkatës, për miratimin e projektit, *“Unaza e Jashtme e Tiranës”, Loti III (Sistemimi i shtratit të Lumit të Lanës dhe ndërtimi i rrugëve paralele, segmenti Marteniteti i Ri, Unaza e Jashtme e Tiranës)*, si dhe të një kopjeje të shkresës nr. 5736 prot, datë 12.07.2017, që ARRSH-ja i ka dërguar IKMT-së.

Përkundër kopjes së Vendimit për miratimin e projektit *“Unaza e Jashtme e Tiranës”, Loti III*, na është dërguar një kopje e Vendimit nr. 89, të Këshillit Teknik të ARRSH, administruar prej tij me nr.10369 Prot, datë 15.12.2016, me objekt: *“Ndërtim i Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa Verilindore (segmenti kthesa e Saukut – Bregu i Lumit), Loti 3”*.<sup>20</sup> Në këto kushte kemi ripërsëritur kërkesën tonë për dërgimin e kopjes së Vendimit për miratimin e projektit. ARRSH me shkresën nr.9315/2 datë 30.11.2017, na ka dërguar në vazhdim një kopje të Vendimit të datës 20.02.2013, të Këshillit Teknik të Autoritetit Rrugor Shqiptar, *“Mbi shqyrtimin e projekt-zbatimit të objektit “Studim-projektim, Ndërtim i rrugës së Unazës së Jashtme të Tiranës, vazhdimi që kalon nga kthesa e Saukut-pjesa lindore, Verilindore, Veriore e Tiranës – deri në afërsi të kthesës së Kamzës (Zyrat e AMC)”*. Pra, pavarësisht kërkesave tona nuk na është dërguar kopja e Vendimit për miratimin e projektit, si dhe nuk na është dhënë asnjë shpjegim lidhur me këtë fakt.

- Mospërfundimi i procedurës respektive administrative për shqyrtimin e vetëdeklarimeve dhe daljen me vendim përfundimtar, nga ana e ALUIZNI-t, në afatet ligjore të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

<sup>19</sup> Në nenin 3/a, të Ligjit nr.8510 datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës publike”, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Organet e administratës shtetërore përgjigjen për dëmet që u shkaktojnë personave fizikë a juridikë private, në rastet që vijnë: - Kur kryejnë veprime a mosveprime të kundërligjshme”*.

<sup>20</sup> Në përmbajtjen e Vendimit nr. 89, të Këshillit Teknik të ARRSH, administruar prej tij me nr.10369 Prot, datë 15.12.2016, thuhet shprehimisht se: *“Këshilli Teknik i ARRSH-së, i mbledhur në datë 14.12.2016...mori në shqyrtim materialet me propozimet për ndryshime/përmirësime/modifikime/saktësime dhe shtesë punimesh, në projekt – preventivin e objektit “Ndërtim i Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa Veri-lindore (segmenti kthesa e Saukut – Bregu i Lumit), Loti 3. Po kështu në pjesën e dispozitivit të këtij vendimi, në pikën e tij të parë thuhet shprehimisht: “Të miratojë në parim propozimet e kontraktorit të aprovuara nga mbikqyrësi i punimeve për saktësime, ndryshime/modifikime, përmirësime e plotësime të projekt-preventivit, dhe punimet shtesë në objektin “Ndërtim i Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa Verilindore (segmenti kthesa e Saukut – Bregu i Lumit), Loti 3”*.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ana e ALUIZNI-t, rezulton se, poseduesit e ndërtimeve informale të ndodhura në zonën ku po zbatohet projekti kanë kryer vetëdeklarim për legalizim, që nga viti 2005 e deri më datë 27.06.2014. Në rast se do të zhvillohej procedura administrative e shqyrtimit të vetëdeklarimit për legalizim, brenda afatit ligjor të parashikuar nga neni 49,<sup>21</sup> i Ligjit nr.8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, meqënëse Ligji nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, nuk parashikon afate kohore për përfundimin e kësaj procedure, statusi juridik i ndërtimeve në Shkozë do të ishte i ndryshëm nga ai që paraqitet sot.

- Nga ankesat e shqyrtuara, për ecurinë e procesit të legalizimit të ndërtimeve në zonën e Shkozës, Tiranë, kemi konstatuar në disa raste gjithashtu se, ALUIZNI ka kryer procedura ligjore deri në lidhje kontrate për kalim pronësie të parcelës ndërtimore, siç është edhe rasti i ankuesit H.L, i cili ka lidhur “Kontratën e kalimit të pronësisë të parcelës ndërtimore”, me ALUIZNI-n, Drejtoria Rajonale, Tiranë, (me nr. 3792 Rep, nr.1491 Kol, datë 04.06.2009, redaktuar para Noteres M.SH). Kjo kontratë është lidhur në kushtet e përmbushjes së kriterëve të parashikuara në nenin 39, të Ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, dhe paragrafin 1, pika 2, shkronjat “a”, “b”, dhe “dh”, të VKM nr.438, datë 28.06.2006 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe dokumentacionit të zbatueshëm, për të kualifikuar objektet në ndërtim, që legalizohen ose jo”, i ndryshuar”.
- Pesë vjet më vonë, ALUIZNI, me Vendimin Nr.90, Datë 17.11.2014, ka vendosur përjashtimin nga procesi i legalizimit të objektit informal në posedim të subjektit H.L. Ky vendim është i paligjshëm, pasi në kushtet kur kontrata për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore është lidhur midis ALUIZNI-t dhe subjektit të interesuar, atëherë parcela ndërtimore cilësohet e kaluar në pronësi subjektit. Ky subjekt rrjedhimisht duhej të shpronësohej.
- Është evidentuar fakti se, për disa parcela ndërtimore është miratuar kalimi në pronësi i tyre subjekteve posedues, konform parashikimeve të VKM Nr.125, Datë 17.02.2010 “Për miratimin e kalimit në pronësi të disa parcelave ndërtimore në favor të poseduesve të objekteve informale”. Edhe pse ky vendim i Këshillit të Ministrave është në fuqi, zbatimi i tij nuk është kryer deri më sot prej ALUIZNI-t, si organ publik që ka këtë detyrim ligjor.

### 5.1.3 Situata e dëbimit me forcë

Nga të dhënat e marra rezultonte se do të prekeshin nga zbatimi i projektit rreth 169 objekte-ndërtime. Nisur nga ky fakt, me shkresat tona respektive, i jemi drejtuar ARRSH-së dhe Bashkisë Tiranë, për dhënie informacioni mbi masat papaprake që ishin marrë për zgjidhjen e problemit të strehimit të familjeve, të cilave iu cënoheshin banesat nga zbatimi i projektit.

Bazuar në përgjigjen e ARRSH-së me shkresën nr.8294/1 datë 26.10.2017, dhe të dokumentacionit të paraqitur bashkëngjitur kësaj përgjigjeje na rezulton se, VKM nr.557 datë 27.07.2016 “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtëshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza Lindore Tiranë (LOTI III)”, parashikon si subjekte shpronësimi 30 pasuri, të llojit “Truall” dhe “Pyll”, por jo ndërtime - banesa. Nga lista e vetme papaprake që ARRSH-ja ka dërguar bashkëngjitur kërkesave për shpronësim shtesë në vazhdim na rezulton se, **kërkohet shpronësim për subjektet përkatëse për 2 (dy) pronësi të llojit “Arë”, për subjektet përkatëse për 13 (trembëdhjetë) pronësi të llojit “Truall”, për subjektet përkatëse për 29 (njëzet e nëntë) pronësi të llojit “Ndërtesë”, si dhe për subjektet përkatëse për 2 (dy) pronësi të llojit “Apartament”**. Sipas kësaj liste atëherë del e qartë

<sup>21</sup> Përcaktohet një afat kohor prej 3 muajsh, për përfundimin e procedurës administrative, nga ana e ALUIZNI-t, nga momenti i inicimit të saj, për çdo vetëdeklarim të ndërtimit informal, nga subjektet e interesuara.

se, vetëm 31 pronësi që mund ti cilësojmë si banesa ku jetojnë familje të këtij komuniteti do të shpronësohen, ndërsa diferenca prej 138 objektivsh-ndërtime të tjera do të prishen.

Sipas shkresës nr.33714/3 datë 18.09.2017, të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale, në Bashkinë Tiranë, janë marrë kontakte në vend me familje të komunitetit të banorëve, banesat e të cilëve preken nga zbatimi i projektit, për njohjen e situatës social-ekonomike të këtyre familjeve. Sipas një vlerësimi fillestar të cituar në shkresë, punësimi i anëtarëve të një pjese të këtyre familjeve, mbulon vetëm nevojat bazë të jetesës dhe jo më shumë. Në këto kushte, Bashkia Tiranë ka kërkuar mirëkuptim dhe bashkëveprim me IKMT-në, për t'ju mundësuar banorëve ndihmë përmes trajtimit me programet sociale të strehimit. Kemi kërkuar të vihem në dijeni nga ana e Bashkisë Tiranë, nëse ka patur koordinim ndërmjet ARRSH-së dhe Bashkisë Tiranë për këtë çështje dhe nëse është kryer një studim paraprak i gjendjes së familjeve që preken në pronësitë e tyre nga zbatimi i projektit, sa i takon përbërjes së tyre, mundësive financiare, trajtimit të mundshëm me strehim dhe çështjeve të tjera që lidhen me nivelin e jetesës në vazhdim. Sipas përgjigjes përkatëse, Bashkia Tiranë ka vlerësuar paraprakisht gjendjen emergjente dhe nevojën për strehim të familjeve të prekura në këtë zonë, duke realizuar vlerësimin social ekonomik në çdo familje. Përmes vendimit të Këshillit Bashkiak nr.113 datë 28.09.2017, Bashkia Tiranë u ka ardhur në ndihmë familjeve të prekura (113 familje), nga zbatimi i projektit, me mbulimin e shpenzimeve të qirasë për një periudhë 1 vjeçare.

Ndërkohë rezulton se, ka munguar komunikimi real dhe i nevojshëm, si dhe koordinimi paraprak ndërmjet ARRSH-së dhe Bashkisë Tiranë, për trajtimin e familjeve të cilat preken në pronësitë e tyre, pra të banesave, qofshin këto në posedim, apo në pronësi të ligjshme, si pasojë e zbatimit të projektit. Kjo situatë, paraqitet në kushtet e “dëbimit me forcë”, në shkelje të të gjitha parimeve dhe standardeve ndërkombëtare të trajtimit të rasteve të dëbimit me forcë.

#### **5.1.4 Ndërtimet ekzistuese para Gushtit të vitit 1991, në zonën e Shkozës**

Gjatë shqyrtimit të disa ankesave individuale na ka rezultuar se, ARRSH-ja mbi bazën e konstatimeve paraprake ka mbajtur korrespondencë me Bashkinë Tiranë, mbi ekzistencën e ndërtimeve të ngritura para vitit 1991 në zonën e Shkozës dhe për të cilat, poseduesit nuk disponojnë dokumenta ligjore pronësie. ARRSH-ja, me shkresën nr.7487/1 datë 3.10.2017, i ka kërkuar Bashkisë Tiranë vazhdimin e procedurave për regjistrimin e këtyre ndërtimeve, tashmë të identifikuara, në përputhje me parashikimet e VKM nr.608 datë 5.09.2012. Për këtë arsye, i kemi kërkuar shpjegime Bashkisë Tiranë, lidhur me masat e marra për këtë qëllim. Bashkia Tiranë na ka informuar me shkresën nr.36284/1 datë 23.11.2017 (drejtuar edhe ARRSH-së për dijeni) se, për 16 subjektet pjesë e listës së ARRSH-së, priste plotësimin e dokumentacionit të kërkuar nga ana e VKM nr.608 datë 5.09.2012, për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave të regjistrimit të pasurive të paluajtëshme. Megjithëse i janë kërkuar shpjegime në vazhdim ARRSH-së, mbi masat e marra për plotësimin e dokumentacionit ligjor të munguar, sipas kërkesës së paraqitur nga ana e Bashkisë Tiranë, përsëri nuk na është dërguar asnjë përgjigje zyrtare.

Vendimmarrja e Bashkisë Tiranë ka munguar dhe kjo ka bërë që, pasuritë e paluajtëshme, të ndodhura në zonën e Shkozës në këto kushte dhe që preken nga zbatimi i projektit, të mos kalojnë në pronësi të ligjshme të poseduesve të tyre, duke mohuar kështu një proces shpronësimi për to.

#### **5.1.5 Konkluzione përfundimtare:**

Nga shqyrtimi i veprimtarisë së ARRSH-së, IKMT-së dhe Bashkisë Tiranë, lidhur me problematikat e ndeshura janë nxjerrë disa konkluzione, ndër të cilat veçojmë:

**5.1.5.1** Mosdhënia apo fshehja e informacionit për vendimin për miratimin e projektit “Unazë Jashtme e Tiranës”, Loti III, na nxjerr në konkluzionin se: nuk ka një vendim për miratimin e projektit “Unazë e Jashtme e Tiranës”, Loti III (Sistemimi i shtratit të Lumit të Lanës dhe ndërtimi i rrugëve

paralele, segmenti Materniteti i Ri, Unaza e Jashtme e Tiranës)”, gjë që sjell pasoja shumë serioze për gjithë ligjshmërinë e procesit në tërësi.

#### **5.1.5.2** Veprimtaria e ALUIZNI-t, ka shkelje ligjore të cilat konsistojnë në:

- a) Mostrajtimin e vetëdeklarimeve brenda afateve ligjore procedurale, të përcaktuara nga nenit 49, të Ligjit nr.8485 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”. Ky mosveprim, realisht i ka shkaktuar dëm subjekteve vetëdeklaruese të ndërtimeve informale, në zonën e Shkozës që preket nga zbatimi i projektit, në kushtet e parashikuara nga Ligji nr.8510 datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës publike”, i ndryshuar. Po kështu, ky mosveprim ka sjellë pasojën që lidhet me shkeljen e, së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor, apo të parimit të sigurisë juridike.
- b) ALUIZNI rezulton se ka kryer procedura ligjore, deri në lidhje kontrate për kalim pronësie të parcelës ndërtimore (të ndodhur në zonën ku po zbatohet projekti), në favor të subjekteve vetëdeklarues. Por në mënyrë të kundërligjshme procedura nuk është vazhduar më tej, gjë që ka sjellë pasoja të rënda për subjektin tashmë ligjërisht pronar të parcelës ndërtimore, sa i takon vlerësimit të gjendjes juridike të ndërtimit informal të vetëdeklaruar prej tij dhe mospërfshirjes në listën e subjekteve që duhen shpronësuar, për llojin e pasurisë “Truall”.
- c) ALUIZNI nuk ka zbatuar VKM Nr.125, Datë 17.02.2010 “Për miratimin e kalimit në pronësi të disa parcelave ndërtimore në favor të poseduesve të objekteve informale”.

**5.1.5.3** Veprimtaria e IKMT-së, në këtë çështje shfaqet e fragmentarizuar, jo analizuese dhe jo reaguese, mbi veprimet ligjore që i kërkohet që të ndërmerret, si dhe në ndërveprimin institucional të kërkuar.

**5.1.5.4** Procesi i shpronësimit me subjekt përfitues, Autoritetin Rrugor Shqiptar, shfaqet problematik dhe me shkelje të rënda ligjore. VKM nr.557 datë 27.07.2016, ka mungesë të elementëve thelbësore të përcaktuar nga ligji, gjë që vë në diskutim vlefshmërinë e gjithë procedurës së shpronësimit.

**5.1.5.5** Është i nevojshëm ndryshimi dhe përmirësimi i legjislacionit, lidhur me parashikimin e një dëmshpërblimi të arsyeshëm në kuadër të një procesi shpronësimi specifik, për të gjithë subjektet posedues të objekteve informale që preken nga zbatimi i projekteve për ndërtimin e veprave publike. Në këtë grupim duhet të futen ndërtimet informale për të cilat ka filluar procesi i legalizimit, apo edhe ndërtime të tjera informale, të cilat vërtetohet se janë ekzistuese në kohë, para miratimit dhe zbatimit të projekteve për ndërtimin e veprave publike.

Mbi bazën e këtyre gjetjeve është përgatitur Raporti i Veçantë “Për problematikat e vërejtura në veprimtarinë e disa organeve të administratës publike, gjatë zbatimit të projektit “Unaza e Jashtme e Tiranës”, Loti III (Sistemimi i shtratit të Lumit të Lanës dhe ndërtimi i rrugëve paralele, segmenti Materniteti i Ri, Unaza e Jashtme e Tiranës)”. Ky Raport i Veçantë i është dërguar Kuvendit të Shqipërisë, me shkresën përcjellëse nr.256 datë 29.06.2018, por nuk është trajtuar dhe diskutuar brenda afateve ligjore. Theksojmë se, problematikat e evidentuara vazhdojnë ende të jenë në dinamikën e tyre, ndaj edhe konstatimet dhe konkluzionet e nxjerra vlejné për ecurinë në vazhdim të të gjithë procesit të zbatimit të projektit për ndërtimin e këtij segmenti rrugor, si dhe të projekteve të tjera në vazhdim, për ndërtimin e Unazës së Jashtme të qytetit të Tiranës.

Në muajt e fundit të vitit 2018 kemi filluar shqyrtimin e ankesave të banorëve në zonën e Astirit, të cilët kanë parashtruar shqetësimin dhe pretendimin e tyre, lidhur me prishjen e planifikuar në këtë zonë të një numri të lartë objektesh banimi dhe shërbimi, të vetëdeklaruar për legalizim në periudha të ndryshme kohore, duke filluar që nga viti 2005. Veç ankesave individuale problematika e shfaqur po shqyrtohet me inisiativë nga ana jonë. Si shkak që ka krijuar këtë gjendje identifikohet zbatimi i projektit “Rehabilitimi i segmentit rrugor Mbikalimi Pallati me Shigjeta –Rrethrotullimi Shqiponja”.

Për hetimin administrativ të kësaj problematike janë marrë kontakte me banorë të kësaj zone, nga të cilët janë administruar dokumenta dhe ankesa individuale në thelb të të cilave qëndron fakti se, banesat e tyre po prishen në mënyrë të padrejtë, pasi i janë nënshtruar një procesi të gjatë legalizimi. Po kështu është ngritur pretendimi se projekti që po zbatohet në këtë zonë është hartuar dhe miratuar në mungesë të plotë transparence dhe pa një proces real konsultimi dhe informimi, sikundër pretendohet nga ana e ankuesve edhe për ndërhyrje të shumta në projektin paraprak, si pasojë e të cilave favorizohen disa subjekte apo persona të veçantë, me qëllim zhvillimin e zonës me ndërtime të larta. Në trajtimin e kësaj çështjeje komplekse përfshihet veprimtaria e disa organeve publike si Autoriteti Rrugor Shqiptar, ALUIZNI, si edhe Bashkia Tiranë.

Nga verifikimet dhe konstatimet e kryera gjatë vitit 2018 për këtë rast, na rezultojnë të njëjtat problematika, të cilat lidhen me veprimtarinë e ushtruar jo në përputhje me ligjin nga ana e Autoritetit Rrugor Shqiptar, ALUIZNI-t, si edhe të Bashkisë Tiranë, sikurse kemi theksuar dhe evidentuar edhe në Raportin e Veçantë “Për problematikat e vërejtura në veprimtarinë e disa organeve të administratës publike, gjatë zbatimit të projektit “Unaza e Jashtme e Tiranës”, Loti III (Sistemimi i shtratit të Lumit të Lanës dhe ndërtimi i rrugëve paralele, segmenti Materniteti i Ri, Unaza e Jashtme e Tiranës)”, drejtuar Kuvendit të Shqipërisë. Kjo gjë është e kuptueshme edhe për faktin se, zbatimi i projektit “Rehabilitimi i segmentit rrugor Mbikalimi Pallati me Shigjeta –Rrethrotullimi Shqiponja”, është vazhdim i ndërtimit të segmenteve të Unazës së Re, të Tiranës, të ndarë në disa lote ndërtimi.

Ndërkohë po punohet për përgatitjen e një raporti të veçantë për problematikat dhe gjetjet që lidhen me zbatimin e projektit “Rehabilitimi i segmentit rrugor Mbikalimi Pallati me Shigjeta –Rrethrotullimi Shqiponja”, në zonën e Astirit, Tiranë.

## **5.2. E drejta për tubime paqësore**

Në vijimësi, por veçanërisht gjatë vitit 2018, në institucionin e Avokatit të Popullit kanë ardhur për shqyrtim ankesa nga subjekte të ndryshme, si persona fizik dhe juridik (OJQ, sindikata, grupime qytetarësh, etj.) të cilët kanë pasur pretendime ndaj organeve të Policisë së Shtetit për mos lejjimin e ushtrimit të të drejtës për tubim të kërkuara prej tyre. Sipas subjekteve ankuese, pengesat e organeve të policisë kanë qënë për shkaqe nga më të ndryshme, si për mos bërjen e njoftimit organeve të policisë brenda afatit të parashikuar nga ligji, për mungesë të identitetit ose të adresës së organizatorit apo të drejtuesit të tubimit, për mos pasqyrimin në njoftim të qëllimit të tubimit, të datës, vendit, orës së fillimit dhe të përfundimit të tubimit, apo të itinerarit të tij (nëse ka të tillë), të numrit të përafërt të pjesëmarrësve dhe numrit e personave ndihmës në mbarëvajtjen e tubimit, të identitetit të personave që do të flasin në tubim, etj.

Nga shqyrtimi i këtyre rasteve nga institucioni ynë ka rezultuar se, në pjesën më të madhe të tyre, organet e policisë me të drejtë u kanë kthyer përgjigje njoftuesve se, njoftimet e tyre nuk plotësonin kriteret ligjore të parashikuara në ligjin “Për tubimet”. Ndërsa në disa raste njoftimet e subjekteve për tubim janë refuzuar për arsye se vendi i kërkuar për tubim nuk ka qënë i përshtatshëm, pasi bëhej pengesë për lëvizjen normale të shtetasve dhe të automjeteve. Gjithashtu ka pasur edhe raste që përgjigjet e organeve të policisë për plotësim të dhënash, apo për refuzimin e tubimit nuk kanë qënë korrekte, por janë gjetur shkaqe të paqënësishme për të refuzuar njoftimet apo kthyer përgjigje se ato nuk plotësonin kriteret ligjore. Ndërkohë kemi konstatuar që drejtuesit e organeve të policisë, kryesisht Shefat e Komisariateve, të cilëve iu drejtohen këto njoftime, nuk nxjerrin vendime të arsyetuara për komunikim me organizatorin ose drejtuesin e tubimit për ndalimet dhe kufizimet e mundshme ose kushtet e tjera, duke përfshirë edhe numrin e personave që do të ndihmojnë në mbarëvajtjen e tij, sipas nenit 6/1/a të ligjit “Për Tubimet”<sup>22</sup>,

<sup>22</sup> Neni 6 i ligjit nr. 8773, datë 23.4.2001, “Për Tubimet”, parashikon se:

“1. Shefi i Komisarariatit të Policisë, brenda 24 orëve nga marrja e kërkesës sipas pikës 2 të nenit 5, ose brenda 8 orëve nga marrja e kërkesës sipas pikës 3, të nenit 5, të këtij ligji me vendim të arsyetuar duhet:

për ndalimin e tubimit në sheshe ose vendkalime publike, apo për përcaktimin e kohës dhe vendit të zhvillimit të tubimit, sipas nenit 8 të këtij ligji<sup>23</sup>.

Mosnxjerrja e një vendimi të arsyetuar mbi kërkesën (njoftimin) për tubim nga ana e Shefit të Komisarariatit të Policisë, jo vetëm që nuk është qëndrim korrekt me ligjin, por në të njëjtën kohë bëhet shkak për cënimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi i mohon të drejtën ligjore kërkuesve për ankim ndaj vendimit të prishëm të Shefit të Komisarariatit të Policisë, të parashikuar në nenin 25 të ligjit “Për tubimet”.

Në rastet kur përgjigjet e organeve të policisë (Shefave të Komisariateve) nuk kanë qënë të bazuara në ligj apo nuk kanë qënë korrekte, policia është bërë shkak për shkeljen e një të drejte kushtetuese dhe ligjore të shtetasve për të tubuar lirisht. Ndërkohë ka pasur edhe raste që ndonëse policia ka refuzuar njoftimet, tubimet janë zhvilluar dhe pas kësaj policia ka bërë shpërndarjen me forcë të tubuesve dhe/ose ka bërë referime në organin e prokurorisë për fillimin e hetimeve ndaj organizatorëve dhe pjesëmarrësve në tubim për veprën penale të “Organizimit dhe pjesëmarrjes në grumbullime e manifestime të paligjshme”, parashikuar nga neni 262 i Kodit Penal.

Theksojmë se, qëndrimet jo ligjore të mbajtuara në këto raste nga organet e policisë çënojnë rëndë imazhin e Policisë së Shtetit dhe besimin e publikut tek ky organ, të cilat janë të domosdoshme në kryerjen me sukses të misionit ligjor të saj për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike.

Avokati i Popullit shpreh qëndrimin e tij në lidhje me ushtrimin e të drejtës/lirisë së tubimit nga qytetarët si një nga të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Sjellim në vëmendje se liria e tubimeve është parashikuar dhe garantuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Pjesa e II-të “Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”, Kreu III “Liritë dhe të drejtat politike”, respektivisht në nenin 47 ku parashikohet se:

1. *Liria e tubimeve paqësore dhe pa armë, si dhe e pjesëmarrjes në to është e garantuar.*
2. *Tubimet paqësore në sheshe dhe në vendet e kalimit publik bëhen sipas procedurave të parashikuara me ligj”.*

Rregullat procedurale që disiplinojnë apo kushtëzojnë ushtrimin e kësaj të drejte janë të përcaktuara në mënyrë të shprehur në ligjin nr. 8773, datë 23.4.2001 “Për tubimet”, ku parashikohen edhe kufizimet apo ndalimet shtetuese të cilat nuk mund të tejkalohen në ushtrimin e së drejtës së tubimit. Ky ligj pasi përcakton se, çdo person ka të drejtë të organizojë dhe të marrë pjesë në një tubim paqësor dhe pa armë, parashikon gjithashtu se Policia e Shtetit garanton dhe mbron të drejtën e çdo personi për të organizuar e marrë pjesë në tubime paqësore dhe pa armë. Ndalimi dhe shpërndarja e një tubimi lejohet vetëm në rastet e parashikuara me ligj. Nga referimi në përmbajtjen e dispozitave të këtij ligji rezulton në mënyrë të qartë se, detyrat e Policisë së Shtetit në lidhje me tubimet janë:

*Së pari*, veprime për garantimin e ushtrimit të kësaj lirie/të drejte themelore kushtetuese të shtetasve dhe; *Së dyti*, ndalimi i ushtrimit të kësaj lirie/të drejte bëhet vetëm për raste të kufizuara dhe të përcaktuara qartë në ligj.

---

a) t’i komunikojë organizatorit ose drejtuesit të tubimit ndalimet dhe kufizimet e mundshme ose kushtet e tjera, duke përfshirë edhe numrin e personave që do të ndihmojnë në mbarëvajtjen e tij,

b) t’u japë kopje të urdhrat zyrtar për caktimin e oficerit të policisë që do të jetë përgjegjës për të ndihmuar dhe vëzhguar zhvillimin e tubimit, 2. Shefi i Komisarariatit të Policisë njofton me shkrim drejtuesin e pushtetit vendor dhe prefektin për zhvillimin e tubimit”.

<sup>23</sup> Neni 8 parashikon se:

Kur ka arsye të motivuar se zhvillimi i një tubimi në një shesh ose vendkalim publik përbën një rrezik real për sigurinë kombëtare, sigurinë publike, parandalimin e krimit, mbrojtjen e shëndetit ose të moralit ose mbrojtjen e lirisë dhe të drejtave të të tjerëve dhe ky rrezik nuk mund të ndalohet me masa më pak shtrënguese, shefi i komisarariatit të policisë mund të ndalojë zhvillimin e tubimit ose të vendosë për kohën dhe vendin e zhvillimit të tubimit.

Theksojmë se e drejta e tubimit, që prej vitit 2001, vit në të cilin është miratuar ligji në fuqi, nuk i nënshtrohet asnjë formaliteti për miratim nga organet e policisë, sikurse parashikohej në ligjin e mëparshëm nr. 8145, datë 11.9.1996 "Për të drejtën e tubimeve", i cili është shfuqizuar tashmë. Për ushtrimin e kësaj të drejte kërkohet vetëm bërja e njoftimit në një kohë të përcaktuar i organeve të policisë ku të pasqyrohen disa të dhëna që lidhen me zbatimin e detyrës së saj si garantuese e ushtrimit të kësaj të drejte duke i dhënë kohe për të marrë masat e nevojshme për mbarëvajtjen e tubimit. Madje ligji aktual, në nenin 7 parashikon edhe të drejtën e shtetasve për zhvillimin e tubimeve urgjente në rastet kur ka rrethana urgjente, i cili mund të zhvillohet pa respektuar afatin e parashikuar në nenin 5<sup>24</sup> të këtij ligji, por detyrimisht duhet të bëhet njoftimi me shkrim i cili përmban elementët e përcaktuar në nenin 5, pika 2 të këtij ligji, si dhe arsyen e urgjencës. Në këto raste njoftimi duhet të bëhet menjëherë, por jo më vonë se 3 orë përpara kohës së zhvillimit të tubimit. Fakti që në ligjin aktual përdoret termi njoftim drejtuar Komisarariatit të Policisë për zhvillimin tubimit dhe jo kërkesë është me shumë rëndësi dhe domethënës në favor të ushtrimit dhe garantimit të kësaj të drejte/lirie nga shtetasit. Nëse në këtë ligj do të parashikohej termi kërkesë për zhvillimin e tubimit, kuptohet në mënyrë të qartë se për të bërë të mundur ushtrimin e kësaj lirie/të drejte do të duhej miratimi i organit të policisë, sikurse ishte në ligjin e mëparshëm. Ndërsa përdorimi në ligj i termit njoftim, do të thotë që "vendimin" për ushtrimin e të drejtës e ka marrë vetë subjekti njoftues dhe nuk kërkohet miratimi i organit të policisë. Pikërisht këtu qëndron ndryshimi thelbësor që ka sjellë ligji i ri "Për tubimet" për të garantuar ushtrimin real të kësaj lirie/të drejte themelore kushtetuese të shtetasve në një vend demokratik, sikurse është edhe vendi ynë. Nëse njoftuesit nuk e bëjnë njoftimin me të dhënat e parashikuara dhe kërkuara nga ligji, Shefi i Komisarariatit të Policisë ka të drejtën ligjore të komunikojë me organizatorin për plotësimin e të dhënave ose të marrë vendim të arsyetuar për ndalimin e tubimit në sheshe ose vendkalime publike, apo ndryshimin e vendit dhe të kohës së zhvillimit të tij. Është me rëndësi që të sjellim në vëmendje se, fryma pozitive e ligjit aktual reflektohet në mënyrë të qartë edhe në nenin 12<sup>25</sup> të tij ku parashikohet zhvillimi i tubimeve në vendet e hapura për publikun pa bërë njoftimin paraprak të policisë sipas nenit 5 të tij.

Përveç dispozitave të cituara më sipër, duke i referuar nenit 15/2 të Kushtetutës ku parashikohet se: *"Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre"*, si dhe nenit 2 të ligjit nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit" ku parashikohet se: *"Policia e Shtetit ka për mision ruajtjen e rendit e të sigurisë publike, ruajtjen e personaliteteve të larta shtetërore dhe objekteve të rëndësisë së veçantë, garantimin e zbatimit të ligjit, në përputhje me Kushtetutën dhe aktet ndërkombëtare, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut"*, Avokati i Popullit gjykon se nga Policia e Shtetit kërkohet që, jo vetëm të mos bëhet pengesë për ushtrimin e lirisë së tubimeve të shtetasve, por përkundrazi duhet të kontribuojë në realizimin e saj.

Në vijim të këtij detyrimi dhe për t'u krijuar lehtësi shtetasve për realizimin e të drejtave të tyre kushtetuese e ligjore, por edhe për të unifikuar qëndrimin e organeve të Policisë së Shtetit në të tilla raste, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit duhet të përgatiste modelar tip të njoftimit që i bëjnë

<sup>24</sup> Në neni 5 të këtij ligji parashikohet se:

1. Në rast tubimi në sheshe ose vendkalime publike, organizatori dhe drejtuesi janë të detyruar të njoftojnë me shkrim shefin e komisarariatit të policisë jo më vonë se tri ditë para datës së zhvillimit të tubimit.
2. Njoftimi me shkrim duhet të përmbajë:
  - a) identitetin dhe adresën e drejtuesit dhe të organizatorit të tubimit;
  - b) qëllimin e tubimit;
  - c) datën, vendin, orën e fillimit dhe të përfundimit të tubimit dhe itinerarin e tij (nëse ka të tillë);
  - ç) numrin e përfaqësuesve dhe numrin e personave ndihmës në mbarëvajtjen e tubimit;
  - d) personat që do të flasin në tubim.
3. Në rast se njoftimi me shkrim nuk i përmban elementet e parashikuar në pikën 2 të këtij neni, ai i kthehet për plotësim organizatorit dhe drejtuesit të tubimit, të cilët duhet ta riparaqesin atë të plotësuar jo më vonë se 24 orë para kohës kur do të zhvillohet tubimi.

<sup>25</sup> Në nenin 12 parashikohet se:

1. Tubimet në vende të hapura për publikun mbahen edhe pa njoftimin paraprak të policisë, sipas nenit 5 të këtij ligji.
2. Organizatorët e këtyre tubimeve mund të kërkojnë mbështetjen e policisë jashtë këtyre vendeve, për të mënjeluar ç'rregullimet gjatë ose pas zhvillimit të tubimit.

subjektet organit të policisë për ushtrimin e lirisë së tubimit në sheshe ose vendkalime publike dhe për rastet e njoftimit për tubimet urgjente. Në këto modelar duhet të përfshiheshin të gjitha rubrikat me qëllim që njoftuesit të plotësojnë të dhënat e nevojshme të parashikuara në nenin 5, pika 2 dhe nenin 7 të ligjit “Për tubimet”. Këto modelar të publikohen në Website e Policisë së Shtetit dhe të jenë të aksesueshëm për shtetasit duke krijuar edhe mundësinë e aplikimit on-line prej tyre. Gjithashtu për të qënë korrekt me ligjin dhe për unifikimin e qëndrimit të organeve të Policisë së Shtetit ndaj njoftimeve të subjekteve për tubim, të përgatiteshin modelar tip për nxjerrjen vendimit administrativ të arsyetuar nga Shefi i Komisarariatit të Policisë, si “Vendim administrativ për komunikim me organizatorin ose drejtuesin e tubimit për ndalimet dhe kufizimet e mundshme ose kushtet e tjera, duke përfshirë edhe numrin e personave që do të ndihmojnë në mbarëvajtjen e tij”, sipas nenit 6/1/a të ligjit “Për Tubimet” dhe “Vendim administrativ për ndalimin e tubimit në sheshe ose vendkalime publike, apo për përcaktimin e kohës dhe vendit të zhvillimit të tubimit”, sipas nenit 8 të këtij ligji dhe të mos vazhdonte më praktika e deritanishme duke iu kthyer përgjigje njoftuesve. Përgatitja dhe publikimi i këtyre modelarëve do të garantonte ushtrimin e lirisë/të drejtës së tubimit në mënyrë efektive nga qytetarët siç ia nje ligji dhe pa pengesa administrative.

Për sa më sipër dhe me qëllim rritjen e performancës dhe imazhit të Policisë së Shtetit, si dhe rritjen e besimit të publikut tek ky organ, Avokati i Popullit i rekomandoi Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për:

- a- *Marrjen e masave të nevojshme për përgatitjen e modelarëve tip, si “Njoftim drejtuar Komisarariatit të Policisë për zhvillimin e tubimit në sheshe ose vendkalime publike” dhe “Njoftim drejtuar Komisarariatit të Policisë për zhvillimin e tubimit urgjent në sheshe ose vendkalime publike” nga subjektet njoftuese, publikimin e tij në Website e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit me qëllim që të jetë i aksesueshëm për shtetasit dhe të krijojë mundësinë e aplikimit on-line prej tyre.*
- b- *Marrjen e masave të nevojshme për përgatitjen e modelarëve tip, si “Vendim administrativ për komunikim me organizatorin ose drejtuesin e tubimit për ndalimet dhe kufizimet e mundshme ose kushtet e tjera, duke përfshirë edhe numrin e personave që do të ndihmojnë në mbarëvajtjen e tij”, sipas nenit 6/1/a të ligjit “Për Tubimet” dhe “Vendim administrativ për ndalimin e zhvillimit të tubimit në sheshe ose vendkalime publike, apo për përcaktimin e kohës dhe vendit të zhvillimit të tubimit”, sipas nenit 8 të këtij ligji.*

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me shkresën nr. 5530/3 prot., datë 06.11.2018, ka informuar se rekomandimi u pranua dhe në vijim të zbatimit të tij u përgatit Procedura Standarde e Punës “Planifikimi i shërbimeve të policisë gjatë zhvillimit të tubimeve”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1034, datë 31.10.2018. Kjo procedurë iu dërgua Sektorit të Komunikimit me Median dhe Publikun, pranë DPPSH, për të publikuar në site e Policisë së Shtetit formularët (modelarët) përkatës.

### **5.3 Protesta kundër taksës së Rrugës së Kombit**

Ky rast u vlerësua nga Avokati i Popullit, duke u kryer një hetim i gjithanshëm administrativ dhe në vijim paraqesim konstatimet për veprimtarinë e Prokurorisë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.

Pas ngjarjes së ndodhur, prokurorët bazuar në nenin 253 të Kodit të Procedurës Penale, më datë 31.03.2018, ora 23.00, kanë përpiluar 37 urdhëra ndalimi për qytetarët protestues, si të dyshuar për kryerjen e veprave penale “Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik” dhe “Shkatërrim i pronës, parashikuar nga nenet 236/2 e 150 të Kodit Penal.

Nga studimi i urdhërave të ndalimit, tek pjesa arsyetuese organi procedues, jo vetëm që nuk ka paraqitur asnjë arsye ligjore të ndalimit të personave, por gjithashtu nuk ka vërtetuar asnjë kusht për ekzistencën e shkaqeve të bazuara për rrezikun e ikjes për secilin prej tyre. Edhe në kërkesën e saj për vleftësimin e



ndalimeve dhe caktimin e masës së sigurimit, zhvilluar më datë 04.04.2018, organi i akuzës nuk paraqiti prova që të vërtetonin kushtet e rrezikut të ikjes për çdo person të ndaluar.

Nga hetimi i pavarur i Avokatit të Popullit dhe zhvillimit të shqyrtimit gjyqësor në seancën e vleftësimit të ndalimit, u evidentua fakti se, disa nga personat e ndaluar kishin shkaqe dhe arsye të tilla objektive që as mund të mendonin për t'u larguar, pra të përbënin rrezik për ikje, siç ka pretenduar organi i Prokurorisë. Më konkretisht, shkelje të lirive dhe të drejtave themelore të individit në vlerësimin tonë, ishin krijuar nga veprimet, apo mosveprimet në vijim:

- ✓ Urdhërat e ndalimit të nxjerrë nga Prokuroria nuk përmbanin asnjë arsyetim në lidhje me shkaqet që kanë çuar Prokurorinë në zbatimin në rastin konkret të një masë sigurie me privim lirie.
- ✓ Nuk ishin evidentuar nga ana e Prokurorisë dhe/ose Policisë veprimet konkrete të bëra midis tyre për të dokumentuar orën në të cilën i është kërkuar policisë zbatimi i këtyre urdhrave të ndalimit;
- ✓ As të ndaluarve dhe as familjareve të tyre nuk u ishte komunikuar një kopje e urdhërit të ndalimit, në momentin në të cilin u është privuar liria;
- ✓ Oficerët e Policisë Gjyqësore dhe/ose organi i akuzës kishin dështuar për evidentimin në mënyrë të saktë të orës në të cilën personave u ishte privuar liria;
- ✓ Procesverbalet e komunikimit të urdhrave të ndalimit, përmbanin pasaktësi të theksuara në përpilimin e tyre dhe kishin mangësi në lidhje me evidentimin e veprimeve procedurale, të cilat duheshin kryer në përputhje me Kodin e Procedurës Penale, gjë që kanë çuar në mosgarantimin e të drejtave të ligjore të ndaluarve;
- ✓ Kërkesa e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Kukës, për vlerësimin dhe caktimin e masave të sigurimit personal ndaj 23 shtetasve të ndaluar ishte depozituar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Kukës, jashtë afatit ligjor të parashikuar nga neni 258 i Kodit të Procedurës Penale.
- ✓ Gjithashtu Prokuroria kishte cenuar të drejtat e të ndaluarve duke llogaritur si kohë ndalimi orën e ekzekutimit të urdhrave të ndalimit datë 01.04.2018, ndërmjet 10.20-12.00, kohë e cila nuk pasqyrore realitetin e veprimeve të kryera në këtë rast. Pra për 23 personat e ndaluar, koha (ora) dhe vendi i ekzekutimit të ndalimit të tyre ishin të pasakta dhe nuk ishin pasqyruar siç kishte ndodhur në të vërtetë. Në fakt rezultoi se ora e privimit të lirisë për çdonjërin prej tyre kishte qenë të paktën 2 orë e gjysmë më parë;
- ✓ Prokurori i çështjes nuk kishte bërë ndjekjen e zbatimit korrekt të dispozitave procedurale nga ana e Policisë Gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Kukës, ndaj personave të ndaluar, sikurse parashikohet në pikën 1, të nenit 304, të Kodit të Procedurës Penale.
- ✓ Prezenca e madhe e forcave të Policisë së Shtetit gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, megjithëse e justifikuar ligjërisht për shkak të numrit të personave të ndaluar që po gjykoreshin, mund të krijonte premisa të intimidimit të trupës gjyqësore për zhvillimin normal të procesit, veçanërisht në rastet kur kishte pretendime në lidhje me zbatimin e ligjit nga organet e Policisë. Gjithashtu një prezencë e tillë mund të kishte ndikim në gjendjen e një “presioni të shtuar psikologjik”, tek personat e tjerë të pranishëm në sallën e gjyqimit (personat që gjykohen, apo mbrojtësit e tyre).

Gjatë zhvillimit të seancës gjyqësore për vlerësimin e masës së sigurisë, ishin gjykuar njëherazi 23 persona. Është e evidente se ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale në rastin konkret bëhen shkas për mosgarantimin me korrektesë të të gjitha të drejtave që parashikohen në një proces të rregullt gjyqësor për personat e ndaluar, nisur nga numri i madh i tyre. Gjithashtu numri i madh i personave kishte kërkuar edhe marrjen e masave jo të zakonshme, për të garantuar ruajtjen e rendit dhe sigurisë në sallë e jashtë saj.

Pavarësisht ndryshimeve që kanë ndodhur në Kodin e Procedurës Penale, mbi gjykimin e disa personave njëherësh në të njëjtën seancë gjyqësore, sikurse ka ndodhur edhe në këtë rast, duhet vënë dukje fakti se, kjo mënyrë gjykimi nuk mund të sigurojë në situatën faktike (kur ka një numër të lartë të ndaluarish) efektivitetin e gjyqimit, si dhe kontradiktorialitetin e nevojshëm në gjykim e ndaj ka nevojë për t'u vlerësuar një ndryshim legjislativ në këtë drejtim.

Ndërkohë, nga dokumentacioni i disponuar në lidhje me këtë çështje, u vërejt se në vendimin gjyqësor nr. 39329, datë 04.04.2018, cilësohej se kjo seancë gjyqësore kishte qenë publike, çka binte ndesh me situatën e krijuar para zhvillimit të kësaj seance. Nuk rezultoi nga aktet as të ketë pasur kërkesë nga organi i akuzës dhe as të jetë marrë ndonjë vendim nga ana e Gjyqtarës, për gjykimin e sencës gjyqësore me dyer të mbyllura.

Kjo situatë e krijuar bie ndesh me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale për zhvillimin e seancës me dyer të hapura dhe pikërisht nenet 339 dhe 340, të Kodit të Procedurës Penale, që parashikojnë se në parim, seancat gjyqësore janë publike.

Nga ky konstatim i parë, duhet theksuar se, seanca e hapur gjyqësore përbën një tipar thelbësor të së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Karakteri i hapur i procedimeve para organeve gjyqësore, sipas nenit 6/1 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), mbron palët ndërgjyqëse kundrejt ushtrimit të drejtësisë në fshehtësi dhe pa mbikëqyrje publike. Publiciteti në ushtrimin e drejtësisë kontribuon në përmbushjen e synimit për një proces të rregullt ligjor.

Evidentimi më i saktë i vendimeve, komunikimeve dhe zbatimi korrekt i tyre, në lidhje me zhvillimin me dyer të mbyllura apo të hapura të seancës së vlerësimit të masës së sigurimit, do të mënjanonte konfrontime midis familjarëve të personave të ndaluar dhe deputetëve të Kuvendit, me forcat e Policisë së Shtetit, që kishin marrë përsipër të garantonin rregullin dhe sigurinë në sallën e gjyqit. Këto vendime e komunikime duhet të bëhen për raste të tilla në mënyrë publike edhe nga administrata e Gjykatës, për të mënjanuar tensionet në vigjilje të seancës.

Duke mos qenë objekt i drejtëpërdrejtë i punës së Avokatit të Popullit dhënia mendim mbi përmbajtjen e vendimit të Gjykatës, në lidhje me formën e tij, jemi të mendimit se një vendim gjykate duhet të jetë i arsyetuar në mënyrë bindëse e shteruese duke marrë në shqyrtim e analizuar të gjitha pretendimet e ngritura gjatë gjykimit, për të përjashtuar kështu efektet negative që mund të krijohen në rastin e kundërt. Vetëm kështu sistemi i drejtësisë do të mund të krijojë besimin e munguar në sytë e publikut.

Respektimi i së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor mbetet një nga elementët kyç në çdo proces vendimmarrës të organeve shtetërore, gjë që ngërthen në vetvete një sërë të drejtash të tjera, shkelja e të cilave cenon rëndë besueshmërinë dhe legjitimitetin e këtyre organeve. “Prezumimi i pafajësisë” kërkon një proces shterues dhe të plotë ligjor, ku çdo hap dhe hallkë procedurale plotëson “mozaikun e nevojshëm” ligjor të bazueshmërisë së masave dhe vendimeve të dhëna, në procesin penal.

Në fund të këtij hetimi administrativ, Avokati i Popullit hartoi rekomandimin drejtuar Prokurorisë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, datë 19.04. 2018, *“Në lidhje me trajtimin e rastit tubimit të datës 31.03.2018 në “Rrugën e Kombit”, për kundërshtimin e tarifës së vendosur për kalimin në këtë rrugë”*. Duke qenë se një problem i tillë po paraqitet shqetësues në vijimësi, institucioni i Avokatit të Popullit është në përfundim të një raporti të veçantë për këtë çështje që do ti adresohet Kuvendit në një kohë sa më të shpejtë.

#### **5.4 Monitorimi i pavarur i të drejtave të emigrantëve të huaj dhe kthimeve të detyruara të qytetarëve shqiptarë**

Shqipëria vijon të përballet me raste të shtuara të hyrjes së migrantëve të huaj kryesisht nga kufiri me Greqinë si pikë hyrëse dhe kufiri me Malin e Zi si pika dalëse. Pika e Kakavijës në Gjirokastrë dhe zonat përreth saj shërbejnë si rrugë të depërtimit të migrantëve të huaj.

Gjatë vitit 2018, siç është informuar edhe më parë institucioni i Avokatit të Popullit (MKPT-ja) në kuadër Marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkruar me UNHCR, është përfshirë në monitorimin e pikave të kalimit të migrantëve dhe forcimin e respektimit të të drejtave të tyre.

Kjo gjë është arritur përmes aktiviteteve të tilla si monitorimi sistematik i kufijve, prezenca gjatë procedurave të përzgjedhjes me personat në fjalë, analizë dhe rekomandime në lidhje me procedurat e mësipërme dhe monitorimin e kufirit, raportim i të dhënave në Zyrën Qendrore dhe UNHCR, kontribut në hartimin e fletëpalosjeve për refugjatët dhe azilkërkuetit, bashkëpunim me aktorët dhe pjesëmarrje në aktivitete/evente të përbashkëta. Gjatë periudhës dhjetor 2017- dhjetor 2018 janë kryer mbi **50** misione monitoruese në brezin kufitar të Qarkut të Gjirokastrës me Greqinë, një pjesë e madhe e të cilëve në bashkëveprim me zyrën e UNHCR-së Gjirokastrë ndërsa një pjesë në mënyrë të pavarur. Misione janë kryer edhe në Qafëbotë të Sarandës dhe në Drejtorinë e Kufirit Sarandë.

**TABELA MONITORIMIT TË INTERVISTAVE TË PËRZGJEDHJES SË REFUGJATËVE  
(Gjirokastrë dhe Kakavijë për periudhën janar- dhjetor 2018)**

Muaji	Monotorimi i proceduarve të përzgjedhjes		Kryerja e intervistave të thelluara në Gjirokastrë dhe Kakavijë	Vizita të përbashkëta monitoruese ne objektet e përzgjedhjes në Kakavijë dhe Grehot
	raste	persona		
<b>Janar</b>	8	29	18	4
<b>Shkurt</b>	24	160	21	7
<b>Mars</b>	31	296	27	6
<b>Prill</b>	25	240	17	7
<b>Maj</b>	23	210	11	5
<b>Qershor</b>	13	103	13	5
<b>Korrik</b>	21	116	19	4
<b>Gusht</b>	27	87	9	4
<b>Shtator</b>	24	50	11	4
<b>Tetor</b>	27	81	13	4
<b>Nëntor</b>	21	30	9	4
<b>Dhjetor</b>	24	52	6	4
<b>Totali</b>	<b>268</b>	<b>1454</b>	<b>169</b>	<b>58</b>

Inspektimi i Qendrës së Mbyllur për të Huajt, Kareç, për strehimin e të huajve të parregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë, ndaj të cilëve është marrë një masë ndalimi në përputhje me legjislacionin në fuqi, ka qenë një tjetër mision i realizuar me qëllim vlerësimin e kushteve të trajtimit të personave të trajtuar në të. Gjatë vizitave monitoruese dhe hetuese në këtë Qendër, si rrjedhojë e ankesave të shumta mbi trajtimin e shtetasve të huaj në të gjatë vitit 2018, u konstatua se flukset migratore janë të çrregullta, pasi ka raste në periudha të caktuara të vitit, që kjo qendër nuk ka prani për strehim për të huajt ndaj të cilëve është marrë masë ndalimi, sikurse ka raste të tjera që në periudha të caktuara të vitit ka mbipopullim. Përgjithësisht vijojnë po të njëjtat problematika të konstatuara në inspektimet e kryera gjatë viteve të fundit:

- Organika e parashikuar nuk i plotësonte nevojat me staf për, komunikime në gjuhën dominante të të huajve, shërbime psiko-sociale, juridike dhe mjekësore.
- Mungojnë pajisjet në ambientet rekreative dhe sportive.
- Mungonin aktivitetet kulturore, argëtuese e sportive.
- Mungonin aktivitetet për të miturit, fëmijët e rritur dhe gratë.

Gjatë gjithë periudhës raportuese, Avokati i Popullit në rolin e MKPT-së, në bashkëpunim me Drejtorinë e Policisë Kufitare dhe të Migracionit dhe FRONTEx, ka monitoruar në mënyrë konstante operacionet e

riatdhesimit vullnetar e të detyruar të shtetasve shqiptarë nga vendet e BE-së dhe shteteve të zonës Shengen, me qëllim transferimin sipas rregullave të shtetasve shqiptarë me vendim riatdhesimi nga territoret e vendeve anëtare të BE-së. MKPT, ishte pjesë e grupit monitorues të 32 operacioneve të riatdhesimit, duke u bashkërenduar dhe me Mekanizmat e vendeve të tjera, duke ushtuar në këtë mënyrë rolin e vet ligjor si garant, e njëkohësisht duke përmbushur Direktivën 2008/115/EC<sup>26</sup> të Parlamentit Evropian për standardet e përbashkëta midis vendeve të BE-së dhe vendeve të treta, në monitorimin e pavarur nga ana e MKPT-ve të operacioneve të kthimit të shtetasve nga BE në vendet e origjinës. Standardet e veprimtarisë së punës së MKPT-së në këtë proces bazohen në parimet ligjore të cilat rrjedhin nga instrumentet ndërkombëtare (të drejtat e njeriut).<sup>27</sup>

Në përfundim të proceseve të monitorimit MKPT-ja ka rekomanduar marrjen e masave për të garantuar kthimin në mënyrë njerëzore duke respektuar plotësisht të drejtat themelore të migrantëve shqiptarë, respektimin rigoroz të standardeve të BE-së si dhe respektimin rigoroz të ligjit shqiptar duke nënvizuar zbatimin e standarteve veçanërisht për grupet vulnerabel përfshirë gratë dhe fëmijët, në mënyrë që të reduktohet në maksimum efekti psikologjik tek ta; marrjen e masave lidhur me sigurimin e shërbimit të përkthimit nga pala Franceze gjatë fazës së pyetjes në vendet e ndalimit si dhe procedurave të kryerjes së protokolleve të dorëzimit të dokumentacionit në qendrën e mbyllur në Lillë Francë, si dhe marrjen e masave për pajisjen me certifikatë mjeksore (fit to fly) të shtetasve shqiptarë para procesit të kthimit të detyruar etj.

## 5.5 Hartimi i Planit Strategjik 2019-2022

Institucioni i Avokatit të Popullit, me mbështetjen e Zyrës së Ombudsmanit Danez dhe Institutit Danez për të Drejtat e Njeriut, gjatë gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2018, vijoi punën për hartimin e Planit Strategjik të institucionit, që përfshin periudhën 2019-2022. Nëpërmjet këtij Plani Strategjik, Avokati i Popullit synon krijimin dhe zhvillimin e një kulture të qeverisjes së mirë, e cila nënkupton administrim të mirë, transparencë dhe llogaridhënie të administratës publike para qytetarëve të Shqipërisë, si dhe forcim të përgjithshëm të sundimit të ligjit, elementë të domosdoshëm për funksionimin e demokracisë dhe integrimin në Bashkimin Europian.

Gjithashtu, duke pasur parasysh kapacitetin institucional dhe burimet, si dhe duke marrë parasysh realitetin politik, ligjor, social, ekonomik, zhvillimor dhe kulturor të Shqipërisë, ambicia strategjike e Avokatit të Popullit është të qenurit aktor kryesor i të drejtave të njeriut i një sistemi kombëtar mirë-funksionues për të drejtat e njeriut në Shqipëri. Me këtë qasje dhe ambicie strategjike, Avokati i Popullit synon të përqëndrohet në atë që konsiderohet e rëndësishme për të dyja; ngritjen e kapacitetit të institucionit si dhe për vendosjen e dialogut me palët e interesuara.

Në të njëjtën kohë, Avokati i Popullit do të fokusohet në arritjen e rezultateve në një periudhë afatshkurtër, duke ruajtur qëllimet afatgjata në fokus, që të mund t'i tregojë shoqërisë shqiptare se Avokati i Popullit mund të bëjë dhe krijojë ndryshimin. Avokati i Popullit do të trajtojë gjithashtu çështje që kërkojnë përkushtim afatgjatë, përkrahje të jashtme politike të shoqërisë civile dhe komunitetit ndërkombëtar në Shqipëri si dhe mbledhjen e fondeve shtesë përtej financimit që Avokati i Popullit merr nga buxheti i shtetit.

Me qëllim hartimin dhe miratimin e një dokumenti gjithëpërfshirës, u konsiderua e domosdoshme nisja e një procesi të gjërë këshillimi publik me të gjithë aktorët dhe faktorët e ndryshëm të shoqërisë (ekspertë

<sup>26</sup> Direktiva 2008/115 / EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 16 dhjetor 2008, mbi standardet dhe procedurat e përbashkëta në shtetet anëtare për kthimin e shtetasve të vendeve të treta që qëndrojnë në mënyrë të paligjshme. Direktiva zbatohet për të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian përveç Mbretërisë së Bashkuar dhe Irlandës. Në masën që aplikohet për individët që hyjnë në territor pa autorizim, ajo zbatohet edhe për Danimarkën dhe bashkëpunëtorët e Shengenit (Islandën, Lihtenshtajnin, Norvegjinë dhe Zvicrën).

<sup>27</sup> Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)<sup>27</sup> Në veçanti nenet 3, 5 dhe 8, 20 udhëzimet e Komitetit të Ministrave për Kthimin me Forcë CM(2005)40 versioni përfundimtar, 9 maj 2005; në veçanti Udhëzimet 10 dhe 11, traktatet përkatëse të Kombeve të Bashkuara (OKB), dhe Direktiva për Kthimin e Bashkimit Evropian (BE) e vitit 2008

kombëtarë dhe ndërkombëtarë, përfaqësues të institucioneve publike dhe organizatave ndërkombëtare, shoqërinë civile etj), me qëllim marrjen e sugjerimeve dhe kontributeve reale për përmirësimin e mëtejshëm të këtij dokumenti strategjik.

Avokati i Popullit është i vetëdijshëm se nuk do të jetë i vetëm në realizimin e Planit Strategjik, pasi avancimi i axhendës së të drejtave të njeriut në Shqipëri kërkon angazhimin e të gjithë aktorëve të cilët janë të dedikuar ndaj standarteve të të drejtave të njeriut. Fuqizimi i bashkëpunimit si dhe krijimi i marrëdhënieve të reja me aktorë të tjerë do të përbëjë një element thelbësor në punën e Avokatit të Popullit. Vetëm duke punuar së bashku dhe duke qenë sa më gjithëpërfshirës ndaj grupeve të ndryshme të shoqërisë, zëri ynë dhe i qytetarëve të cilëve ne u shërbejmë do të bëhet më i besueshëm dhe i fuqishëm.

Aktualisht, me mbështetjen teknike të Zyrës së Kombeve të Bashkuara në Shqipëri është duke u punuar në hartimin e planit të veprimit në kuadër të zbatimit të Planit Strategjik, përmes përcaktimit të aktiviteteve konkrete, kostove dhe afateve të realizimit të tyre. Zbatimi i Planit të Strategjik në të gjithë komponentët e tij do të kërkonte domosdoshmërisht një mbështetje më të madhe financiare nga buxheti i shtetit, në burime njerëzore dhe financiare, për të mundur realizimin e mandatit të Avokatit të Popullit në fushën e promovimit, parandalimit dhe mbrojtjes të të drejtave të njeriut.

## **KREU 6**

### **Shërbimet mbështetëse**

Forcimi i kapaciteteve njerëzore dhe financiare të tyre, zbatimi i standarteve dhe praktikave më të mira, nëpërmjet pasjes së një infrastrukture që mundëson realizimin e objektivave dhe qëllimeve, është dhe mbetet një përpjekje dhe sfidë e vazhdueshme.

Institucionet e të Drejtave të Njeriut kanë nevojë për një mbështetje më të fortë dhe të vazhdueshme politike dhe financiare nga Parlamenti dhe qeveria, për të siguruar realizimin e detyrave të tyre në një mënyrë plotësisht efektive; të kenë autonomi ligjore, autonomi operationale dhe autonomi financiare nga qeveria, pavarësi të garantuar nga Kushtetuta apo ligji, pluralizëm në anëtarësi, burime adekuate, fuqi adekuate investigimi. E gjitha kjo për të garantuar një veprimtari sa më efikase institucionale.

Një institucion kombëtar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut (siç është institucioni i Avokatit të Popullit), duhet të veprojë domosdoshmërisht me “Parimet e Parisit”, të cilat përcaktojnë kompetencat, përgjegjësitë, përbërjen dhe garantojnë pavarësinë dhe pluralizmin. Për më shumë, Parimet e Parisit, sanksionojnë se “Një institucion kombëtar duhet të ketë një infrastrukturë që mundëson një drejtim të kënaqshëm të aktiviteteve të tij.....”.

#### **6.1 Menaxhimi i Burimeve Njerëzore dhe Administrative**

Mënyra e miratimit të strukturës dhe organikës së institucionit, është parashikuar shprehimisht në nenin 35, paragrafi 3 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar. Në ndryshim nga shumë institucione të pavarura kushtetuese, dhe të institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj, struktura dhe organika e institucionit caktohet nga vetë Avokati i Popullit.

E vërteta është që gjatë viteve të fundit, struktura dhe organika e institucionit ka pësuar ndryshime të herëpashershme, ndryshime që kanë synuar rritjen e efikasitetit dhe përshtatjen me rregullat dhe procedurat e parashikuara nga kuadri ligjor në fuqi në fushën e shërbimit civil. Këto ndryshime kanë synuar përcaktimin e një raporti të rregullt midis pozicioneve të punës me karakter manaxherial, drejtues dhe atyre të nivelit ekzekutues, si në organizimin e njësisë të strukturës, drejtori dhe sektorë, ashtu edhe në drejtim të numrit të pozicioneve të punës që nevojiten për të ndërtuar këto njësi të strukturës.

Gjithashtu, këto ndryshime kanë synuar dhe reflektuar pasjen e një strukture të qëndrueshme në kohë, relativisht homogjene me strukturat dhe kategorizimet e punonjësve të institucioneve të tjera shtetërore si dhe plotësimin e standardeve në drejtim të formatimit të njësive të strukturës, që lidhen me drejtoritë dhe sektorët përkatës.

Nisur nga numri i përgjithshëm i miratuar për punonjësit e institucionit, vlerësimi të njësive dhe strukturave aktuale, problematikave dhe mangësive të konstatuara sa i përket menaxhimit të burimeve njerëzore, siç dhe jeni në dijeni, gjatë 2-3 viteve të fundit (përfshirë edhe kërkesat dhe propozimet e bëra gjatë diskutimit të projekt-buxhetit për vitin 2019), e kemi konsideruar të nevojshme mbështetjen nga Kuvendi i Shqipërisë për shtimin e burimeve njerëzore, sidomos për sa i përket fuqizimit të strukturave mbështetëse të institucionit.

Duke qenë se këto kërkesa permanente, pavarësisht nevojave dhe argumenteve të paraqitura, nuk janë marrë në konsideratë, gjatë vitit 2018, struktura e institucionit pësoi disa ndryshime (ndryshime të miratuara në muajin prill dhe nëntor 2018). Fillimisht, në muajin prill pati një amendim të strukturës ekzistuese, e cila kishte të bënte me nevojën e fuqizimit të mëtejshëm të kabinetit ndihmës të Avokatit të Popullit, nëpërmjet fuqizimit të kësaj strukture edhe me një këshilltar. Kjo, për të mundësuar lehtësimin dhe mbarëvajtjen më të mirë të punës nga ana e titullarit së institucionit, pasi kjo strukturë organizative luan një rol të rëndësishëm konsultativ dhe verifikues për problemet dhe fushën e përgjegjësisë që mbulon Avokati i Popullit, si dhe shërben si strukturë filtruese e problemeve administrative.


Ndryshimi i dytë erdhi pas një vlerësimi të funksionimit dhe organizimit të institucionit (sidomos sa i përket strukturave mbështetëse dhe më konkretisht ri-organizimin e dy drejtorive: Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve dhe Drejtoria e Shërbimeve ndaj Qytetarit), me synimin drejt një ristrukturimi në drejtim të formatimit të njësive të këtyre strukturave, me synimin e fuqizimit të institucionit në përputhje me standardet e organizimit dhe veprimtarisë të institucioneve kombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Duke e parë në këtë këndvështrim, vlerësohet se struktura që u miratua me urdhërin e Avokatit të Popullit, nr.252, datë 21.11.2018, në formën që ajo është dhe brenda mundësive dhe kapaciteteve ekzistuese, akomodon shqetësimet e konstatuara, problematikat dhe sugjerimet e parashtruara si dhe ofron të gjitha garancitë e nevojshme për t'iu përgjigjur më së miri realizimit në mënyrë të suksesshme dhe të plotë të objektivave dhe misionit të institucionit të Avokatit të Popullit, veçanërisht për çështjet që lidhen me integrimin evropian, bashkëpunimin ndërkombëtar, shërbimeve mbështetëse etj., të cilat kërkojnë ndërveprim dhe angazhim permanent si dhe struktura të dedikuara dhe të kualifikuara për adresimin e duhur të tyre.

Gjithashtu, duhet të theksohet se në tërësinë e saj kjo strukturë respekton të njëjtat parime dhe standarde që duhet të ndiqen gjatë hartimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës shtetërore, dhe është në përputhje të plotë me vendimin nr.893, datë 17.12.2014 ‘Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm’.

*Struktura dhe Organigrama*

LIDHJA NR.1



## Lidhja Nr.2

Emërtimi i funksionit	Numri i Punonjësve (56)	Kategoria/Klasa
<b>Avokati i Popullit</b>	1	Ligji nr. 8454, datë 04.02.1999, i ndryshuar
<b>Kabineti</b>	7	
-Drejtor Kabineti	1	VKM nr. 187, datë 08.03.2017, i ndryshuar
-Këshilltar	5	I-b
-Sekretar	1	VKM nr. 187, datë 08.03.2017, i ndryshuar
- Sekretar i Përgjithshëm	1	I-a
<b>Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre</b>	7	
- Komisioner	1	Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, i ndryshuar
- Ndihmëskomisioner	3	II-a
- Ndihmëskomisioner	3	II-b
<b>Seksioni për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura dhe pushtetin gjyqësor</b>	5	
- Komisioner	1	Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, i ndryshuar
- Ndihmëskomisioner	3	II-a
- Ndihmëskomisioner	1	II-b
<b>Seksioni i Përgjithshëm</b>	5	
- Komisioner	1	Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, i ndryshuar
- Ndihmëskomisioner	3	II-a
- Ndihmëskomisioner	1	II-b
<b>Seksioni për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve</b>	4	
- Komisioner	1	Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, i ndryshuar
- Ndihmëskomisioner	1	II-a
- Ndihmëskomisioner	2	II-b



<p><b>Mekanizimi për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Komisioner</li> <li>- Ndhmëskomisioner</li> <li>- Ndhmëskomisioner</li> </ul>	<p style="text-align: center;"><b>5</b></p> <p style="text-align: center;">1</p> <p style="text-align: center;">2</p> <p style="text-align: center;">2</p>	<p>Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, i ndryshuar</p> <p>II-a</p> <p>II-b</p>
<p><b>Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Drejtor</li> </ul> <p><b>Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përgjegjës Sektori</li> <li>- Specialist për Burimet Njerëzore</li> <li>- Specialist Protokolli</li> <li>- Arkivist/Bibliotekar</li> <li>- Magazinier</li> <li>- Shofer i titullarit</li> <li>- Shofer</li> <li>- Teknik i mesëm i specialiteteve të ndryshme</li> <li>- Punëtor pastrimi</li> </ul> <p><b>Sektori i Financës dhe Prokurimeve</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Përgjegjës Sektori</li> <li>-Specialist i Financës</li> <li>-Specialist i Prokurimeve</li> </ul> <p><b>Sektori i IT dhe Pritjes së Qytetarëve</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përgjegjës sektori</li> <li>- Specialist i Shërbimeve ndaj Qytetarit</li> </ul>	<p style="text-align: center;"><b>18</b></p> <p style="text-align: center;">1</p> <p style="text-align: center;">1</p> <p style="text-align: center;">1</p> <p style="text-align: center;">1</p> <p style="text-align: center;">1</p> <p style="text-align: center;">1</p> <p style="text-align: center;">1</p> <p style="text-align: center;">2</p> <p style="text-align: center;">1</p> <p style="text-align: center;">2</p> <p style="text-align: center;">1</p> <p style="text-align: center;">1</p> <p style="text-align: center;">1</p> <p style="text-align: center;">1</p> <p style="text-align: center;">1</p> <p style="text-align: center;">2</p>	<p>II-b</p> <p>III-a</p> <p>III-b</p> <p>III-b</p> <p>Klasa VIII</p> <p>Klasa VI</p> <p>Klasa VI</p> <p>Klasa IV</p> <p>Klasa VI</p> <p>Klasa I</p> <p>III-a</p> <p>III-b</p> <p>III-b</p> <p>III-a</p> <p>III-b</p>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- <b>Sektori për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe integrimin evropian</b></li> <li>- Përgjegjës Sektori</li> <li>- Specialist</li> </ul>	<p style="text-align: center;"><b>3</b></p> <p style="text-align: center;">1</p> <p style="text-align: center;">2</p>	<p>III-a</p> <p>III-b</p>

## 6.2 Vështrim mbi të ardhurat dhe shpenzimet

Në mbështetje të ligjit nr. 109, datë 31.11.2017, "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2018", Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2 datë 06.02.2012 "Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" si dhe Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave nr. 2, datë 19.01.2018, "Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2018", i ndryshuar, performanca e produktit të buxhetit për institucionin e Avokatit të Popullit, sipas programit buxhetor të miratuar për vitin 2018, paraqitet si më poshtë:

### Programi - "Shërbimi Avokatisë"

Buxheti i akorduar për këtë program (i vetmi program që ka institucioni i Avokatit të Popullit) ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës së Programit (DPP) të hartuar gjatë procesit të PBA 2018-2020 dhe ka për qëllim arritjen e objektivave e produktit të përcaktuar e të miratuara në dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm (2018-2020).

### Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Artikujve për vitin 2018.

Me ligjin nr. 109/2017, "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2018", fondet e akorduara me ndryshimet e bëra gjatë vitit për funksionimin e aktivitetit të Institucionit të Avokatit të Popullit sipas artikujve, paraqiten në tabelat e mëposhtme:

### Raporti i Shpenzimeve Faktike të programit sipas Artikujve

Tabela nr. 1


Nr. Llog.	Emërtimi	Plani fillestar	Shtesa & Pakësimi	Plani i ndryshuar	Fakti
600	Paga	81.800.000	-10.500.000	71.300.000	71.128.898
601	Sig. Shoqërore e Shëndetësore	12.700.000	-2.500.000	10.200.000	10.012.953
602	Mallra dhe shërbime të tjera	15.400.000	3.380.000	18.780.000	18.743.952
605	Transferta. Korente të Huaaja	1.600.000	120.000	1.720.000	1.679.442
606	Transf për buxhetet familjare	500.000	2.639.100	3.139.100	1.887.915
231	Investimet	4.000.000		4.000.000	3.543.498
	<b>TOTALI</b>	<b>116.000.000</b>	<b>-6.860.900</b>	<b>109.139.100</b>	<b>106.996.658</b>

### Raporti Vjetor i Realizimeve të Shpenzimeve për vitin 2018

Tabela nr. 2

Nr.	Emërtimi	Plani i ndryshuar	Fakti	Diferenca	Realizimi në %
1	Paga	71.300.000	71.128.898	171.102	99,80
2	Sig. Shoqërore e	10.200.000	10.012.953	187.047	98,20
3	Mallra dhe shërbime të	18.780.000	18.743.952	36.048	99,80
4	Transferta. Korente të	1.720.000	1.679.442	40.558	97,60
5	Transf për buxhetet	3.139.100	1.887.915	1.251.185	60,10
6	Investimet	4.000.000	3.543.498	456.502	88,60
	<b>Totali</b>	<b>109.139.100</b>	<b>106.996.658</b>	<b>2.142.442</b>	<b>98,00</b>

## Struktura e Shpenzimeve 2018



### 6.2.1 Shpenzime Personeli

Realizimi i fondit të pagave reflekton strukturën dhe organikë, lëvizjet e brendshme dhe të jashtme. Ky fond i akorduar për vitin 2018, për mbulimin e shpenzimeve në paga personeli ishte 81.800.000 lekë, i ndryshuar me shkresat nr. 7101/1 Prot., datë 11.04.2018, “Transferim fonde për vitin 2018”, nr. 7101/4, datë 12.12.2018, “Transferim fonde për vitin 2018”, si dhe ndryshime sipas Aktit Normativ nr. 2, datë 19.12.2018, në 71.300.000 lekë, **ndërsa realizimi është 71.128.898 lekë ose 99,80%, i buxhetit të ndryshuar**, si dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore ishin në plan 12.700.000 lekë, i ndryshuar sipas Aktit Normativ nr. 2, datë 19.12.2018, në 10.200.000 lekë, **ndërsa realizimi është 10.012.953 lekë ose në masën 98,80% i buxhetit të ndryshuar**. Të dyja zërat së bashku paga personeli dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore (600+601) për vitin 2018 **janë realizuar në masën 99,60% i buxhetit të ndryshuar**. Gjatë vitit 2018, numri mesatar i punonjësve ka qenë 51,80 punonjës nga 56 punonjës që ka qenë kufiri i miratuar me ligjin e lartpërmendur. Mosrealizimi i këtij zëri të shpenzimeve vjen për shkak të mosplotësimit të strukturave organike si rezultat i vendeve vakant të krijuara në fund të vitit 2017 dhe gjatë vitit 2018 nga lëvizja e punonjësve të institucionit tonë në detyra të tjera.

### 6.2.2 Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera

Fondi i akorduar për periudhën Janar – Dhjetor 2018 për shpenzime mallra dhe shërbime (**zëri 602**) ishte 15.400.000 lekë, i ndryshuar me shkresën nr. 7101/1 Prot., datë 11.04.2018, “Transferim fonde për vitin 2018” në 18.780.000 lekë, **ndërsa realizimi është 18.743.952 lekë ose 99,80% e buxhetit të ndryshuar**.

Për vitit 2018 shpenzimet operative, janë përdorur për pagesat e blerjeve për kancelari, materiale pastrimi, furnizime me materiale të tjera zyre, njoftime publikime në gazeta dhe botime, shpenzime për energjisë elektrike, ujë, Albtelecom, Vodafon, shërbimi postar, siguracion automjetesh, blerje karburant, shpenzime për mirëmbajtjen e automjeteve të institucionit, dieta brenda dhe jashtë vendit, shpenzime për mirëmbajtje ndërtimore, shpenzime për mirëmbajtje aparatura e pajisje teknike, shpenzime pritje-përcjellje të të huajve, shpenzime për ekzekutim të vendimeve gjyqësore, shpenzime për pjesëmarrje në evente, etj.

Fondi për transferta korente të huaja (**zëri 605**) për vitin 2018, ishte 1.600.000 lekë, i ndryshuar me

shkresë nr. 7101/1 Prot., datë 11.04.2018, “Transferim fonde për vitin 2018” në 1.720.000 lekë (për shkak të rritjes së kuotave të anëtarësimit), ndërsa **realizimi është 1.679.442 lekë ose 97,60% i buxhetit të ndryshuar.**

Nr.	Emërtimi i Organizatës	Kuotacionet në vite						
		Monedha	Vlera në vite					
			2014	2015	2016	2017	2018	2019
1.	Shoqata e Ombudsmanit të Vendeve Mesdhetare (AOM)	Euro	750	750	750	750	750	1.000
2.	Shoqata e Ombudsmanëve dhe Mediatorëve të Frankofonisë (AOMF)	Euro	650	650	650	750	900	900
3.	Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (ENNHRI)	Euro	3.000	3.000	3.000	3.000	4.000	4.000
4.	Rrjeti Evropian të Ombudsmanit për Fëmijë (ENOC)	Euro	0	0	1.100	1.100	1.100	1.100
5.	Instituti Evropian i Ombudsmanit (EOI)	Euro	350	350	350	350	350	350
6.	Aleanca Globale e Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (GANHRI)	CHF	5.000	5.000	5.000	5.000	5.000	5.000
7.	Instituti Ndërkombëtar i Ombudsmanit (IOI)	Euro	750	750	750	750	750	750

Për vitin 2018 këto fonde janë përdorur për shlyerjen e detyrimeve në kohë të kuotave të anëtarësimit ku institucioni i Avokatit të Popullit është anëtarë në organizata ndërkombëtare si Shoqata e Ombudsmanëve dhe Mediatorëve të Frankofonisë (AOMF), Instituti Evropian i Ombudsmanit (EOI), Shoqata e Ombudsmanit të Vendeve Mesdhetare (AOM), Instituti Ndërkombëtar i Ombudsmanit (IOI), Aleanca Globale e Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (GANHRI), Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (ENNHRI), si dhe Rrjeti Evropian të Ombudsmanit për Fëmijë (ENOC).

Fondi për transferta buxhetore familjare dhe individë (**zëri 606**) për periudhën Janar - Dhjetor 2018, ishte 500.000 lekë, i ndryshuar me shkresat nr. 14795/1, datë 22.08.2018, “Akordim fondi për përdorim fondi të veçantë”, si dhe nr. 7101/4, datë 12.12.2018, “Transferim fonde për vitin 2018”, 3.139.100 lekë, ndërsa **realizimi është 1.887.915 lekë ose 60,10% i buxhetit të ndryshuar.**

### 6.2.3 Shpenzime në investime

Fondi i investimeve i akorduar nga buxheti i shtetit për vitin 2018 është 4.000.000 lekë, **ndërsa realizimi është 3.543.498 lekë ose 88,60% i buxhetit të rishikuar.** Për përmirësimin e kushteve të godinës të institucionit të Avokatit të Popullit janë bërë këto investime (shiko tabelën e mëposhtme).

në mijë/lekë

Projekti	Kodi i Projektit	Plan	Fakt	%
1. Rikonstruksion tarrace dhe lyerje	M660005	2.500	2.277	91
2. Blerje sistemi i kamerave	M660016	1.500	1.266	84,40
<b>TOTALI</b>		<b>4.000</b>	<b>3.543</b>	<b>88,60</b>

## 6.2.4 Miratimi i Buxhetit të institucionit për vitin 2019

Në kuadër të përgatitjes dhe diskutimit të Projekt Buxhetit për vitin 2019, institucioni i Avokatit të Popullit paraqiti në mënyrë të argumentuar disa propozime konkrete që lidheshin me disa shtesa dhe ndryshime në buxhetin e institucionin (shtesa në burime njerëzore dhe financiare). Argumentet për sa i përket rritjes së mbështetjes financiare, lidheshin së pari me misionin që ka Avokati i Popullit si një institucion kombëtar me mandat të gjerë në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut, institucion i cili gëzon dhe statusin “A”, si dhe duke pasur parasysh që veprimtaria e tij bazohet në parandalimin, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, konsiderohet e domosdoshme mbështetja përmes një infrastrukture njerëzore dhe financiare.

E vërteta është se pamvarësisht kërkesave të argumentuara për rritjen e buxhetimit për disa zëra (psh; shpenzime operative/kapitale) apo rritjes së numrit të burimeve njerëzore, këto kërkesa nuk u morën në konsideratë gjatë diskutimit të buxhetit për vitin 2019 në komisionet përkatëse parlamentare.

Institucioni i Avokatit të Popullit është i ndërgjegjshëm se mbështetja, apo pavarësia financiare nuk ka dhe nuk mund të ketë të njëjtën natyrë me pavarësinë organizative, ose me atë funksionale. Ky aspekt i pavarësisë varet kryesisht nga mundësitë financiare të vet shtetit. Gjithsesi, ashtu siç theksohet dhe në parimet e Parisit, si dhe në parimet e përcaktuara nga Komisioni i Venecias, një institucion kombëtar i të Drejtave të Njeriut duhet që të ketë jo vetëm staf të mjaftueshëm dhe një strukturë fleksibël, por edhe burimet e nevojshme financiare për kryerjen e plotë, të pavarur dhe efektive, të përgjegjësi dhe funksioneve të tij.

Nisur nga një qasje krahasimore, buxheti i institucionit për periudhën 2014-2019, ka qënë si më poshtë:  
Në mijë lekë

Nr.	Vitet	Miratuara					
		600-601	602-606	231	Nr. i Punonjësve		Totali
		Paga+sig	Shp. Operative	Investime	Nd/Komisioner	Gjithsej	
1	2014	75.500	16.000	4.000	21	50	95.500
2	2015	75.500	16.000	4.000	21	51	95.500
3	2016	84.500	17.000	4.000	21	55	105.500
4	2017	84.500	18.000	4.000	21	56	106.500
5	2018	94.500	17.500	4.000	21	56	116.000
6	2019	104.500	18.600	2.000	21	56	125.100

## 6.3. Funksionimi i zyrave rajonale

Është në tagrin kushtetues të institucionit të Avokatit të Popullit që në përmbushje të funksioneve të tij të jetë në gjendje të veprjë në barazi dhe ta bëjë administratën publike më të ndjeshme ndaj opinionit publik dhe më të përgjegjshme ndaj kërkesave për drejtësi dhe besueshmëri. Me fjalë të tjera, Avokati i Popullit gëzon të drejtën dhe detyrimin, që në bashkëpunim me zyrtarët publikë në nivel qendror apo vendor, të përpiqet për krijimin e një kulture demokratike dhe standardeve më të larta të respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut në vend.

Në referencë të arsyetimit të sipërcituar, Kuvendi i Shqipërisë në ligjin nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, ka përcaktuar ndërmjet të tjerash, të drejtën që ka Avokati i Popullit për të emëruar një përfaqësues të tij vendor si dhe detyrimin e organeve të pushtetit vendor për të ofruar akomodimin me zyrë si dhe krijimin e kushteve të nevojshme të punës, për zbatimin e gjithë kërkesave të këtij ligji. (neni 32)


Mbarëvajtja, mirëfunksionimi dhe efektiviteti i Zyrave Vendore të Avokatit të Popullit janë në vëmendje jo vetëm të qeverisë shqiptare (që akordon një buxhet të veçantë vjetor për funksionimin e tyre), por edhe në vëmendje të organizmave ndërkombëtarë (Bashkimit Evropian, Këshillit të Evropës, etj), që synojnë të mbështesin një institucion kombëtar për të drejtat e njeriut, siç është Avokati i Popullit, për të ushtruar sa më mirë funksionet e tij kushtetuese dhe ligjore. Thelbi i të tëra rekomandimeve të këtyre institucioneve ndër vite është krijimi i një aksesit sa më të mirë dhe pranë qytetarëve për marrjen e ankesave të tyre.

Bazuar në dispozitën e sipërcituar dhe në marrëveshje me pushtetin vendor, që nga viti 2013 janë ngritur dhe funksionojnë Zyrat Vendore në 7 (shtatë) Bashki të vendit, ç’ka ka mundësuar një njohje gjithmonë në rritje e rolit të institucionit të Avokatit të Popullit si promovues i të drejtave të njeriut.


Fakt për këtë është numri në rritje i qytetarëve që i drejtohen Zyrave Vendore, për të depozituar një ankesë, apo për të marrë këshillim ligjor, mbi rrugët që duhet të ndjekin për rivendosjen e të drejtës së pretenduar prej tyre. ***Për periudhën Janar-Dhjetor 2018, numri i ankesave/kërkesave të paraqitura kanë qenë 2385 ose 43% e totalit për vitin 2018.***

Në gjykimin tonë institucional të bazuar në eksperiencat përkatëse, kemi vlerësuar se nëse zyrat vendore të Avokatit të Popullit do të ndodheshin brenda godinave të bashkive respektive, apo pranë tyre, aksesueshmëria e qytetarëve drejt këtyre zyrave do të ishte shumë më e lehtë, vizibiliteti shumë më i lartë, dhe do të ndikonte në rritjen e bashkëpunimit ndërinstitutional si dhe të imazhit e besimit të qytetarëve tek ky institucion. Ky shqetësim është ngritur edhe gjatë diskutimit në Kuvend të raportit vjetor të vitit të kaluar, si dhe përmes një shkresë zyrtare dërguar Kryetarit të Kuvendit. Pavarësisht ndërhyrjes së Kuvendit (përmes angazhimit të institucionit të prefektit të qarkut), situata e zyrave rajonale në disa bashki ku ato operojnë vazhdon të mbetet e njëjtë (Zyra Vendore Pogradec, Berat si dhe kohët e fundit edhe ajo në Bashkinë Sarandë).

Më poshtë jepet një vështrim krahasimor të ankesave të ardhura nga Zyrat vendore për vitin 2017 dhe për vitin 2018.



## ZYRAT RAJONALE



### KREU 7

#### Shifra dhe fakte në lidhje me ankesat dhe trajtimin e tyre

Për gjithë periudhën e vitit 2018, në zyrën e pritjes së qytetarëve, zyrat rajonale dhe përmes mjeteve të tjera të komunikimit, atij postar dhe on-line, janë paraqitur **5516** ankesa pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, nga të cilat **2601 ankesa** kanë qenë pjesë e objektit të punës së Institucionit të Avokatit të Popullit dhe janë cilësuar “brenda juridiksionit dhe kompetencës“ dhe **2915 ankesa** janë trajtuar në formën e “këshillimeve dhe orientimeve”, mbi rrugët ligjore që duhet të ndjekin qytetarët për trajtimin e mëtejshëm të ankesave dhe institucionet që duhet t’u drejtohen. Nga totali i Ankesave për këtë vit 2385 ankesa kanë ardhur nga zyrat Rajonale.


#### 7.1 Numri i ankesave, kërkesave dhe njoftimeve të shqyrtuara

Gjatë shqyrtimit të vitit 2018 të ankesave të bëra nga institucioni i Avokatit të Popullit rezultojnë se janë mbyllur 1831 ankesa si më poshtë vijon:

- 173 Ankesa jashtë juridiksionit
- 290 Ankesa jashtë kompetence
- 556 Ankesa të pabazuar
- 14 Ankesa të refuzuar
- 743 Ankesa të pranuar (*të zgjidhura në favor të qytetarëve*)
- 55 Ankesa me heqje dorë

Paraqitja grafike Nr.1-Trajtimi i ankesave

## SI JANE TRAJTUAR ANKESAT



Grafiku më poshtë tregon mënyrën e shpërndarjes së ankesave, kërkesave dhe njoftimeve sipas seksioneve në Institucionin e Avokatit të Popullit, konkretisht:

Seksioni i Administratës	<b>886</b> ankesa
Seksioni i Fëmijëve	<b>170</b> ankesa
Seksioni i Veçantë	<b>880</b> ankesa
Seksioni i Përgjithshëm	<b>585</b> ankesa
MKPT-ja	<b>80</b> ankesa

Paraqitja grafike Nr.2-Shpërndarja e Ankesave Sipas Seksioneve




## 7.2 Rastet e mbartura në vite

Tabelat në vijim japin në mënyrë grafike një informacion rreth ankesave që janë trajtuar gjatë viteve nga Institucioni i Avokatit të Popullit.


Paraqitja grafike Nr.3- Ankesat e ardhura në Institucionin e AP ndër vite




## ANKESA 2001-2018




Paraqitja grafike Nr.4 – Shpërndarja e ankesave përgjatë vitit 2018 sipas qyteteve




Paraqitja grafike Nr.5 – Ankesat e regjistruara gjatë vitit 2018 sipas të drejtës që i janë shkelur qytetarëve



Paraqitja grafike Nr.6 – Shpërndarja e ankesave drejtua Institucionit të Avokatit të Popullit drejt Institucioneve Shtetërore dhe institucionet që janë në vartësi të tyre.



Paraqitja grafike Nr.7 – Ndarja e ankesave sipas mënyrës së trajtimit dhe zgjidhjes 2018



**REKOMANDIME drejtuar Institucioneve nga 01/01/2018 --- 31/12/2018**

Nr.	Nr.Doculive	Data e nisjes	Objekti i Rekomandimit	Institucioni që është dërguar Rekomandimi	Sistemi Ministror nga varet institucioni të cilit i është dërguar rekomandimi	Statusi i Rekomandimit	
						1. Pa Zbatuar 1.1. Pranuar 1.2. Pranuar Pjesërisht 1.3. Refuzuar 1.4. Pa përgjigje 1.5. Në Proçes	2. Zbatuar 2.1. Zbatuar Plotësisht 2.2. Zbatuar Pjesërisht
1	201701366	02.02.2018	Marrjen e masave të menjëhershme për lëshimin e dokumentave të pronësisë shtetasit Milo Brahimaj, për pasurinë e përfuturuar në pronësi sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi nr.10580, Datë 20.02.1994, të dhënë prej Komisionit të Ndarjes së Tokës, Fshati Dukat-Fshat, Vlorë, në emër të të ndjerit Brahim Brahimaj	Regjistruerit të ZVRPP Vlore	Ministria e Drejtësisë	Refuzuar	
2	201800022	25.01.2018	Marrjen e masave për dorëzimin sa më parë të kopjes origjinale të urdhërit të ekzekutimit, Vendimit Gjyqësor Nr.1178 Akti, Datë 20.04.2010 lëshuar prej Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, për ekzekutimin e Vendimit Gjyqësor Nr.2076, Datë 17.03.2009, dhënë po nga kjo Gjykatë	Drejtore Rajonale të Sigurime Shoqerore Tirane	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Pranuar	Zbatuar
3	201701562	05.02.2018	"Ushtrimin i kompetencave në procesin e ekzekutimit të Vendimit Gjyqësor të formës së prerë Nr. 8003, Datë 11.10.2016, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit, Tiranë, me Vendimin Nr. 1381, Datë 08.06.2016", konform parashikimit të kryer në Nenin 606 të K.Pr.C.	Zyra e Permbarimit Tirane	Ministria e Drejtësisë	Refuzuar	
